

I paklasifikuar

CCNM/DEELSA(2001)2

Organizata per Bashkepunim dhe Zhvillim Ekonomik

15 Korrik 2002

**QENDRA PER BASHKEPUNIM ME JO-ANETARET
DREJTORIA PER ARSIMIN; PUNESIMIN; ÇESHTJET SOCIALE E TE PUNES
KOMITETI I ARSIMIT**

**SHQYRTIM TEMATIK I POLITIKAVE KOMBETARE PER ARSIMIN –
SHQIPERI**

Pakti i Stabilitetit per Europen Juglindore

Tryeza 1 - Task Forca per Arsimin

JT00129648

Dokument i plote i disponueshem ne OLIS ne formatin e tij origjinal

Perktheu nga Anglishtja

Shfaqet SHYTI

PARATHENIE

Ky raport mbi arsimin ne Shqiperi eshte pergatitur ne kuadrin e Qendres per Bashkepunim me Jo-Anetaret (CCNM) te OECD si pjese e nje programi bashkepunimi me Paktin e Stabilitetit per Europen Juglindore. Sekretariati, si Koordinator per Politiken e Pergjithshme Arsimore dhe Ndryshimin e Sistemit, dhe i Task Forces per Arsimin ne Tryezen 1 te Paktit te Stabilitetit, ka realizuar nje Shqyrtim Tematik te Politikes arsimore te rajonit me seksione per Shqiperine, Bosnie-Hercegovinen, Bullgarine, Kroacine, FYROM, Kosoven, Moldavine, Malin e Zi, Rumanine, Serbine, dhe nje kapitull per çeshtjet rajonale. Temat e mbuluara jane mesuesit, kurrikulumit, drejtimi, dhe arsimi e kujdesi per femijet. Çdo seksion ofron nje veshtrim te pergjithshem te sistemit arsimor, çeshtje dhe barriera per reformen, dhe rekomandime. Rekomandimet jane hartuar per t'u perdorur nga politike-beresit kombetare dhe per te ndihmuar vendet dhe institucionet donatore te adresojne ku duhet asistencen rajonale. Krahas ketyre, raportet mund te sherbejne si baze per nje analize me te detajuar te sektoreve te veçante te arsimit.

Tranzicioni i rajonit drejt demokracive pluraliste dhe ekonomise se tregut dallohet per ndryshime ekonomike, sociale dhe politike te nje gjerësie dhe thellesie te jashtezakonshme. Talentet, aftesite dhe njohuritë e popullsisë janë te nje rendësie kyçe ne kete proces; prej kendej rrjedh edhe shkalla e ambicies dhe urgjences se reformave qe po ndermerren ne arsim, te cilat i bejne pjesemarresit ne Tryezen 1 te Paktit te Stabilitetit ta percaktojne arsimin si nje nga kater hapesirat prioritare.

Bazuar ne materialin mbeshletes te pergatitur nga autoritetet arsimore ne rajon, dhe ne raportet egzistuese e informacionet e marra nga mbledhjet gjate vizitave ne terren, ky Shqyrtim Tematik ofron nje analize te sistemit arsimor nen driten e kontekstit politik dhe shoqeror te rajonit dhe te çeshtjeve prioritare te aksesit dhe barazise, cilesise, efektshmerise dhe drejtimit.

Shqyrtimet Tematike te Politikes Arsimore ne Europen Juglindore u bene te mundura nga nje grant i Austrise, Finlandes, Greqise, Zvicres dhe UNICEF. Asistence shtese u dha nga Zelanda e Re, Keshilli Britanik, Byroja CROSS (Hollande), Fondacioni European i Trainimit (ETF), Banka Boterore, Fondacioni Shoqeria e Hapur dhe Qendra per Studimet e Politikes Arsimore (CEPS, Universiteti i Ljubljanes).

Anetaret e ekipit vleresues ishin: Johanna Crighton (Hollande), Raportuese e Pergjithshme, Helmut Bachmann (Austri), Ibrahim Barbaros (Turqi), Virginia Budiene (Lituani), Yael Duhilleul (Banka Boterore), Sergej Gabrshçek (Slloveni), Elsie Hunt (Shtetet e Bashkuara), Gia Kjellen (Suedi), John Mallea (Kanada), Francesco Panzica (ETF), Kari Pitkanen (Finlande), Frances Tsakonas (Greqi), Christine Stromberger dhe Ian Whitman (Sekretariati).

Opinionet e dhena dhe argumentet e shfrytezuara ne kete raport jane pergjegjesi eksklusive e autoreve dhe nuk reflektojne domosdoshmerisht ato te qeverise se Shqiperise, te OECD apo te qeverive te Vendeve Anetare te saj.

TABELA E PERMBAJTJES

PARATHENIE.....	2
SHQIPERIA.....	5
Te Dhena te Pergjithshme.....	5
Hyrja dhe Konteksti.....	6
Kuadri Ligjor.....	8
Sistemi Arsimit.....	9
Tipare te Veçanta.....	10
Drejtimi dhe Administrimi i Arsimit.....	13
Nivelet e Drejtimit Arsimit.....	13
Financa e Arsimit.....	14
Menyrat e financimit.....	14
Mbeturinat e se Kaluares.....	15
Pergjegjesi te Shperndara ne Nivelin Qendror.....	16
Decentralizimi Vertikal.....	17
Projekt Strategjia per Zhvillimin e Arsimit ne Shqiperi.....	17
Çeshtje dhe Barriera ne Drejtim dhe Administrim.....	18
Kurrikulumi.....	19
Reformat ne Kurrikulum.....	20
Klasat 1-4 dhe 5-8.....	20
Kurrikulumi per Arsimin e Mesem, Klasat 9-12.....	21
Forma te Tjera te Arsimit te Mesem.....	21
Tekstet.....	22
Çeshtje dhe Barriera ne Kurrikulum dhe Tekste.....	22
Vleresimi i Rezultateve te te Nxenit.....	24
Sistemi aktual i vleresimit dhe provimeve.....	24
Vleresimi ne arsimin parashkollor.....	24
Vleresimi i vazhduar ne klasat 1-4.....	24
Perfundimi i klases 8.....	24
Perfundimi i klases 12.....	25
Pranimet ne Universitet.....	25
Hapi pasues ne vleresimin e rezultateve te te nxenit.....	26
Çeshtje dhe Barriera ne Vleresim.....	27
Mesuesit dhe Trainimi i Mesuesve.....	28
Gjendja aktuale e mesuesve ne Shqiperi.....	28
Kualifikimet i mesuesve.....	29
Pagat e mesuesve.....	31
Ambienti i punes.....	32
Trainimi i mesuesve.....	32
Pergatitja ne shkolla.....	32
Trainimi ne detyre.....	34
Mesuesit dhe trainimi i mesuesve ne Strategjine Afatmesme te MASH.....	35

Kujdesi per Femijet dhe Zhvillimin e Tyre.....	36
Rendesia e arsimit ne femijerine e hershme.....	36
Fakte dhe shifra.....	36
Drejtimi dhe administrimi i sektorit parashkollor.....	37
Numuri i kopshteve dhe femijeve.....	38
Çeshtje te barazise dhe aksesit.....	39
Femijet Romë.....	39
Femijet me nevoja te veçanta arsimore (NVA).....	40
Femijet me probleme shoqerore dhe femijet ne rrezik.....	41
Çeshtje dhe Barriera ne Kujdesin per Femijet dhe Zhvillimin e Tyre.....	43
Arsimi dhe Formimi Profesional.....	44
Drejtimi.....	44
Keshilli Kombetar i AFP.....	46
Zhvillimi i kurrikulimit, standartet dhe vleresimi ne AFP.....	46
Asistenca e KE-Phare per Reformen e AFP ne Shqiperi.....	47
Çeshtje dhe Barriera ne Arsimin Profesional.....	48
Arsimi i Larte.....	49
Çeshtje dhe Barriera ne Arsimin e Larte.....	49
Rekomandime sipas Seksioneve.....	50
Drejtimi dhe Administrimi.....	50
Kurrikulumi.....	54
Vleresimi i Rezultateve te te Nxenit.....	56
Mesuesit dhe Trainimi i Mesuesve.....	57
Kujdesi per Femijet dhe Zhvillimin e Tyre.....	59
Arsimi Profesional.....	60
Arsimi i Larte.....	61
REFERENCAT.....	63

SHQIPERIA

Te Dhena te Pergjithshme

Siperfaqja: 28 748 km²

Popullsia: 3 387 327 (41% qytet, 59% fshat)

Struktura moshore dhe veçorite e popullsisë:

Mosha 0-4: 9.70%; 5-14: 22.6%; 48.86% e popullsisë nën 24 vjeç. Ritmi i lindjeve: 19.47 lindje për 1 000 banorë. Vdekshmëria foshnjore: 41.33 vdekje në 1 000 lindje. Popullsia në moshe për punë (16-65): 62%.¹

Densiteti i popullsisë: 118 për km².

Perberja etnike: 97.96% shqiptarë etnikë; 1.85% grekë (pohuajse të gjithë në rrethet Gjirrokaster dhe Sarandë); maqedonas 0.15%: një numur i vogël të tjerësh (serbë, malazezë {afër Shkodrës}, vllehe, dhe romë) 0.04%.²

Feja: Muslimanë 70%; ortodoksë 20%; katolike 10% (Libri Vjetor i Statistikave 1991). Feja nuk përben problem ndarjesh në Shqipëri.

Gjuhët: Shqipja (Toskerishtja është forma zyrtare; Gegerishtja flitet gjithashtu në disa pjesë të vendit); Greqishtja. Gjuha është me e rëndësishme se feja për identitetin e kombëtar të shqiptarëve.

GDP (vler. i 1999): 5.6 miliard USD pariteti i fuqisë blerëse, ose 1 650 USD për frymë.

Perqindja e GDP

shpenzuar për arsimin:

2.7% (vlerësim i 2000), me e ulët se 4% në fillim të periudhës së tranzicionit dhe 3.7% në 1995. Shpenzimet publike për arsimin si përqindje e totalit të shpenzimeve publike: 9.7% në 1999 (me e ulët se 11.4% në 1995, kur ishte shumë pranë parametërve mesatare të OECD prej

¹ Burimi: Instituti i Statistikave (INSTAT), Shqipëri.

² Burimet: CEPS, Ljubjana, bazuar në regjistrimin e popullsisë në 1989. Vlerësimet për Keshillin e Europës. (J.P. Liegeois, shih Referencat) tregonin se në 1994 kishte rreth 95 000 romë në Shqipëri (2.5% e popullsisë); sidoqoftë, shumë romë mund të jenë identifikuar si “shqiptarë” ose mund të mos kenë marrë pjesë në regjistrimin e 1989. (Shifrat “zyrtare” për romët mund të variojnë nga burime të ndryshme deri në 500%).

12.6%). Gjate viteve 90, shpenzimet totale per arsimin u ulen me rreth 35% ne shifra reale, regjistrimet me 15%, dhe shpenzimet per student me 20%.

Niveli i inflacionit (vler. 1999): 0.5% (çmimet e konsumit).

Papunesia: Papunesia e regjistruar (Ankete per Fuqine Puntore 1999): 17.1%. Papunesia tek te rinjte: 25.5% (nen 29 vjeç), me e larte tek meshkujt se tek femrat. 90% e te papuneve jane te tille prej me shume se nje viti. (1999) (Shifrat: INSTAT, CEPS). Vetem 3.5% e te papuneve perfituan prej projekteve trainuese ne 1999. Shiko tabelen 1 me poshte.

Nivelet e drejtimit arsimor: Tre. (1.) *Niveli qendror* (Parlamenti; Komisioni Parlamentar per Arsimin dhe Kulturen; Keshilli i Ministrave; Ministria e Arsimit dhe Shkences; Instituti i Kerkimeve Pedagogjike)
(2.) *Niveli lokal:* Rrethet, dhe Bashkite³ {Drejtorite Arsimore; Keshillat e Bashkive ose Komunave; Keshillat e Rretheve dhe departamentet e tyre te Arsimit dhe Shendetesise} (3.) *Niveli shkollor:* {Drejtori, Nendrejtori/et, keshilli i mesuesve, keshilli i prinderve, bordi i shkolles⁴}.

Hyrja dhe konteksti

Trojet ku shtrihet Shqiperia e sotme kane qene te banuara qysh nga Paleoliti dhe jane zbuluar gjithashtu shume qendra arkeologjike me interes nga Epoka e Neolitit, Bronxit dhe Hekurit. Çeshtja me diskutueshme eshte shfaqja e Ilireve, te cilet konsiderohen nga shumica e arkeologeve shqiptare si autoktone qe zhvilluan nje gjuhe dhe kulture te perbashket Ilire gjate Epokes se Bronxit. Te tjere besojne se Iliret kane ardhur ne Shqiperi ne kohen e qyteterimit Mikenas ne Greqi, dhe disa te tjere besojne se shfaqja e Ilireve nuk ka ndodhur para shekullit 10 para Krishtit. Fatkeqsisht, njohurite per gjuhen dhe kulturen e hershme Ilire jane te pakta – nuk kane mbijetuar mbishkrime apo fragmente te shkruara.⁵ Periudha Ilire zgjati deri ne vitin 230 para Krishtit, e pasuar nga periudha Romake (deri ne shek. 6 pas Krishtit) dhe periudha Sllave (shekulli 5-7 pas

³ Shqiperia ka 37 bashki qe mbulojne 320 komuna.

⁴ Bordi i shkolles eshte nje organ konsultativ qe perfaqeson komunitetin lokal. Ai ka fuqine t'i propozoje Drejtorise Arsimore emerimin e drejtorit, ose emerimin apo largimin e nje mesuesi, por jo çdo shkolle ka nje bord dhe jo te gjithë keto borde mund t'i ushtrojne ne praktike fuqite e tyre. Funkcioni i tyre kryesor eshte te sigurojne fonde jashte-buxhetore per shkollat.

⁵ Dokumentat e para te Shqipes se shkruar datojne ne shekullin 15 dhe kane te bejne kryesisht me ceremoni fetare (pagezime) dhe fjalore Latinisht-Shqip.

Krishtit) ne fund te se ciles heroi i madh i Shqiperise, Skenderbeu, udhehoqi rezistencen e fundit kunder Turqve.

Megjithë hisorinë e tyre të gjatë, shqiptarët mbeten populli më misterioz dhe më pak i njohur nga të gjithë popujt e Ballkandit. Historia dhe kultura shqiptare janë ndikuar thellësisht nga veçoritë gjeografike – është një vend i ashpër, ku më shumë se 2/3 e hapësirës dominohen nga male. Në jug, lumenjtë e mëdhenj fryhen nga shirat në male, dhe për shumë shekuj kenetat mbeteshin plot ujë në pranverë dhe në vjeshtë, deri kur drenazhimi modern solli përmirësimet e para.. Sidoqoftë, këto veçori gjeografike dhe klimatike e kanë bërë Shqipërinë një vend me komunitete të vogla e të izoluara, me një histori të gjatë mbretërisht të vogla dhe fisesh blegtorale. Më vonë, ndikimi grek në jug çoi në një nivel të caktuar “urbanizimi” dhe ndryshimi nga profesionet bujqësore në zejë – punime metali, poçeri, etj. Të tilla qytete rrethoheshin nga mure mbrojtëse, duke krijuar kështu ndarje të reja midis komuniteteve fqinjë dhe “qytetare”. Iliria (sidomos Iliria “qytetare”⁶) e përqafoi Krishterimin relativisht herët (shekulli 2 pas Krishtit) megjithëse nga shekulli 16 pas Krishtit e në vazhdim u përhap shumë ndikimi Islamik, veçanërisht mes Gegeve në Veri.

Historia e Shqipërisë qysh nga fundi i Luftës së Dytë Botërore ka qënë perseri një histori e mbushur me izolim nga ngjarjet Europiane dhe nderkombetare.⁷ Në 1944, kur mbaroi lufta për Shqipërinë, vendi ishte shkatërruar ekonomikisht si rezultat i pushtimit fashist, i infrastrukturës së vjetëruar, dhe rrenimit prej viteve të pushtimit, rezistencës, sabotimeve dhe aktivitetit guerril. Kishte shumë pak kapital, si financiar dhe në burime njerezore; dhe në këtë kontekst, ishte e natyreshme që Enver Hoxha dhe Partia (Komuniste) e Punes, dhe Shqipëria, të beheshin aleatë të Bashkimit Sovjetik. Qysh nga dhjetori 1944 mjetet e prodhimit ishin nën kontrollin e shtetit, për t’u pasuar nga reforma agrare në 1945 dhe eliminimi i sektorit privat në 1947. Pas çarjes së levizjes komuniste nderkombetare në 1960, Bashkimi Sovjetik ndërpreu mbështetjen teknike dhe financiare, dhe Shqipëria lidhi një aleancë të vështirë me Republikën Popullore të Kinës.

Gjatë gjithë këtyre viteve, Enver Hoxha mbajti nën kontroll të fortë pushtetin dhe zhvilloi një kult të shfrenuar individual dhe një vendim-marrje autoritare të tejperqëndruar e cila nuk u sfidua deri në vdekjen e Hoxhës në 1985. Pasketaj, u ndërmorr një program i kujdesshëm “liberalizimi” krahasuar me ndryshimet radikale në vendet fqinje (sidomos Rumaninë) në 1989-90. Protestat dhe emigracioni masiv u bënë të zakonshme. Në shtator 1990, reformat ligjore e çliruan sjelljen publike nga kontrolli i rreptë i shtetit, dhe gjatë dimrit 1990-91 u shemben të gjitha simbolet e shtetit njëpartiak, duke përfshirë edhe statujën gjigande prej bronxi të Enver Hoxhës në qendër të Tiranës. Zgjedhjet e para demokratike u mbajtën në mars 1991; megjithatë, destabiliteti vazhdoi gjatë gjithë vitit, duke përfshirë edhe një eksod masiv në Gusht, kur afro 25 000 njerëz rrembyen anijet në Durrës dhe i detyruan të lundronin drejt Italisë. Protesta për ushqimin e të tjerë (p.sh., shembja e “skemave piramidale” në 1997, jehona e luftërave në ish-Jugosllavi, sidomos në Kosovë, e më pas në Maqedoni) kanë penguar deri tani progresin

⁶ Termat *Shqiperi* dhe *Shqiptar* filluan të përdoren në kohën e Perandorisë Bizantine.

⁷ James Pettifer, 1994, f. 41.

politik dhe ekonomik. Ne disa pjese te vendit, pasiguria e vazhdueshme, zoterimi i armeve dhe veprimtari te bandave kriminale kane çuar ne rishfaqjen e fenomenit te vet-vendosjes lokale te “rregullit dhe ligjit” nga familje dhe grupe shoqerore te fuqishme, si edhe ne forma tradicionale te drejtesise komunitare (*kanun*), per te kompensuar mosfeksionimin e institucioneve shteterore, veçanerisht te policise dhe gjykatave. Mosbesimi mes ketyre klaneve fisnore apo grupeve shoqerore eshte shume i perhapur, dhe militon perkundrejt zhvillimit te nje shoqerie civile kombetare⁸.

Konfliktet sociale te 1991 dhe 1997 kane krijuar nje ndjenje te forte pasigurie e cila vazhdon te ndikojë ne jeten e perdritshme te shqiptareve, dhe ne qendrimet e tyre ndaj – dhe ne pjesemarrjen – shkollimit. Veçanerisht djemte e rinj terhiqen me shume nga jeta kriminale, shpesh ne banda, se sa nga arsimit; dhe shume prinder jane te frikesuar nga pasiguria ne shkolla, sidomos per vajzat e tyre.

Per me teper, trazirat e viteve 1991 e 1997 i kthyen shume shkolla ne “asgje me shume se guacka te demtuara pa asnje pajisje te domosdoshme baze per nje edukim te mire,”⁹ dhe veçanerisht ngjarjet e dhunshme te 1997 e minuan me tej besimin e njerzve tek stabiliteti politik dhe social i Shqiperise. Akoma egziston nje ndjenje se kaosi mund te rikthehet ne çdo moment, siç ndodhi, deri diku, ne Veri gjate dhe pas krizes Kosovare.

Kuadri Ligjor

Kushtetuta (1992, me Aktet Kryesore Kushtetuese te zbatuara ne 1992-95) shpreh te drejten e gjithe qytetareve per arsimim; shkollimi u mundesohet te gjitheve ne kushte te barabarta, dhe burimet per kete sigurohen nga buxheti i shtetit. Me tej Kushtetuta i jep Parlamentit autoritetin per te bere ligjet per arsimin, ndersa Qeveria (ne menyre te veçante Ministria e Arsimit dhe Shkences) eshte pergjegjese per hartimin e politikave arsimore dhe akteve ligjore dhe nen-ligjore.

Ligjt baze per sektorin e arsimit jane:

- Ligji per Sistemin e Arsimit Parauniversitar (1995).
- Aktet Normative per Shkollat Publike, Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise (1995).
- Ligji per Arsimin Privat (1995)
- Ligji per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise (1994).
- Krahas ketyre, MASH ka nxjerre nje mori rregullash (akte nenligjore) qe lidhen me arsimin, si per shembull, per vleresimin e studenteve, per

⁸ Nora Dudwick dhe Helen Shahriari, *Arsimi ne Shqiperi: Ndryshim Qendrimesh dhe Shpresash*. Shkurt 2000. Banka Boterore, faqe v. Ky vleresim shoqeror permban nje diskutim te detajuar te arsimit socialist dhe post-socialist ne Shqiperi, duke gjurmuar sjelljet sociale, marredheniet institucionale, aksesin dhe barazine, si edhe nje numur çeshtjesh te lidhura me Shqyrtimet Tematike te SEE.

⁹ *Ibid*, page 17.

pranimet ne shkollat e mesme e te larta, standarte per mesuesit, per trainimet kualifikuese te mesuesve ne detyre etj.

Sistemi Arsimor

Arsimi ne kisha dhe manastire filloi gjate periudhes Bizantine; shkollat e para Islamike u themeluan ne shekullin e 17. Shkollat e para fillore u shfaqen ne vitet 1890. Pas Nentorit 1912, Shqipja u be gjuha zyrtare dhe te gjitha bashkrite krijuan drejtorite arsimore. U hapen edhe institute te pergatitjes se mesuesve. Deri me 1939, 60 000 studente ishin regjistruar ne shkollat fillore dhe te mesme.¹⁰ Deri ne 1990, ishin regjistruar 906 000 studente, ose rreth 73.3% e popullsisë ne moshe shkollore (3-22 vjeç). Kjo shifer ra ne 719 000 ne 1997, nje renie prej 14%.

Mosha kur fillon arsimi i detyruar: 6 vjeç

Mosha kur perfundon arsimi i detyruar: 14 vjeç. Nese nxenesi ngelet, ai/ajo eshte i/e detyruar te qendroje ne shkollë deri ne moshen 16 vjeç.

Struktura e sistemit arsimor: Arsimi eshte falas ne te gjitha nivelet. Arsimi i pergjithshem perbehet nga ai tetevjeçar (4 vjet fillore + 4 vjet i larte) + 4 vjet arsim i mesem (jo i detyrueshem). Profesional: pas tetevjeçares arsim i mesem profesional 3 dhe 5 vjecar. Programet 5 vjeçare çojne ne provimet e Pjekurise. Programet profesionale 4 vjeçare u nderprene pas vitit 1998.

Piket e kalimit/provimet: Deftesa e tetevjeçares bazuar ne vleresimin e vazhduar dhe notat kaluese ne provimet shkollore. Numri i nxenesve perafersisht 54 000. Provimet e matures hartohen nga MASH (me shkrim + me goje) por vleresohen nga mesuesit. Numri i nxenesëve ne arsimin e pergjithshem afro 12 500; ne arsimin profesional 5 vjeçar: afro 15 000.

Arsimi i larte: Programe 4-, 5-, 6-vjeçare ne 11 institucione (39 fakultete/shkolla); programe jo-universitare (mesat) 3.5 vjet, ne 3 institucione. Pranimet totale ne 1999/00: afro 40 000, 15% e grupmoshes 18-23. Rritje kryesisht ne studentet e

¹⁰ N. Terzis, *Sistemet Arsimore te Vendeve Ballkanike: Çeshtje dhe tendenca*. Sistemi Shqiptar i Arsimit 2000: ff. 13 et. seq.

korrespondences: nga 20% te totalit ne 1990/91 ne 45% ne 1999/00.

Niveli e alfabetizimit:

I rritur nga 20% ne 1945 ne 89% nga fundi i viteve 1980; por eshte afro 75% keto vitet e fundit.

Pritshmeria per shkollim per femijet shqiptare mesatarisht 6 vjeçare (perjashtuar parashkolloret):

9.5 vjet (1998), 2 vjet me pak se ne 1989 dhe 6 vjet me pak se mesatarja per vendet e OECD (15.4 vjet).

Nivelet e arritjeve ne arsim:

8 vjet (arsim baze i detyrueshem) per 59% te popullsisë; arsim i mesem per 33% te popullsisë (20-59 vjeç, 1999).

Arsimi privat:

Ne 2000, kishte 2 543 femije ne kopshte parashkollore private; 4 717 ne shkolla fillore private; 1 975 ne shkolla te mesme private; dhe asnje student ne arsimin terciar (universitar) privat. Shkollat private regjistrohen dhe akreditohen nga MASH, dhe jane te detyruara te ndjekin kurrikulat shtetore edhe pse aty mund te mesohen edhe lende shtese.

Tabela 1. Papunesia Totale e Regjistruar (ne mije vete)

	1989	1992	1994	1996	1997	1998	1999
Femra	52	194	141	88	109	127	130
Meshkuj	61	200	121	70	85	108	110
Totali i te papuneve te regjistruar	113	394	262	158	194	235	240

Burimi: INSTAT: Zhvillimi i Tregut te Punes, Korrik, 2000. Cituar nga Francesco Panzica, Nentor 2000, faqe 43.

Tipare te Veçanta

Renia e pranimeve dhe problemet e braktisjes se shkolles. Nivelet bruto te regjistrimit per arsimin baze (klasa 1 deri 8), (Table 3) rane nga mbi 100% ne 1989 ne 90% ne 1998. Shifrat zyrtare te braktisjes se shkolles per arsimin e detyrueshem tregohen ne Tabelen 2.

Tabela 2. Niveli i braktisjes se shkolles gjate arsimit te detyrueshem

Vitet	90-91	91-92	92-93	93-94	94-95	95-96	96-97	97-98	98-99	99-00
%	3.9	6.3	4.1	4	3.1	3	3.2	3	3.01	2.8
Total	21 710	34 232	21532	20 939	17134	17 162	18 300	16 779	16 730	15 232

Burimi: MASH, Drejtoria e Statistikave, dhe CEPS-Ljubljana.

Nje Ankete per Matjen e Nivelit te Jeteses e bere ne 1996 tregoi se me shume se 35% e femijeve shqiptare, qe nuk vazhdonin shkollen ateher, dhane “mungesen e burimeve financiare” si arsye kryesore (41.4% ne zonat qytetare) ndersa afro 20% thane se “nuk ishin te kenaqur me cilesine e arsimit” (21% ne zonat fshatare).

Ne nivelin e arsimit te mesem (pas te detyrueshmit), reniet kane qene me dramatike, por jo per te gjitha llojet e arsimit. Ne total, renia ishte nga 78.6% e nxenesve ne 1989 ne 41% ne 1998. Megjithate, regjistrimet ne arsimin e mesem te pergjithshem *u rriten* nga 24.4% ne 1989 ne 34.9% ne 1998, ndersa ato ne arsimin e mesem profesional *rane* nga 54.1% ne 6.1%. Ne fakt, regjistrimet ne arsimin e mesem profesional *bujqesor* rane nga 49% ne 1990 ne 2% ne 1998, kryesisht per shkak te mbylljes se shume shkollave e ndermarrjeve profesionale bujqesore.

Regjistrimit ne nivelin e trete (universitar) ne pergjithesi jane rritur, por pothuajse e gjithë rritja eshte ne regjistrimet me korrespondence, nderkohe qe regjistrimet ne sitemin e dites (me shkeputje nga puna) jane rritur fare pak. Çështja e kerkesave per te hyre ne universitet dhe e provimeve te pranimit diskutohet ne detaje me poshte.

Arsimi i minoriteteve. Shqiperia ka dy minoritete te njohura zyrtarisht – Greket (kryesisht ne jug, p.sh. ne rrethet e Gjirokastrës, Sarandës, Delvinës dhe Permetit; dhe Maqedonasit (kryesisht ne pjesen veri-lindore te Shqiperise p.sh. rreth Korçës dhe Vernikut. Ka edhe te tjere grupe te vegjel etnike si Romët (endacake apo te vendosur), Vllehet ose Arumunet, etj. Kushtetuta (neni 20) thekson se minoritetet gezojne te drejta dhe liri te barabarta me ligj; se ato kane te drejten te shprehen lirshem, te drejten per te ruajtur identitetin e tyre etnik, kulturor, gjuhesor dhe fetar, si edhe “te drejten per t’u shkolluar e per te mesuar ne gjuhen e vet ametare”.

Infrastruktura e varfer. Banka Boterore vlereson se rehabilitimi ne nje nivel te pershtatshem i shkollave shqiptare do te kushtonte 270 milion USD (299.5 milion EUR).¹¹ Nje kombinim i ndertimeve fillestare me cilesi te dobet, me te pakten dy episode vandalizmi dhe shkaterrimi, dhe me mungesen kronike te mirembajtjes nder vite (rreth 35% e shkollave jane ndertuar para vitit 1960) do te thote qe shume shkollave u mungojne pajisjet dhe orendite fillestare si ngrohja, uji, elektriciteti etj.

¹¹ Sue Berryman, *Sektori i Arsimit ne Shqiperi: Probleme dhe Premtime*. Maj 2000, f .iv.

Tabela 3. Nivelet bruto te regjistrimit sipas niveleve te arsimit per grup-nxenesit 1989-98

Viti	1989	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998
<i>Parashkollor</i>	56.7	57.9	48.9	36.8	36.1	36.8	39.2	38.9	36.0	35.8
<i>Tetevjeçar</i>										
Total	100.9	102.1	99.3	97.3	99.4	100.4	100.3	99.5	97.1	93.9
Meshkuj	100.3	101.5	98.2	95.3	99.1	100.8	100.5	100.4	97.7	94.0
Femra	101.4	102.9	100.5	99.6	99.7	100.0	100.0	98.6	96.5	93.7
<i>I mesem i ulet</i>										
Total	103.4	102.5	96.2	90.8	90.7	92.5	91.4	91.5	91.1	90.1
Meshkuj	104.8	103.7	95.4	88.9	89.0	91.5	90.3	91.7	89.3	88.4
Femra	101.9	101.1	97.0	92.8	92.4	93.7	92.6	92.0	92.1	92.0
<i>I mesem i larte</i>										
Total	78.6	78.0	57.3	47.0	42.4	38.1	36.6	38.5	40.3	41.0
I pergjithshem	24.41	25.9	28.3	29.6	30.1	29.7	29.1	31.6	33.9	34.9
Profesional	54.14	53.1	30.0	17.4	12.3	8.4	7.5	6.9	6.4	6.1
<i>Niveli Universitar</i>										
Total	8.2	9.0	9.3	11.9	11.7	11.1	11.8	13.1	13.6	13.3
Sistem pa Shkeputje	6.6	7.0	7.6	8.3	7.8	6.9	6.7	6.6	7.0	6.9

Burimi: Zyra e Staistikave te Shqiperise, cituar ne Palomba dhe Vodopivec, op.cit. faqe 63.

Popullsia e ndryshueshme dhe ndryshimet demografike, varferimi i zonave fshatare, mbyllja e shume klasave dhe shkollave bujqesore, dhe “shperngulja drejt qytetit” per shkak te papunesise, trazirat dhe pasiguria kane çuar ne mbipopullimin e klasave ne qytete dhe periferi, ne mesimin me turne, dhe ne nje cilesi me te varfer te te nxenit. Per me teper, shume refugjate shqiptare etnike erdhen ne Shqiperi gjate krizes Kosovare, dhe se fundi asaj Maqedonase, dhe shumica prej tyre iu drejtuan (sidomos) Tiranes. Shume femije refugjate jane te traumatizuar, vijne nga ambiente te privuara, dhe kane probleme me gjuhen, strehimin dhe pershtatjen sociale.

Drejtimi dhe Administrimi i Arsimit

Modelet e drejtimit dhe administrimit të arsimit janë të ndryshme për vende të ndryshme të OCDE, por nuk mund të percaktohen si një vazhdimësi sistemesh tepër të centralizuara nga njëra anë dhe tepër të liberalizuara nga ana tjetër. Shumica janë diku ndërmjet këtyre dy ekstremeve; në vendet ish komuniste, tendenca është largimi nga modeli i centralizuar drejt atij më të decentralizuar, megjithatë shkalla e pushtetit që u delegohet autoriteteve lokale dhe shkollave është e ndryshme për vende të ndryshme në tranzicion.

Zgjedhja që bëhet secila qeveri varet nga vlerat të cilave ajo u jep përparësi, edhe pse këto kanë tendencën të jenë më tepër vlera politike se sa arsimore. Për këto arsye, levizjet e shpejta drejt decentralizimit politik në vendet post-komuniste jo gjithmonë kanë çuar në përmirësimin e kushteve për shkollat, studentet, apo mesuesit në nivel lokal. Një arsye është se buxhetet lokale nuk kanë qenë në gjendje të përballojnë kërkesat e reja që shtrohen para tyre nga ndryshimet në legjislacion; një tjetër arsye është se delegimi i pushtetit, vetëm në rastet e rralla, është shoqëruar me përgjegjësi të qarta për njësitë vendore për të cilat u duhet të japin llogari për cilësinë e shërbimit që ato ofrojnë.

Kushtetuta Shqiptare ofron edhe kuadrin ligjor për decentralizimin: “Pushteti Lokal në Republikën e Shqipërisë bazohet në decentralizimin e pushtetit, dhe ushtrohet sipas parimit të pavaresisë lokale”. Ndryshimi kryesor në strukturë ishte modifikimi i rolit të dy niveleve të qeverisjes lokale, (1) duke forcuar funksionet e bashkive dhe komunave si niveli bazë i autoritetit lokal, dhe (2) duke ndryshuar rolin e Këshillave të Rrethave nëpërmjet dhenies atyre të një funksioni më tepër koordinues se sa përgjegjësi direkte.

Në administratën publike, qeveria shqiptare ka ngritur një Bord Nderministror për Reformën Institucionale (Janar 1999) dhe ka filluar të zbatojë një Strategji për Reformën Institucionale dhe Administratën Publike që nga fundi i po atij viti. Strukturat organizative do të zvogelohen dhe standartizohen, dhe synimi është të inkurajohet lidhja horizontale mes institucioneve qendrore dhe të fillojë reforma ligjore. Tashmë janë kaluar një mori ligjesh që i përforcojnë këto ndryshime, dhe sjellin një hapje dhe transparencë më të madhe në administratën publike. Në arsim, në fund të viteve 1990, u kaluan ligje të reja mbi arsimin parashkollor, tërëjeçar dhe të mesëm, dhe, në kohën kur u bë vizita e grupit, ishte për diskutim në Parlament edhe një ligj për arsimin e lartë.

Nivelet e Drejtimit Arsimor

Parlamenti i Shqipërisë ka 155 anëtarë. Ka edhe një *Komision Special për Arsimin* me 8 anëtarë. Mbizoteron një konsensus i gjërë lidhur me rëndësinë dhe nevojat për zhvillimin e arsimit. Ligjet për arsimin parashkollor, tërëjeçar, dhe të mesëm janë vënë në zbatim në gjysmën e dytë të viteve 1990. Është duke ardhur në Parlament edhe një propozim për një ligj të ri për Arsimin e Lartë. *Këshilli i Ministrave* është bordi ekzekutiv kombëtar.

Ministria e Arsimit dhe Shkences (MASH) eshte pergjegjese per arsimin, *Ministria e Shendetesise (MSH)* eshte pergjegjese per kujdesin dhe arsimin parashkollor. Te gjitha shkollat jane prone e shtetit. *Ministria e Punes* ka pergjegjesine e trainimit te te papuneve, por vellimi i ketij trainimi eshte shume i kufizuar. *Instituti i Studimeve Pedagogjike te Shqiperise (ISP)*, nen mbikqyrjen e MASH, koordinon procesin e zhvillimit te kurrikalave.

Ne vend ka 36 *rrethe* dhe 65 *bashki*. MASH ka Departamente ne Rrethe misioni i te cileve eshte te keshillojne dhe kontrollojne shkollat. Bashkite kane *borde arsimore*.

Çdo shkolle duhet te kete nje bord shkollor. Sistemi i Bordeve Shkollore eshte i rendesishem dhe funksional. Sidoqofte, keto njesi jane teresisht te varura nga MASH.

Financa e Arsimit¹²

Gjate tranzicionit, burimet reale per arsimin kane rene nga 4% te GDP ne fillim te viteve 1990 ne 3.0% ne 1998 (niveli mesatar per 19 vende ne tranzicion ishte 4.8% ne 1998). Edhe shpenzimet reale per student pesuan renie, megjithate zvogelimin e numurit te studenteve. Si rezultat, mungesa kronike e burimeve e ka dobësuar sistemin vit pas viti, duke demtuar edhe cilesine e arsimit. Nga ana e saj, kjo gje ka ndikuar edhe ne menyren e perceptimit te *vleres* se arsimit, veçanerisht nga familjet e varfera, ato me shume femije ne moshe shkollore, dhe familjet fshatare me nivele te larta papunesie.

Jane te argumentuara tashme ndikimet e varferise ne ndjekjen dhe kohezgjatjen e shkollimit ne vendet ne tranzicion ne Europe dhe Azine Qendrore.¹³ Te varferit perballen me tre probleme persa i perket arsimit: (1) sistemi ne teresi nuk funksionon mire, dhe kjo ndikon tek te gjitha femijet ne pergjithesi, por femijet e varfer e vuajne me shume; (2) kostoja e arsimit per nje familje eshte rritur, per pasoje arsimit – si mall – konkuron me pretendime te tjera per tkurrjen e buxhetit familjar; (3) perfitimet e paramenduara prej arsimimit (te ardhura me te medha apo pune me te mira) mbeten te uleta, duke minuar keshtu motivet afatgjata per investim ne arsim. Megjithese akoma ka nje “shije” per arsimim, ka nje rrezik ne rritje qe femijet e varfer te braktisin arsimin dhe te bien vete ne varferi. “Sa me e ulet te jete cilesia e arsimit e sa me e kushtueshme te jete mundesia per te ndjekur shkollen, aq me e vogel do te jete mundesia per vazhdimin e shkolles”.¹⁴

Nuk ka dyshim se mungesa e burimeve financiare ne arsimin baze ne Shqiperi (fillor dhe tetevjeçar), ka ndikuar ne kerkesen per arsim. Sidoqofte, perfitimi privat (perfitimi i individit) nga arsimit baze eshte shume me i larte se perfitimi nga arsimit parashkollor dhe ai post-baze. Per Shqiperine, keto nivele perfitimmi jane llogaritur te

¹² Per nje analize te detajuar, lexuesi drejtohet tek tre studime te Bankes Boterore (shiko referencat), ne veçanti tek G. Palomba dhe M Vodopivec, *Financimi, Efijenca dhe Barazia ne Arsimin Shqiptar*, Mars 2000.
Nancy Van Dyke, *Akresi i te Varferve ne Arsimin ne Europe dhe Azine Qendrore: Te Dhena Paraprake dhe Rrjedhoja Politike*. Prill 2001. Punim per Diskutim Teknik. Washington: Banka Boterore, ECSHD.

¹⁴ G. Palomba dhe M Vodopivec, *op. cit.*, Mars 2000, f. 19.

jene 13 deri 16% per arsimin baze dhe 2 deri 4% per arsimin e mesem, dhe 2.5% per arsimin terciar (universitar). Ekipi i OECD eshte dakord me konkluzionet e nxjerra si nga UNICEF (1998) dhe Banka Boterore (2000) se qeveria shqiptare do te bente mire ti perqendronte burimet e saj ne sektorin e arsimit baze, se sa ne ate parashkollor apo pas-te detyrueshem (te mesem dhe te larte).¹⁵

Mbeturinat e se Kaluares

Diktatura e gjate komuniste e kombinuar me nje izolim te plote nga pjesa tjetere e botes ka lene te çara te thella ne psiqiken njerezore, strukturat organizative dhe te gjitha llojet e infrastruktures ne Shqiperi. Historia e viteve te fundit te arsimit shqiptar eshte akoma shume e ndikuar nga sundimi i regjimit te Hoxhes.

Pas dimrit 1990-91, kerkesa per stabilitet ne nje kontekst politik dhe ekonomik te paqendrueshem ka qene shqetesim si per komunitetin vendas edhe per ate nderkombetar. Gjate ketyre viteve te trazuara u vu ne pikepyetje aftesia e Shtetit per te qeverisur, dhe vetem tani po rishfaqet nje optimizem i kujdesshem. Sigurimi i rendit publik, reduktimi i varferise, dhe kontrollimi i krimit te organizuar jane ne krye te listes se axhendes qeveritare. Ne menyre te pashmangshme, dhe mbase me te drejte, keto konkurojne per burime me sektorin arsimor.

Arsimi nuk shikohet si kontribues vendimtar per zhvillimin ekonomik. Ai konsiderohet me teper si kosto se si investim. Strukturat qeverisese te shtetit dhe institucionet e tij mbeten teper te politizuara, dhe organet e shoqerise civile (p.sh. organizatat jo qeveritare) nuk gezojne mbeshtetje te mjaftueshme. Krijimi i komuniteteve te shendosha nuk eshte prioritet ne axhenden e kurrkujt, dhe pjesmarrja civile ne qeverisjen lokale ne pergjithesi – e ne veçanti ne arsim – eshte e kufizuar, megjithese ka edhe disa raste te suksesshme te komuniteteve qe kane filluar te marrin pergjegjesi per cilesine e shkollave te tyre. Zerat e aktoreve te ndryshem, te faktoreve dhe klienteve nuk degjohen fare dhe mekanizmat per te shprehur mendimin e tyre egzistojne vetem ne leter. Ka nje hendek te thelle midis teorise dhe praktikes demokratike. Siç u shpreh edhe nje mesues profesionist me eksperience: “Trashegimia kulturore e pese dekadave te autarkise dhe pasivitetit vazhdon te percaktoje jeten e perdritshme ne arsim dhe ne menaxhimin e tij”.

Rendi publik, reduktimi i varferise dhe arsimi, si pjese e saj, thuhet se jane perparsite e Shqiperise. Por, si shume vende te tjera ne tranzicion, Shqiperia ka nevoja shume te medha per te ndertuar dhe permiresuar infrastrukturen e vendit, duke perfshire rruget, ndertimet private e publike, kanalizimet e ujrave te zeza, furnizimin me uje te pijshem, menaxhimin e mbeturinave dhe te ambientit. Prandaj, percaktimi i prioriteteve eshte nje çeshtje e nderlikuar. Perveç kesaj, njerezit jane me te interesuar te permbushin nevojat afatshkurtra se sa investimet per te ardhmen.

¹⁵ UNICEF Qendra Nderkombetare per Zhvillimin e Femijeve, *Arsimi per Te Gjithe?* (1998). Projekti MONEE, CEE/CIS/Baltics. Raporti Monitorues Rajonal Nr. 5. Firence: ICDC, ff. 67-71; dhe G Palomba e M Vodopivec, *op.cit.*, f. 54.

Ne jeten politike, duhet te vendoset nje balance midis permiresimit konkret te kushteve te jeteses, dhe investimeve per zhvillim ne te ardhmen. "Arsimi" perjetohet nga mesuesit, nxenesit dhe prinderit e tyre si ambient i perditshem shkollor"; ndersa nga kendveshtrimi i ekonomise kombetare, "arsimi" eshte nje investim afatgjate. Duke qene se sektori arsimor eshte kaq i madh dhe kaq i varfer, çdo permiresim rrenjesor ne infrastrukturen arsimore te Shqiperise do te kerkonte pjesen e luanit nga burimet publike kombetare; prandaj, percaktimi i kujdesshem i prioriteteve ne gamen e gjere te nevojave te arsimit merr nje rendesi paresore.

Qeverisja publike ne Shqiperi mbetet akoma teper e politizuar. Nivelet rajonale te administrates jane te lidhura direkt me ministrite perkatese, duke perfshire ketu edhe MASH e Ministrine e Finances (MF). Bashkite jane shume te varura nga pushteti qendror, ndersa shpenzimet lokale financohen direkt (dhe jane pronesi) nga Shteti. Te ardhurat e vete pushtetit lokal jane shume te kufizuara. Kjo lloj strukture politike, dhe rivaliteti midis dy partive kryesore, kane shkaktuar nje tejpolitizim te sherbimeve publike. Edhe pse, ne krahasim me sektore te tjere, politizimi ne arsim nuk eshte aq i madh, ai vazhdon te mbetet nje faktor dominues ne administrimin e sistemit shkollor. Per pasoje reformat nuk kane vazhdimesi, jane te frgmentuara e te pakoordinuara, dhe potencialeve profesionale te drejoreve te shkollave nuk u lihet mundesi te shperthejne.

Struktura organizative e arsimit eshte e pafuqishme per nje vend me 2 200 shkolla dhe 700 000 studente. MASH eshte relativisht e vogel dhe pa mundesi te medha per te ndikuar, p.sh. ne financimin e shkollave apo per te shfrytezuar ne menyre te efektshme burimet egzistuese. Edhe organizatat e tjera ne nivel qendror nuk kane kapacitetin njerezor dhe institucional per te qene te dobishme per shkollat dhe mesuesit ne punen e tyre te perditshme e te veshtire. Niveli rajonal drejtohet drejtpersedrejti nga ministrite perkatese, Departamentet e Rretheve varen direkt nga MASH dhe Zyrat e Financave te Rretheve varen nga MF. Departamentet e Rretheve (37) nuk jane ne gjendje te zgjidhin problemet e shkollave. Zyrat e Financave te Rretheve kane detyren e rendesishme dhe dhe teknike te shperndarjes se parave sipas vendimeve te MF. Bashkite (65) jane te pafuqishme dhe nuk kane ndikim te ndjeshem apo burime per arsimin. Pajisja me tekste dhe cilesia e tyre jane te pamjaftueshme per t'i ndihmuar mesuesit, pa folur pastaj per zhvillim te mesimdhënies.

Pergjegjesi te Shperndara ne Nivelin Qendror

Procesi i pergatitjes se buxhetit eshte nje shembull se si shperndahen pergjegjesite ndermjet dy ministrive dhe departamenteve te MASH. Çdo bashki paraqet nje projekt buxhet ne zyren e rrethit, i cili nga ana e vet dergon nje projekt buxhet ne MF. Kopje te projekt buxheteve dergohen edhe ne MASH. Departamenti i Buxhetit ne MF pergatit buxhetin si pjese e tere buxhetit per shtetin. MASH dergon gjithashtu nje projekt buxhet ne Departamentin e Buxhetit. Drejtori i Finances ne MASH e diskuton me tej projektin me Drejtorin e Departamentit te Buxhetit ne MF. Eventualisht, MF aprovon sasine e parave qe i caktohet shkollave. MF u paguan grantet bashkive. Keto grante jane per arsimin, sherbimet shendetesore dhe per gjithë shpenzimet per te cilat bashkite jane pergjegjese. Me perjashtim te Departamentit te Finances, departamentet e tjera te MASH

nuk kane shume dijeni per menyren e caktimit te fondeve per ato pjese te sistemit arsimor qe jane nen pergjegjese direkte te MASH.

MASH eshte nominalisht pergjegjese per permbajtjen e arsimit. Por duke patur parasysh madhesine dhe angazhimin e perditshem te departamenteve per vendimet e detajuara, nuk ka hapesire qe ekspertet e MASH te perqendrohen ne ceshtje strategjike e te menaxhimit arsimor, apo te vihen ne udheheqje te percaktimit te permbajtjes se arsimit dhe pergatitjes se mesuesve ne Shqiperi. Keshtu, praktikisht jane Instituti i Kerkimeve Pedagogjike dhe shtepite botuese te teksteve shkollore - te drejtuara nga procedurat aprovuese te MASH – ato qe zhvillojne dhe zbatojne kurrikula dhe tekste.

Decentralizimi Vertikal

Eshte arritur nje konsensus i gjere mbi nevojën e decentralizimit te pushtetit dhe kompetencave te qeverisjes qendrore. Perceptimet kane ndryshuar, dhe eshte hartuar, ose eshte ne proces, legjislacioni qe do te sjelle kete ndryshim ne sistemin arsimor. Jane identifikuar gjithashtu edhe mekanizmat. Por “decentralizimi” vazhdon te jete akoma nje drejtim nga lart poshte.

Arsyeja per kete eshte se, ndersa kane ndryshuar perceptimet dhe legjislacioni, nuk kane ndryshuar sistemet e finances dhe te vendim-marrjes. Qeverisja lokale nuk ka as fuqine as burimet per te sjelle ndryshime ne sistemin e arsimit publik. Po keshtu, shkollat dhe faktoret e tyre – ndersa kane ne parim nje strukture te re menaxhuese dhe pergjegjesi me te medha menaxhimi – nuk disponojne as buxhetin operacional as fuqine per te marre vendime per ceshtje kyçe te menaxhimit si p.sh. rekrutimin e mesuesve apo vleresimin e tyre.

Ne te njejten kohe, duhet te marrim parasysh se faktet nuk mbeshtesin supozimin e zakonshem se decentralizimi ne menyre automatike do te nxise efektshmerine dhe barazine ne vendim-marrje. Ne fakt, persa i perket efektshmerise, eshte deshmuar se nocioni i efektshmerise se alokuar nuk eshte paresor per mireqenien e femijes ne rastet e vendeve ku nuk eshte permbushur ende e drejta e femijes per sherbime sociale baze. Ndikimi i decentralizimit ne ceshtje te barazise se aksesit, psh, mund te jete i demshem.¹⁶

Projekt-Strategjia per Zhvillimin e Arsimit ne Shqiperi

Strategjia u paraqit si projekt-strategji afatmesme e MASH. Ajo eshte nje dokument me game te gjere qe permban shume informacion rreth zhvillimeve te arsimit gjate dekades se fundit si edhe rekomandime per drejtimet e zhvillimit te arsimit ne te ardhmen. Duke qene kaq permbledhese, eshte e veshtire te kuptosh qarte cilat jane prioritetet horizontale dhe ato per secilin sektor; megjithate, caktimi i qarte i prioriteteve eshte esencial ne kushtet e burimeve te pakta. Per me teper, ekipi vleresues i OECD nuk mundi te percaktonte nese egziston ndonje konsensus mes faktoreve lidhur me permbajtjen e strategjise, dhe me hapat e tjere qe duhet te ndermerren.

¹⁶ Jeni Klugman, *Decentralizimi: Ankete nga Kendveshtrimi i Mireqenies se nje Femije*. UNICEF, Qendra Nderkombetare per Zhvillimin e Femijeve, Firenze 1997, faqe 46.

Eshte e diskutueshme nese Projekt-Strategjia Kombetare per Arsimin do ta permiresoje situaten. Kritikant per menyren e konceptimit jane perqendruar rreth mungeses se inpueteve nga faktoret e tjere, krahas qeverise dhe te varurve prej saj. Nje perfaqesues i sektorit jo-qeveritar p.sh. e pershkroi ate me ironi si nje proces “nga lart-lart” (se sa si nje proces “nga lart-poshte ose nga poshte-lart”). Inputi i faktoreve eshte i kufizuar. Dhe ndonese publikimi i projektit do te pasohet nga diskutime e debate, eshte e paqarte nese projekti do te konsiderohet si Flete e Bardhe e qeverise (ku mirepritet debati dhe diskutimi, por parametrat nuk ndryshojne), apo si Flete e Gjelber (ku debati e diskutimi mes faktoreve mund te çojne ne nje ristrukturim te permbajtjes dhe prioriteteve). Eshte gjithashtu e paqarte nese procesi i pritshem i ndryshimeve do te perfshije nje Plan Veprimi ne te cilin procesi i zbatimit do te marre te njejten sasi kohe, energjie dhe vemendjeje si procesi i konceptimit.

Çeshtje dhe Barriera ne Drejtim dhe Administrim

Nevojitet akoma shume pune urgjente per te restauruar infrastrukturen e sistemit arsimor. Nje nivel i arsyeshem i infrastruktures eshte nje parakusht per nje permbajtje te re dhe nje cilesi me te mire te rezultateve te te nxenit, per nje sistem kombetar arsimor te strukturuar me më shume efektshmeri, per nje motivim te ripertesire te studenteve per te ndjekur shkollen, dhe per zhvillimin e nje drejtimi me te mire. Prandaj, prioriteti i pare duhet te jete permiresimi i gjendjes fizike te shkollave. Mbase tani nuk eshte koha per procese te sofistikuara e te zgjatura per zhvillimin e menaxhimit.

Ndarja e pergjegjesive ndermjet niveleve dhe njesive te qeverisjes nuk eshte e qarte. Po ashtu nuk ka qartesi te mjaftueshme ne hapesirat e pergjegjesive ndermjet Ministrive te ndryshme.

Duket se nuk ka nje vleresim serioz te opsioneve dhe alternativave per ristrukturimin koherent te sistemit arsimor kombetar. Pjesemarrja ne arsim pas shkollimit baze ka pesuar renie dhe eshte me e uleta ne vendet ne tranzicion. Per shembull, ne Zyren e Kryeministrit, ekipi vleresues degjoi se rishikimi i rradhes i Ligjit per Arsimin Profesional do te ndryshoje strukturen e AP duke filluar programe 2-vjeçare studimi profesional, qe do te kene nje orientim te theksuar drejt tregut te punes. Edhe pse kjo mund te jete nje levizje e dobishme, nje strategji me e plote reformash per tere sistemin arsimor eshte me e nevojshme se sa keto “ndryshime” te pjesshme.

Mungesa e stabilitetit dhe e vazhdimesise ne drejtimin e arsimit, per shkak te presioneve politike. Edhe pse natyra e demokracise kerkon debat dhe konkurrence ndermjet ideologjive dhe ideve te ndryshme rreth zhvillimit te kombit dhe shoqerise, kjo nuk do te thote qe profesionalizmi te zevendesohet me emerimet politike te administratoreve te arsimit, drejtoareve dhe mesuesve.

Financimi i arsimit dhe kontrolli i shpenzimeve pothuajse nuk kuptohen. Ngaqe financimi i arsimit dhe i shkollave shperndahet te pakten ne dy ministri dhe ne shume autoritete lokale, mungon informacioni i qarte lidhur me burimet e shpenzimeve. Nuk ka te dhena te besueshme qe mund te perbejne bazen per nje vendim-marrje te informuar,

per shembull, lidhur me konsolidimin dhe racionalizimin e rrjetit shkollor per t'ju pergjigjur renies se regjistrimeve.

Mungojne transparenca dhe kriteret e financimit. Pjeserisht per shkak te shumellojshmerise se shperndarjes, financimi dhe shpenzimet e shkollave nuk raportohen ne asnje nivel qeverisjeje. Me perjashtim te vetem nje rregulli te qarte – qe MF paguan rrogat e mesuesve dhe personelit tjetër arsimor – nuk duket se egzistojne te tjera kriteret per financimin e shpenzimeve bashkiake dhe shkollore. Ne nje fare menyre alokimet e fondeve behen; por ekipi vleresues nuk mundi te zbulojte me saktesi mbi ç' baze behej kjo.

Ka fare pak ose aspak informacion te disponueshem per rezultatet e te nxenit. Shqiperia nuk ka tradite ne matjen dhe krahasimin e rezultateve e tendencave arsimore. Pervec nje njesie te vogel ne Institutin e Studimeve Pedagogjike (ISP), nuk ka struktura te tjera organizative per vleresim te jashtem te niveleve te te nxenit tek studentet, dhe as kapacitete te mjaftueshme per inspektim konsultativ te shkollave.

Mungesa e njohurive dhe aftesive per te ndihmuar reformen ne drejtimin e arsimit. Ndryshimet ne klimen politke dhe pikat e forta qe lidhen me te mund te jene nje nga arsytet e voneses se fillimit te nje reforme vendimtare ne arsim. Zhvillimi i kapaciteteve njerezore ne drejtimin e arsimit eshte nje parakusht per nje reforme kuptimplote.

Kurrikulumi

Kurrikulat per shkollat fillore dhe tetevjeçare zhvillohen nga MASH. Ato permbajne: lende te detyrueshme dhe disa me zgjedhje, permbajtjen e ketyre lendeve per çdo klase, sasine e oreve mesimore javore dhe vjetore, objektivat e mesimdhënies, dhe metodologjine. Bordet e Shkollave, qe i nenshtrohen aprovimit nga bashkia, vendosin per lendet me zgjedhje dhe gjuhete e huaja (te detyrueshme dhe me zgjedhje) qe do te mesohen ne secilen shkolle.

Ne klasat 1-4, te gjitha lendet zhvillohen nga nje mesues, ndersa lendet ne ciklin tetevjeçar (klasat 5-8) kane mesues lende. Disa shkolla kane (disa) mesues lende duke filluar qysh nga klasa 4 e ne vazhdim. Lendet e detyrueshme jane gjuha ametare, muzika, arti, shkencat natyrore, historia, gjeografia, fizika, matematika, biologjia, edukata qytetare, edukimi teknik dhe fizkultura. Lenda me zgjedhje ne nivelin shkollor baze eshte nje gjuhe e huaj e dyte, qe mund te filloje te mesohet qysh nga klasa 3 deri ne klasen 8 me dy ore mesimore ne jave.

Zhvillimi i kurrikulave eshte e vetmja pergjegjesi e ISP, por ka shume pak komunikim midis ISP dhe Universitetit qe pergatit mesues. Duhet vendosur nje komunikim me i mire mes ketyre te dyve. Zhvillimi i kurrikulave duhet te marre inpute si nga mesuesit edhe nga profesoret. Tekstet duhet te jene objektive dhe jo me ngarkese politike. Nje gje shqetesuese eshte se po pergatiten tekste te reja te historise qe nuk perfshijne periudhen 1990-deri sot! Instituti eshte shume i pergatitur dhe zhvilloi

seminare ne vitin 2000 per te informuar mesuesit mbi strategjine e re; sidoqofte, strategjia mund te ishte pergatitur nga nje grup me i gjere.

Reformat ne Kurrikulum

Klasat 1-4 dhe 5-8

Pas vitit 1992, u bene ndryshime ne mesimdhenien e lendeve te gjuhes Shqipe dhe letersise, si edhe u hoqen nga kurrikula Historia e Partise dhe stervitja ushtarake te cilat kishin orientim Marksist. U hartuan texte te reja, duke menjanuar permbajtjen Marksiste. Sociologjia, ekonomia e zbatuar, hyrja ne historine e filozofise u perfshine ne kurrikulum. U prodhua nje tekst per çdo klase, dhe u botuan me shume se 80 tekste te reja.

Ne sistemin parashkollor u pilotuan metoda te reja mesimdhenieje; kopshtet dhe shkollat egsistuese u forcuan nga rikonstruksioni i ndertesave te demtuara dhe ndertimeve te reja.

Nje pjese e mire e bazes materiale didaktike eshte riprterire dhe modernizuar, dhe politika eshte menjanuar ndjeshem nga tekstet. Ne permbajtje jane futur koncepte te reja. Jane permiresuar programet shkollore, dhe jane futur elemente te edukimit civik. Arsimi i pergjithshem dhe profesional kane pesuar ndryshime thelbesore si ne permbajtje edhe ne strukture.

Laboraret e shkollave te trasheguara nga sistemi i meparshem ishin te paket ne numur dhe “jo te pershtatshem...per kurrikulat ne proces ndryshimi”. Bibliotekat e shkollave jane nje pjese e rendesishme e edukimit ne shkolla e cila “ndihmon ne zhvillimin e shprehive te leximit dhe ne realizimin e objektiveve mesimore te letersise si edhe ne zgjerimin e njohurive per lendet e tjera”. Ne vitin shkollor 1998/99, Teknologjia Informatike u fut per here te pare ne 85 shkolla.

Projekt Strategjia Kombetare per Arsimin thekson nevojen urgjente per permiresimin e burimeve materiale (godina shkollash, biblioteka, laboratore, pajisje) dhe didaktike (mesimore) burime te tilla si plane mesimore, programe, tekste, manuale per mesuesit, si edhe pajisje audio vizuale dhe kompjuterike. Kurrikula dhe planet lendore parashikojne objektiva mesimdhenie e te nxeni per çdo klase, por mesuesit kane nevojte per perpunimin e grafikeve dhe planeve mesimore me te detajuara.

Nje tjetër program i ri eshte Projekti per Edukimin me Te Drejtat e Njeriut, qe u shtri ne te gjithë sistemin ne vitin 2001. Kane filluar plot projekte te tjera, por ne dallim nga fqinjët e saj, Shqiperia nuk ka qene ne gjendje te terheqe shume donatore. Pavaresisht nga kjo, koordinimi i masave dhe projekteve te donatoreve mund te permiresohet, dhe nderhyrja e donatoreve duhet te perqendrohet me shume ne *zbatimin* se sa ne prodhimin e raporteve pafund.

Kurrikulumi per Arsimin e Mesem, Klasat 9-12

Kurrikula per shkollat e mesme perfshin 15 lende qe mesohen ne 4 vite, ku çdo vit shkollor ka dy semestra me nga 17 jave secili. Dy vitet e para perfshijne letersi, histori, gjeografi, gjuhe te huaj, sociologji, matematike, fizike, kimi, biologji, teknologji dhe fizkulture. Ne vitin e trete shtohet filozofia dhe mesimi i kompjuterit zevendeson teknologjine. Ekonomia shtohet ne vitin e katert. Ne fund te vitit te katert studentet japin proviome ne gjuhe e letersi shqipe, matematike dhe fizike; keto provime jane me shkrim dhe me goje. Nuk jane te standartizuara, dhe per pasoje nuk jane te besueshme.

Nje ndryshim i madh ne kurrikulum ndodhi ne 1999-2000. Pas vitit te dyte te shkolles se mesme, studenti mund te zgjedhe nje “profil”, ose ne shkencat shoqerore ose ne ato natyrore. Ne fund te vitit te katert studentet japin provime ne profilet e tyre, si edhe ne gjuhen e letersine shqipe. Objektivi kryesor i ketij ndryshimi eshte terheqja e me shume studenteve ne shkollat e mesme.

Forma te Tjera te Arsimit te Mesem

Para vitit 1990, shkollat profesionale ofronin pergatitje teknike dhe bujqesore, dhe 70% e studenteve vazhdonin keto shkolla. Shumica e tyre me pas u mbyllen, dhe sot Shqiperia ka 43 shkolla profesionale nxenesit e te cilave perfaqesojne rreth 16% te grupnxenesve (16 000 nxenes). Kryesisht me ndihmen e OJQ-ve jane krijuar 35 profile. Disa prej tyre u pergjigjen nevojave te tregut. Per pese vitet e ardhshme eshte parashikuar nje reforme e gjere per te rritur pavaresine e ketyre shkollave e per t'i bere ato te plotesojne nevojat e ekonomise.

MASH-se i eshte vene ne dispozicion nje mbeshtetje e konsiderueshme nga vendet e OECD si edhe nga organizata te ndryshme. Si rezultat, jane krijuar shkolla “pilot” ne te gjitha vendin. Qellimi eshte te provohet dhe te zbatohet ne realitetin shqiptar sistemi i arsimit profesional i vendeve te zhvilluara. Shkollat pilot dhe ISP kane punuar se bashku per kualifikimin e mesuesve, menaxhimin, kurrikulat dhe pergatitjen e materialeve mesimore. Shkollat teknike e profesionale kishin nevojte per riparime pas trazirave civile te Marsit 1997.

Ne Shqiperi ka edhe 5 shkolla gjuhe me 2 366 studente. Keto shkolla pergatisin studente per mesimdhenien e gjuhes Angleze, Gjermane, Italiane, Franceze, Spanjolle dhe Ruse. Ka edhe 1 151 studente ne 8 shkolla qe pergatisin studente ne muzike dhe artet e bukura. Krahas ketyre, jane edhe dy shkolla sportive qe pergatisin atlete per te konkuruar ne nivel kombetar dhe nderkombetar. Kater shkolla pedagogjike ne kater qytete pergatisin mesues per arsimin baze ne zonat fshatare. Ne Shqiperi lejohen dhe inkurajohen edhe shkollat private per shkak te mbipopullimit te shkollave ne zonat qytetare.

Tekstet

Me ligj, pergatitja dhe botimi i teksteve per shkollat eshte pergjegjesi e MASH dhe institucioneve te saj te specializuara. MASH vendos se çfare tekstesh nevojiten per te gjitha klasat e arsimit parauniversitar, dhe panele ekspertesh nga ISP bejne vleresimin e doreshkrimeve per pershtatshmerine e perdorimit te tyre ne shkolla. Me pas, Shtepia Botuese e Librit Shkollor (SHBLSH) pergatit tekstet per te gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, ndersa Shtepia Botuese e Librit Universitar (SHBLU) pergatit tekstet per arsimin universitar. Shperndarja e tyre pergjithesisht behet nga Ndermarrja e Shperndarjes se Librit Shkollor.

Per vitin 1998/99, u botuan 95% e titujve qe nevojiteshin per perdorim ne shkollat baze duke plotesuar keshtu kerkesat e tere mases se nxensve. Krahas kesaj, shtepite botuese per tekste e materiale mesimore pergatisin gjithashtu edhe materiale te tilla si guida per mesuesit, lexuesit etj. Per arsimin e mesem shtepite botuese botojne libra per lendet e detyrueshme, dhe jane ne gjendje te mbulojne rreth 70% te numurit te librave te kerkuara.

Para vitit 1990, Shtepia Botuese Shteterore kishte nje departament te veçante per materialet parashkollore; ai u shperbe ne 1990 dhe qysh atehere nuk prodhohen me libra ose materiale per parashkolloret. Kohet e fundit, eshte ngritur nje departament special per parashkolloret per te prodhuar libra te rinj per te vegjelit, te cilet shpresohet ta permirsojne situaten.

Me nje projekt te Bankes Boterore ka plane per ta bere te hapur furnizimin me tekste duke inkurajuar botuesit e librave te hyjne ne nje proces konkurues tenderimi. Po ashtu ka plane edhe per privatizimin e shperndarjes se teksteve, ose per hapjen e tij ndaj konkureses.

Çeshtje dhe Barriera ne Kurrikulum dhe Tekste

Reformat e sistemit politik dhe administrates publike per fat te keq nuk gezojne mbeshetje te plote nga popullsia. Fale eksperiencave te meparshme, njerezit nuk kane shume besim as tek politika as tek administrata. Ne shume diskutime me partneret tane atje, per te zgjidhur konflikte dhe probleme shqiptaret perballen me struktura klanore para-demokratike ose me korrupsion te mirfillte. (shiko rekomandimet)

Menyra se si e trajton shoqeria ne pergjithesi çeshtjen se çfare roli kane luajtur aktoret e sotem ne sistemin e komunizmit shqiptar eshte e nje rendesie themelore per tere hapesiren e zhvillimit te burimeve njerezore ne pergjithesi dhe per ate te arsimit ne veçanti. (shih rekomandimet.)

Menyra se si i kuptojne mesuesit ndryshimet qe priten prej tyre ne permbajtje dhe aftesi eshte shpesh krejt e ndryshme nga politikanet, mbase ngaqë ata marrin drejtim dhe trainim te shkurter dhe te siperfaqshem. Keshtu, mesuesit tentojne t'i ndryshojne veprimtarite e tyre ne klase, por pa nje kuptim konceptual te arsyeve per keto ndryshime.

Rezultatati është që aktivitetet strukturohen në mënyrë të tillë që nuk janë synim i asaj axhënde ndryshimi. Mesuesit kanë tendencë t'i interpretojnë dhe zbatojnë politikat e reja të mesimdhënis nën dritën e eksperiencës, besimeve dhe njohurive të veta. Ky fenomen ndodh edhe në kualifikimet e mesuesve në detyrë.

Planifikimi për të ardhmen është i vështirë për shkak të mungesës së njohurive mbi numrin e studenteve në vend. Derisa të bëhet një regjistrim i saktë i popullsisë, është e pamundur të dihet sa femije braktisin shkollën, apo sa studente potenciale nuk janë në shkollë. Një nga shkaqet më të mëdha të mosndjekjes së shkollës është varferia në zonat fshatare ku prindërit kanë nevojë që fëmijet e tyre të punojnë në shtëpi.

Mesuesit e kualifikuar për të braktisin profesionin për shkak të pagave të ulëta dhe mungesës së statusit. Ato janë gjithashtu të stresuar nga mungesa e inputeve; nuk janë të motivuar pasi janë shpesh skllevër të teksteve dhe nuk kanë mundësi për të qenë krijues. Disa drejtore shkollash i nxisin mesuesit të sjellin materiale nga jashtë në klase, të gjejnë zgjidhjet e veta, të fillojnë mesimin me ekip, por këto janë vetëm një pakicë.

Decentralizimi dhe angazhimi i komunitetit në shkollë janë çështje të rëndësishme. Përdorimi jashtëkomunitar i shkollave do t'u jepte të gjithëve "pronesinë" e shkollave të tyre lokale. Shkollat lokale mund të menaxhohen si qendra të edukimit komunitar, por edhe si qendra shërbimi për nevojat mesimore të nxënësve. Për t'i arritur këto qëllime nevojiten shumë ndryshime: zhvillimi i udhëheqjes lokale, trainimi për menaxhim arsimor i drejtoreve të shkollave lokale dhe të drejtoreve; alokimi i fondeve që buxhetet të jenë të disponueshme për përdorim nga drejtoret e shkollave pa vonesa burokratike; përcaktimi i detyrave me synim menaxhimin e mbivendosjes; dhe zhvillimi i kritereve cilësore për të gjitha nivelet e sistemit arsimor.

Shkollat pilot konsiderohen si instrumente për rinovim e për të treguar atë çka është e mundur, për të inkurajuar mesues të tjerë të punojnë me to, për rikualifikime dhe për përgatitjen e mesuesve, gjithashtu. Një tjetër kontribut për zhvillimin profesional do të ishte përhapja e përvojave dhe e rezultateve të trainimeve.

Vleresimi i Rezultateve te te Nxenit

Sistemi aktual i vleresimit dhe provimeve

Vleresimi ne arsimin parashkollor

Ne sistemin parashkollor, i cili nuk eshte i detyrueshem dhe mbulon moshat 3-6 vjeç, nuk ka vleresim sistematik. Ne momentin e regjistrimit shkollat mund te kerkojne kartelen mjekesore te femijes, por mesuesit nuk jane te trainuar per te vezhguar veshtiresite e mundshme te te nxenit. Sidoqofte, perderisa jo te gjithë femijet e kesaj grupmoshe ndjekin shkollen, nuk dihet asgje per pjesen tjetër deri kur ata vijne ne klasen e pare. Disa programe te futura rishtas per parashkolloret si psh. “Hap pas Hapi”, bejne vleresimin e disa elementeve te gadishmerise per shkolle deri ne momentin kur femija eshte ne moshe per klasen e pare, por nga kjo perseri perfitojne nje numur i vogel femijesh.

Vleresimi i vazhduar ne klasat 1-4

Ne kater e vitet e para te fillores, vleresimi i nxenesve eshte teresisht mbi baze shkolle e klase. Objektivat e arsimit tetevjeçar per secilen klase jane te shprehura qarte ne udhezimet per mesuesit (1-8) dhe ne kapituj te ndryshem qe mbulojne permbajtjen vjetore. Mesuesit i vleresojne nxenesit permes nje shumellojshmerie metodash, duke perfshire pyetje me goje, kuize te shkurtra ose provime kapitulli, pune ne klase apo shtepi. Dy here ne vit, çdo nxenes merr nje note vleresuese pergjithesuese per secilen lende; keto perfshihen ne vleresimin final me note ne fund te vitit. Kalimi nga klase e pare ne te dyten eshte automatik; me pas kalimi nga nje klase ne tjetren bazohet ne vleresimin e mesuesit (provime me goje). Nxenesi qe ngel (dmth qe merr nje note me te ulet se 5 ne nje shkalle 1-10 ku 10 eshte me e larta) ne dy lende ose me pak, lejohet te hyje ne “provimet e vjeshtes”; nqs eshte i suksesesshem, nxenesi kalon, ose perndryshe ai/ajo perserit vitin. Vleresimi ne baze shkolle kontrollohet nga autoriteti lokal i arsimit permes inspektoriatit.

Perfundimi i klases 8

Lendet me provim jane matematika dhe gjuha shqipe. Nga 1996 ne vazhdim, nje komision i vogel nga MASH dhe ISP perpilojne pyetjet e provimeve per te gjithë vendin, me qellim qe te mund te futen elemente te standartizimit dhe krahasueshmerise ne provimet shqiptare. Komisioni i Provimit per secilen shkolle (i perbere nga drejtori i shkolles, mesuesi i lendes, dhe nje mesues tjetër i te njejtës shkolle) shkruan çeshtjet ne derrasen e zeze, dhe te gjithë nxenesit i kopjojne ne fletet e tyre. Provimi zgjat 4 ore. Ne çdo shkolle shkon nje perfaqesues i autoritetit lokal arsomor per te mbikqyrur zhvillimin korrekt te provimit. Komisioni i Provimit korrigjon provimet dhe vlereson nxenesin me nje note perfundimtare; kjo note permbledh edhe noten e marre ne provimin me goje, me vlere 50% per provimin me goje dhe 50% per ate me shkrim. Shkolla i jep nxenesit nje deftese.

Perfundimi i klases 12

Ky eshte mbarimi i shkolles ose i ashtuquajzuri “provim i Matures”. Lendet qe jepen provim perfshijne matematiken, fiziken dhe letersine Shqiptare, me shkrim dhe me goje. Proçedura eshte siç u pershkrua per klasen 8, me perjashtim te faktit se nje perfaqesues i MASH ose i ISP (jo autoritetet lokale) sherben si vezhgues i jashtem. Gjate provimeve me goje, duhet te jete prezent te pakten edhe nje mesues tjetër përveç mesuesit te lendes se vete studentit.

Pranimi ne universitet

Ne vitet e meparshme, konkurset e pranimit ne universitet bazoheshin ne nje sistem 100 pikesh, deri ne 30 pike nga te cilat kandidati i fitonte nga rezultatet e veta ne kater vitet e shkolles se mesme. 70 piket e mbetura u liheshin fakulteteve per rezultatet ne provimin e pranimit, pjesa e specialitetit, qe hartohet dhe vleresohej nga pedagoget e universiteteve. Fakultetet publikojne “programet” e veta per secilen lende dhe studentet, qe duan te konkurojne per nje vend, i studiojne keto “programe” gjate veres deri ne provimet e pranimit ne universitet ne fillim te Shtatorit te çdo viti.

Sistemi, veçanerisht 30 piket e fituara prej mesatares se shkolles se mesme, u vleresua se krijonte mundesi per abuzime. Ne 1998, Ministri shpalli ne televizion se duke filluar nga 1999/2000 nuk do te merreshin me ne konsiderate as nota mesatare as notat e provimeve perfundimtare te shkolles se mesme (qe perbenin rreth 30 nga 100 “piket” e mundshme per pranim ne Universitet) dhe se i vetmi kriter perzgjedhjeje do te ishin provimet e pranimit ne universitet. Ai gjithashtu deklaroi se pedagoget e universiteteve do te ndihmoheshin nga mesuesit e lendeve per te percaktuar kerkesat e provimeve te pranimit dhe se çdo Universitet – madje çdo fakultet – do te caktonte kerkesat e veta pa asnje perpjekje per barazi apo standartizim mes Universitetve.

Megjithese angazhimi i mesuesve te lendeve ishte nje hap i madh perpara, rreziket ketu ishin te qarta. Se pari, kurrikulumi i shkolles se mesme do te dominohej teresisht nga ato njohuri qe mesuesit besojne se do te kerkohen nga universitetet (edhe pse vetem afro 30% e atyre qe mbarojne shkollat e mesme vazhdojne universitetet), dhe universitetet do te ishin *de facto* pergjegjes per kurrikulumin e shkolles. Se dyti, meqenese gjithçka do te varej nga nje provim i vetem (me cilesi teknike te dyshimte), pranimi ne universitet do t’ia kalonte madje edhe nje lotarie, me kerkesat me te larta se kurre, dhe me rritjen ne proporcion me to, te rrezikut per korrupsion dhe ryshfete.

U arrit nje kompromis interesant permes te cilit ISP dhe komisionet e eksperteve hartojne pjesen e “njohurive te pergjithshme” te provimit te pranimit prej nente lendeve shkollore (60% te notes perfundimtare), ndersa pjesa e dyte e provimit, pjesa e specialitetit lendor, hartohet nga çdo fakultet (40% e notes perfundimtare). Ky sistem u zbatua per here te pare ne Shtator 1999. Ishin afro 9 000 kandidate qe moren pjese ne 15 mije provime.¹⁷ Çdo provim zgjat 5 ore dhe perbehet prej nje numri shume te madh

¹⁷ Studentet lejohen te aplikojne per nje vend ne me shume se nje universitet; ne se fitojne ne me shume se nje, atehere ata mund te zgjedhin preferencen e tyre.

pyetjesh (mbi 150); si kohezgjatja edhe ngarkesa e provimit duken te tepruara dhe ekipi shpreson qe ato tashme te jene reduktuar. Pavarsisht nga kjo, procesi duket se ka shkuar relativisht qete, megjithese cilesia teknike (besueshmeria, vleftshmeria) e provimeve te hartuara mbetet e dyshimte, sidomos pjesa e hartuar nga stafet e universiteteve ku rregullat baze te matjeve arsimore kuptohen fare pak ose aspak.

Sidoqofte, deri kur te funksionojne provime te besueshme mature, ka shume pak mundesi qe Universitetet te braktisin krejtesisht praktiken e provimeve te veta te pranimit.

Hapi pasues ne vleresimin e rezultateve te te nxenit

Vleresimi eshte nje çeshtje e rendesishme ne Shqiperi. Ka pasur disa zhvillime pozitive; u krijua nje Qender e re (Qendra e Hartimit dhe Vleresimit te Provimeve ose QHVP), prane ISP ne 1994, me nje personel prej dy tre personash. Nje projekt i financuar nga Banka Boterore mbeshteti pajisjen dhe trainimin e eksperteve te stafit te saj qe po rritet ndjeshem. Stafi kyç i Qendres u specializua jashte, ne ETS (SHBA), CITO (Hollande), UCLES (Bitani e Madhe), dhe ne Sherbimin Kombetar te Vleresimit dhe Provimeve (NAES) ne Rumani. U zhvilluan gjithashtu disa workshope dhe seminare trainimi brenda vendit te cilat bene te mundur qe stafi i Qendres, specialistet dhe mesuesit te trainohen per çeshtje te vleresimit, duke ndertuar keshtu kapacitete per te ardhmen.

Krahas pergatitjes se pjeses se pergjithshme te provimit te pranimit ne universitet, qendra ka kryer me sukses edhe vleresime kombetare me baze modeli ne klasat 4, 8 dhe 12 ne tre lende kryesore, si psh. Matematike, gjuhe shqipe, dhe gjuhe te huaj; dhe stafi i Qendres punon me mesuesit ne shkolla per permiresimin e shprehive te vleresimit te studenteve.

Me nje projekt te dyte te Bankes Boterore, qendra e vleresimit pritet te kthehet ne nje organizate gjysem te pavarur, duke mbetur nen kontrollin politik te MASH por jo më pjese e ISP. Qendra do te vazhdoje punen e saj per provimet kombetare, per krijimin dhe ruajtjen e bankave te tematikes se provimeve, per provimet e pranimit ne universitete, dhe per vleresimin e nxenesve ne klasen 4. Ajo gjithashtu do te marre pjese ne studime krahasuese nderkombetare si Tendencat-TIMSS dhe OECD/PISA, dhe do te krijojte lidhje me agjenci testimi ne vende te tjera.

Ekspertet qe punojne ne ose me qendren tashme kane bere shume pune te mira. Me pavaresine e Qendres, sidoqofte, do te shfaqet nje grup i ndryshem problemesh. Me i rendesishmi do te jete mbajtja e vete Qendres kur te mbarojne financimet nga jashte. Mes anetareve te ekipit te OECD u shtrua pyetja nese do te ishte i pershtatshem per Shqiperine nje sistem provimesh te jashtme ne fund te shkolles se mesme (siç eshte futur tashme ne shume vende te CEE dhe SEE). Nuk eshte vetem çeshtja e koston se fillimit dhe vazhdimit te nje projekti te tille, por edhe fizibiliteti i berjes se provimeve te centralizuara nga Tirana, duke patur parasysh infrastrukturen shume te varfer te vendit dhe nivelet e larta te korrupsionit qe iu raportuan ekipit. A ia "vlen vertete" te ndryshohet sistemi aktual? Neqoftese po, kush do te perfitonte nga kjo? Do te ishte me vlere te vezhgoheshin nje mori metodash dhe protokollesh vleresimi te zhvilluara ne gjithe boten. Shqiperia

duhet te shqyrtoje me kujdes burimet e disponueshme, dhe pastaj te vendose çka do te ishte me e pershtatshme duke patur parasysh kushtet e veçanta te vendit.

Megjithate, nuk do te kishte kuptim perpjekja per permiresimin e kurrikulave, teksteve dhe trainimit te mesuesve nese nuk do t'i kushtohej vemendje *rezultateve* – dmth, permiresimit te *rezultateve te te nxenit*, dhe matjes dhe raportimit te tyre te besueshem dhe te vlefshem. Gjithnje e me shume vende ne bote po perdorin informacion bindes rreth te nxenit te studenteve per te zhvilluar nje politike te bazuar ne fakte. Per fat te keq ne Shqiperi, - si ne shume vende ne tranzicion – te dhenat nga rezultatet nuk perdoren per te mbeshtetur vlerisime strategjike dhe vendime politike. Shkollat rralle shohin pertej mureve te tyre; drejtoret e arsimit ne rrethe nuk dine pothuajse asgje se çfare ndodh ne rrethe te tjera. Sidoqofte, futja e strukturave te reja drejtuese – sidomos vendim-marrja e decentralizuar – do te kerkoje sisteme per informacionin menaxherial ne te gjitha nivelet, dhe te dhena te besueshme per rezultatet e studenteve do t'i ndihmojne shkollat te monitorojne arritjet e veta ne kohe si edhe t'i krahasojne ato me arritjet e shkollave te tjera, si brenda edhe jashte Shqiperise.

Çeshtje dhe Barriera ne Vleresim

Standardet kombetare per permbajtjen dhe arritjet nuk jane vendosur akoma per te gjitha lendet, klasat, dhe gjithë aftesite duke perfshire ato qe mesojne ngadale dhe ato qe jane me te afte. Megjithese eshte bere shume pune e mire, deri tani nuk ka nje strategji koherente *per tere sistemin* per percaktimin e te tilla standardeve; pa keto standarde si kufij referimi, vleresimi i arritjeve nuk mund te kete kuptim.

Nxenesit mbase mbi-testohen por nen-vleresohen persa i perket shprehive te ndryshueshme. Te rinjte shqiptare, si ato ne vende te tjere ne tranzicion, kane nevojte te pergatiten per nje bote ku atyre do t'u duhet te bejne zgjedhje intelektuale, te zgjidhin probleme te paparashikuara, dhe te marrin pergjegjesi per te gjetur rrugen e vet ne nje ekonomi qe ndryshon shume shpejt. Asnje nga keto shprehi nuk çmohej nga sistemi i vjeter – ekonomite e planifikuara nga qendra theksojne mesimin e fakteve te perzgjedhura me kujdes, sepse nuk lene vend per pasiguri, dhe nuk nxisin mendimin e pavarur. Ne te kundert, jeta ne nje ekonomi tregu do te thote qe shume te rinj do te ndryshojne pune e profesion disa here gjate jetes se tyre, dhe per ta bere kete ata kane nevojte me shume per mendim te pavarur dhe shprehi te te nxenit se sa per fakte.

Futja e vleresimeve dhe provimeve te stilit te ri duhet bere me faza qe ato te mund te reflektojne dhe perforcojne kurrikulat e reja dhe tekstet e reja, dhe qe mesuesit e drejtuesit te mund te trainohen per perdorimin dhe interpretimin e tyre. Per momentin, shume mesuesve e nxenesve u duhet te punojne akoma me burimet egzistuese qe jo gjithmone i pershtaten ndryshimeve qe po behen.

Reagimi publik dhe politik ndaj ndryshimeve ne sistemin e vleresimit dhe te provimeve. Ketu ka dy çeshtje kryesore. Se pari, egziston nje shqetesim arsimor se provimet e jashtme me kerkesa te larta mund te kene nje ndikim negativ mbi procesin e mesimdhënies dhe te nxenit ne klase dhe mund te sjellin ngushtimin e kurrikulumit ne ato

çeshtje që testohen. Se dyti, është edhe shqetësimi *politik* se, nëse provimet janë rigorozë, me pak nxënës do t'i kalojnë dhe shumë të tjerë do t'u mbyllën dyert për edukim të metejshëm dhe për punësim. Që të dy janë shqetësime të ligjshme dhe duhen pranuar hapur me qëllim që të behen hapa për të zvogëluar ndikimet e tyre.

Ka mpleksje interesash (sidomos në rrafshin e arsimit të mesëm dhe të lartë) që mund t'i rezistojnë ndryshimit. Gjithashtu, një vlerësim me rigoroz mundet që fillimisht të rrisë ritmet e ngeljes së studentëve, gjë që do të sjellë shqetësime dhe presion mbi politikanet për të braktisur reformat (shumë të nevojshme).

Mesuesit dhe Trainimi i mesuesve

Zhvillimi ekonomik dhe social i një vendi varet nga burimet njerezore të mirë-arsimuara, dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet një sistemi arsimor të efektshëm i cili ka mesues dhe drejtues shkollash që kanë marrë trainimin e duhur fillestar dhe vazhdojnë të trainohen në detyrë për të qenë bashkëkohorë. Sidoqoftë, situata ekonomike dhe procesi i menaxhuar jo mirë i tranzicionit në Shqipëri kanë ushtruar një ndikim shumë negativ mbi sistemin arsimor përmes rënies së pjesëmarrjes në arsimin parauniversitar, dallimeve në zhvillimin fshat/qytet, migrimit të popullsisë fshatare drejt zonave qytetare, statusit të ulët të mesuesve, ambientit të varfër mesimor, varferisë dhe përfitimeve të ulëta private dhe shoqërore në tregun aktual të punës nga arsimimi.

Është e nevojshme të behen ndryshime në të gjithë aspektet e sistemit. Siç thuhet edhe në Strategjinë Afatmesme të MASH¹⁸ “ situata në arsimin parauniversitar nuk është normalizuar akoma”. Kjo është arsyeja pse MASH i ka dhënë prioritet normalizimit të sistemit arsimor, rritjes së efektshmërisë dhe cilësisë së mesimdhënies dhe të nxënësve. Mesuesit janë në qendër të gjithë këtyre problemeve themelore.

Gjendja aktuale e mesuesve në Shqipëri

Në 1998/99, kishte 39 417 mesues definitive (përfshirë sistemin universitar) në Shqipëri (shih tabelën A 30 tek Berryman¹⁹): 4 092 në parashkollor, 29 428 në arsimin baze 1-8, dhe 5 897 mesues në arsimin e mesëm. Ka afro 450 persona staf mesimor profesional në 41 shkolla profesionale. 2/3 e tyre japin lende profesionale teorike dhe 1/3 është e angazhuar në mesimin e praktikës profesionale. Duke gjykuar nga statistikat e disponueshme, në kontrast me shumë vende të tjera në rajon, Shqipëria përçon një arsim relativisht të efektshëm parauniversitar, duke u nisur nga statistikat e përdorimit të stafit mesimor dhe infrastruktures.²⁰ Por kjo behet në kurriz të zvogëlimit të ofrimit të shërbimeve cilësore arsimore në zonat fshatare, të klasave të tejmbushura në zonat qytetare, dhe aftësisë së sistemit për të terhequr mesues të kualifikuar.

¹⁸ Republika e Shqipërisë, MASH, Kabineti i Ministrisë. Mars, 2000. “Strategjia Afatmesme e MASH” (Projekt), Tiranë.

¹⁹ Berryman, Sue E. May, 2000. “Sektori i Arsimit në Shqipëri: Probleme dhe Premtime”. (Projekt Diskutimi, jo për t'u cituar). Banka Botërore.

²⁰ *Ibid* shifra 2.11, 2.13, tabelat A 39.

Mesuesia eshte nje profesion me status te ulet ne Shqiperi; prandaj ky profesion nuk terheq studentet me te mire. Departamentet universitare qe pergatisin mesues nuk konsiderohen prestigjioze, dhe terheqin kandidatet me cilesi te ulet dhe medioker. Megjithese ekipit te OECD nuk iu dhane te dhena te sakta, vleresimi nga Universiteti i Elbasanit (takim me Rektorin) eshte se vetem 30%-40% e studenteve qe mbarojne programe mesuesie shkojne te punojne direkt ne shkolla. Kushtet e veshtira qe po kalojne mesuesit kane nje ndikim negativ.

Pergjegjesine per te emeruar personelin e shkollave e kane vetem 37 Drejtorite Arsimore (DA eshte ne thelb nje dege e MASH). DA i jep MASH shifren e nevojshme te shpenzimeve per pagat per vitin pasardhes. Pushteti lokal, *bashkia/komuna* (autoritete bashkiake/te rrethit) nuk ka fuqine te ndikoje ne alokimin e fondeve apo ne emerimet e personelit te shkollave.

Ekipi i kontrollues i OECD mesoi se zakonisht krijohet nje komision prej tre personash per te perzgjedhur nje mesues. Kur per nje vend ka me shume se nje kandidat, kriteret e perdorura jane: (a) niveli arsimor i kandidatit, (b) numuri i viteve te experiences mesimdhense ne shkolla te vlefshme per vendin e punes dhe (c) faktore jo profesionale.

Mesuesit e rinj qe jane te interesuar per emerim duhet te regjistrojne emrat ne nje liste pritjeje ne DA. Ne realitet, aktualisht – fale mungeses se mesuesve te kualifikuar – komisioni perzgjedhes perpiqet te binde aplikantin qe ta marre vendin e punes, sidomos ne zonat fshatare.

Pasigurite e shkaktuara nga sistemi aktual i kontratave me ane te cilave disa mesues emerohen *me vendim* – zyrtarisht (qe nenkupton nje pozicion mesuesi edhe pse jo domosdoshmerisht ne te njejten shkolle vit pas viti), ndersa te tjere punesohen me kontrate – *kontrate* (nje emerim vetem i perkohshem, me page me te ulet), aktualisht ndihmojne ne nxitjen e largimeve nga fshati. Mesuesit qe nuk kane kualifikimet e duhura zakonisht kontraktohen me afate 6 mujore.²¹

Mund te merret me mend se per shkak te statusit te ulet, pages se ulet, proporcioneve te medha te mesuesve te pakualifikuar dhe emerimeve te perkohshme, mungeses se skemave te pageses bazuar ne rezultatet etj., shkaqet e nenkuptuara te problemeve ne arsimin shqiptar lidhen me shume me motivimin se sa me varferine.

Kualifikimet e mesuesve

Mbeshtetur ne statistikat e dhena nga MASH, numri i mesuesve me arsim te larte ose me diplome te shkolles se mesme eshte duke u zvogeluar. Ne te gjithe nivelet, 22% e mesuesve jane pa kualifikimin e duhur. Ne klasat e larta te arsimit baze 8 vjeçar, kjo

²¹ De Waal, Clarissa. January, 2000. "Raport mbi Arsimin Rural ne Shqiperi dhe Reformat e Propozuara per Rritjen e Efektivitetit. (Projekt). Programi per Zhvillimin e Arsimit, Tirane, Shqiperi.

perqindje rritet ne 33%. Ne vitin shkollor 1998/99, 90% e mesuesve te parashkolloreve, 50% e mesuesve te 8 vjeçareve, dhe 4.3% e mesuesve te shkollave te mesme nuk kishin arsimin e duhur. Mund te verehen diferenca te medha midis kualifikimit te mesuesve ne qytet dhe fshat: ne vitin shkollor 1997/98 ne shkollat 8 vjeçare 70.3% e mesuesve ne zonat qytetare dhe vetem 44% e mesuesve ne zonat fshatare ishin te kualifikuar mire. (shih tabelen A 34 tek Berryman, *op.cit.*). Per shembull, per vitin 1999/2000, ne 51 shkollat baze 8 vjeçare te Mirdites, 60% e 69 mesuesve te Matematike-Fizikes nuk kishin kualifikimin e pershtatshem (De Waal, *op.cit.*).

Mesuesit nuk kontraktohen dhe as nuk promovohen ne baze te vleresimit sistematik te njohurive per lenden, shprehive dhe pervojës te tyre, duke perdorur kriterë te paracaktuara.

Tabela 4. Kualifikimi i edukatoreve per kopshtet

Vitet	90/91	91/92	92/93	93/94	94/95	95/96	96/97	97/98	98/99
Numuri dhe qendrimi ne arsim i edukatoreve te kopshteve									
Edukatoret e kopshteve	5 664	5 440	5 081	4 578	4 428	4 416	4 163	4 116	4 092
Me arsim te mesem					95%	94%	92%	93%	90%
Me arsim te larte					5%	6%	8%	7%	10%

Burimi: Treguesit Kryesore 1999 – Observatori Kombetar Shqiptar dhe MASH

Tabela 5. Kualifikimi i mesuesve ne arsimin baze (shkolla 8 vjeçare)

Vitet	90/91	91/92	92/93	93/94	94/95	95/96	96/97	97/98	98/99
Numuri dhe qendrimi ne arsim i mesuesve ne arsimin baze									
Mesues	28 789	29 553	30 557	32 098	30 893	31 369	30 926	30 111	29 468
Me arsim te mesem					49%	48%	48%	47%	47.9%
Me arsim te larte					51%	52%	52%	53%	52.1%

Burimi: Treguesit Kryesore 1999 - Observatori Kombetar Shqiptar dhe MASH

Tabela 6. Kualifikimi i mesuesve ne arsimin e mesem (te pergjithshem e profesional)

Vitet	90/91	91/92	92/93	93/94	94/95	95/96	96/97	97/98	98/99
Numuri dhe qendrimi ne arsim i mesuesve ne arsimin e mesem									
Mesues	9 708	9 553	9 298	7 834	6 365	6 321	6 118	5 989	5 897
Me arsim te mesem					4%	5%	5%	5%	4.3%
Me arsim te larte					96%	95%	95%	95%	95.7%

Burimi: Treguesit Kryesore 1999 - Observatori Kombetar Shqiptar dhe MASH

Tabela 7. Perqindjet e mesuesve shqiptare me arsim te larte

TOTAL	1997/98 Perqindje
Parashkollor	7.3
8 vjeçar	52.6
i mesem	95.3
Zonat qytetare	
Parashkollor	13.7
8 vjeçar	70.3
i mesem	90.6
Zonat qytetare	
Parashkollor	2.7
8 vjeçar	44.0
i mesem	92.4

Burimi: Zyra e Staistikave te Shqiperie. Tek: Sue E: Berryman (2000), Sektori i Arsimmit ne Shqiperi: Probleme dhe Premtime. (Projekt Diskutim), Banka Boterore.

Pagat e mesuesve

Pagat e mesuesve jane me te uleta se pagat mesatare, edhe ato te uleta, te sektorit publik, dhe nuk mbulojne me as shpenzimet per jetesen. Dhe pagat e uleta kane bere qe nje numur i madh mesuesish e pedagogesh te kualifikuar te largohen nga sistemi arsimor. Disa mesues largohen sepse pagat e uleta demtojne autoritetin e mesuesit ne komunitet. Ata qe largohen nga sistemi i shkollave publike, ose fillojne nje biznes, ose punojne si mesues ne shkollat private ku jane te punesuar afro 510 mesues, dhe disa prej tyre emigrojne ne vende te tjera. Shume nga ata qe qendrojne ne sistem por nuk mund te perballojne jetesen bejne pune te te dyta e te treta duke shitur embelsira, çamçakeza apo

artikuj te tjere, ose zhvillojne mesime private – edhe me studentet e klasave te veta, qe perben nje konflikt te qarte interesash.

Vitet e eksperiences ndikojne ne pagen e mesuesve. Te gjithë mesuesit plotesisht te kualifikuar marrin 2% rritje page per vit, ndersa gjithë mesiesit e pakualifikuar marrin 1% rritje per vit. Ne 1998, kur sindikatat e mesuesve u bashkuan per te bindur Qeverine te bente nje ngritje te pergjithshme, qeveria i ngriti pagat me 30% per nje kategori te caktuar. Sistemi i sotem ne fakt paguan ne menyre uniforme, pavaresisht nese mesuesi eshte neglizhent apo aktivisht i perkushtuar. Sistemi gjithashtu nuk ben dallime ne page per drejtoret e shkollave sipas pergjegjesive dhe ngarkeses kohore; drejtori i nje shkolle me më pak se 50 nxenes, dhe drejtori i nje shkolle me 900 nxenes dhe dy turne, marrin te njejten page.

Ambienti i punes

Tani qe njerezit kane liri levizje ne Shqiperi, migrimi drejt qyteteve e ka sforcuar infrastrukturen arsimore ne qytete. Migrimi i brendshem nga jugu dhe veriu drejt qendres dhe bregdetit te vendit ka shkaktuar krijimin e klasave te mbipopulluara. Numuri mesatar i nxenesve te çdo klase ne nje shkolle te Tiranës, per shembull, eshte 55. Mungesa e materialeve mesimore, teksteve dhe e pajisjeve i detyrojne mesuesit te punojne nen presion dhe me veshtiresi. Rruget e keqia, sidomos ne zonat fshatare, dhe mungesa e transportit publik e veshtiresojne udhetimin e mesuesve per ne shkolle. Shumica e godinave shkollore, sidomos ne fshatra, jane ne gjendje shume te keqe, me dritare te thyera, mure gati per te rene, rubineta qe rrjedhin e tualete qe pikojne – po qe se shkolla eshte aq me fat sa te kete uje. Nese, krahas ketyre kushteve te varfra, mesuesi eshte i pakualifikuar dhe Drejtori i Shkolles i emeruar politikisht me motivim te ulet dhe pa pushtet, ambienti i punes ne shkolle nuk ofron asnje mbeshtetje per mesuesit qe mund te duan te bejne reforma.

MASH percakton ngarkesen mesimore te personelit pedagogjik. Nje mesues ne arsimin parashkollor ka 36 ore (nje ore mesimi eshte 45 minuta) ne jave, nje mesues ne klasen 1-4 ben 23-27 ore ne jave, nje mesues ne klasat 5-8 ben 20-24 ore ne jave, dhe nje mesues ne arsimin e mesem ka 20 ore ne jave ose 620-650 ore ne vit. Mbikqyrja e punes mesimore ne nivel shkolle eshte pergjegjesi e Drejtorit dhe e Inspektoreve te Drejtorive Arsimore.

Eshte e kuptueshme se ndryshimi i shpeshte i Drejtoreve te Shkollave per arsye politike, ose te tjera, e demton menaxhimin e shkolles, dhe ka nje ndikim negativ ne motivimin i mesuesve dhe ne rezultatet e nxenesve.

Trainimi i mesuesve

Pergatitja ne shkolla

Komuniteti kerkon qe mesuesit e punesuar te kene arsim universitar. Universiteti i Tiranës dhe universitetet e rretheve e shkollat e mesme pedagogjike pergatisin studente

per profesionin e mesuesise. Te diplomuarit e Universitetit te Tiranes marrin nje diplome qe i lejon ato te japin mesim ne shkollat e mesme, te jene asistente pedagoge ne universitete, dhe te gjejne pune te tjera ku diploma e tyre pranohet. Gjate 4 ose 5 vjeteve te pergatitjes ne universitet, studentet kryesisht marrin njohuri shkencore dhe me pak pergatitje speciale per profesionin e mesuesise. Per shembull, ne Departamentin e Matematikes ne Universitetin e Tiranes, programi 4 vjeçar i studimit finalizohet me nje diplome si “Mesues Matematike per Shkollat e Mesme”; studentet studiojne Psikologji ne dy semestra, Didaktiken e Matematikes ne 2 semestra, dhe bejne 8 jave praktike pedagogjike ne shkolla.

Universitetet e rretheve pergatisin studente per profesionin e mesuesit ne shkollat baze 8 vjeçare. Mesuesit per parashkolloret (kopshtet), mesuesit e fillores klasa 1-4 dhe mesuesit e klasave 5-8 ne arsimin 8 vjeçar te detyruar pergatiten ne universitetet e rretheve. Studentet ne departamentet qe pergatisin mesues ne universitetet e rretheve te Shkodres, Elbasanit, Gjirokastrës dhe Korçës duhet te bejne 3-4 jave praktike mesimore ne institucionet arsimore perkatese gjate vitit te trete dhe te katert te studimeve. Megjithate, per te permbushur kete kerkese, nuk ka asnje marreveshje qe studentet e universiteteve te shkojne ne shkollat lokale per te vezhguar mesues me eksperience dhe per te praktikuar mesimdhenien nen udheheqjen e tyre. Institucionet qe pergatisin mesues kane lidhje te dobeta me shkollat lokale e administraten e arsimit, dhe nuk kane nje kerkim arsimor te kuptimte e kapacitete per zhvillimin e politikave qe jane te rendesishem per permiresimin e cilesise se pergatitjes se mesuesve. Keshtu, ndersa me pare studentet shpenzonin vetem 8% te kohes se tyre ne shkolla, tani ato shpenzojne deri ne 20% te kohes se studimit per te vezhguar jeten ne klase, dhe per praktike mesimdhenieje. Mesuesit ne shkollat ku behet praktika nuk gezojne ndonje status te veçante dhe nuk jane te kualifikuar per te udhehequr procesin e praktikës se mesimdhenies.

Diplomat e dhena nga universitetet e rretheve nuk jane te percaktuara qarte persa i perket lëmeve te kompetences ku ato jane te specializuara, keshtu qe te diplomuarit nga ketu programe shpesh perfundojne si mesues ne sektorin e arsimit te mesem megjithese ata jane pergatitur si mesues per shkollen 8 vjeçare.

Ka edhe disa institucione per pergatitjen e mesuesve ku pergatiten mesues per fusha te veçanta, si per shembull Akademia e Arteve ku pergatiten mesuesit e artit dhe Instituti i Larte i Kultures Fizike ku pergatiten mesues te edukimit fizik. Qysh nga 1995, edukimi i mesuesve per ciklin parashkollor ofrohet ne te gjithë universitetet me perjashtim te universitetit te Tiranes.

Ndermjet shkollave te mesme profesionale, ka edhe disa (tre) “Shkolla te Mesme Pedagogjike” (shkolla te mesme pedagogjike per studente deri ne moshen 18 vjeç). E para prej tyre u hap ne vitin 1909 ne Elbasan dhe funksionon akoma; ajo u themelua per te pergatitur mesues per ciklin parashkollor dhe fillor. Megjithese nxensit qe mbarojne keto shkolla duhet te vazhdojne pergatitjen per mesues ne departamentet e mesuesise te universiteteve, per shkak te mungeses se mesuesve shume prej tyre gjejne pune si mesues menjehere – pa diplome universitare – ne te gjithë nivelet e arsimit parauniversitar. Sipas

informacioneve nga drejtori i shkolles se mesme pedagogjike te Elbasanit, rreth 50% e nxenesve qe mbaruan shkollen e mesme pedagogjike ne Elbasan ne vitin 2000 filluan pune ne zonat fshatare, ndersa 40% vazhduan arsimin e larte ne Universitetin e Elbasanit. Ne Shkollen e Mesme Pedagogjike, Gjirokaster, ka nje departament per “Mesuesit e Minoritetit” ku pergatiten mesues per t’u dhene mesim minoritareve ne gjuhen e vet ametare ne shkollat e minoritetit.

Nuk egzistojne standarde apo kerkesa per pergatitjen ne shkolla te mesuesve per ciklin parashkollor. Megjithese eshte parashikuar ne Ligjin per Arsimin e Larte (1999), akreditimi i programeve te studimit akoma nuk funksiononte ne kohen e vizites se ekipit te OECD. Qellimi, pra, eshte te vendosen standarde ne nivel kombetar per pergatitjen e mesuesve. Kjo kerkon nje sistem provimesh te jashtme si edhe procedura per monitorimin dhe vleresimin e pergatitjes se mesuesve. Per me teper nuk ka as programe studimi per menaxhimin e arsimit ne universitete.

Trainimi ne detyre

Trainimi i mesuesve ne detyre ka ndryshuar ne keto 10 vitet e fundit, por ai akoma mbetet nje aspekt i percaktuar keq ne sistemin arsimor shqiptar. Aktualisht, ai eshte pergjegjesi e Drejtrorise Arsimore. MASH filloi nje program te ri per trainimin ne detyre ne 1998. Ky program u dha fuqi DA per te ofruar rikualifikime ne nivel rrethi, duke perdorur inspektoret si trainues. Ekipi i OECD u informua ne ISP se rikualifikimi i mesuesve te shkollave te mesme dhe i drejtores behet nga MASH me konsulence te ISP, bazuar ne nje vleresim te nevojave . Programet zhvillohen nga ISP dhe dergohen ne DA ne fillim te vitit shkollor. Rikualifikimi konsiderohet nga ISP si shume i rendesishem per mesuesit ne arsimin profesional. Por ekipi i OECD nuk pa asnje prove te ndonje vleresimi serioz te nevojave per rikualifikim. Nje raport i pergatitur nga AEDP (Programi per Zhvillimin e Arsimit Shqiptar, financiar nga Soros), thote se efektiviteti i ketij programi nuk eshte provuar akoma, dhe nuk duket te kete ndonje perqasje sistematike per çeshtjet e cilesise se mesimdhenies, nevojave per trainim, dhe permbajtjes se trainimit. Krahas kesaj, as inspektoret vete nuk kane trainimin dhe eksperiencen e duhur per te permbushur pergjegjesite e tyre te reja.

DA percaktojne permbajtjen dhe qellimin e trainimit. Mesuesit kerkohet te marrin pjese nje ose dy here ne vit, sipas lendeve qe ato japin. MASH (ISP) vë ne dispozicion te DA konsulente qe ftohen te zhvillojne trainimin.

Rikualifikimi brenda shkolles mund te behet ne menyre individuale ose kolektive. Trainimi individual mund te konsistoje ne vazhdimin e nje kursi kualifikues te miratuar, studimin e literatures profesionale e shkencore, aktivitete profesionale dhe shkencore si dhenia e mesimeve experimentale dhe leksioneve profesionale, botimin e punimeve personale apo perfitimin e nje shkalle me te larte kualifikimi. Rikualifikimi kolektiv behet brenda grupeve profesionale te mesuesve apo me keshillat e mesuesve ne nje ose disa shkolla te nje zone, bashkie a rrethi, ose brenda shoqatave profesionale. Drejtoret e shkollave dh inspektoret e autoriteteve lokale te arsimit dhe MASH monitorojne kete lloj rikualifikimi.

Ne diskutimet me partneret shqiptare, ekipi i OECD kuptoi se koncepti i rikualifikimit te mesuesve shpesh ngaterrohej me programet per atestimin e mesuesve, qe organizohen nga autoritetet arsomore lokale. Mesuesit ne detyre testohen per kompetencen (azhornim i mesuesve) ne lenden e tyre çdo pese vjet, deri kur mbushin 20 vjet pune si mesues dhe me pas ata nuk i nenshtrohen provimeve. Mesuesit pa kualifikimin e duhur (dmth pa nje diplome per pergatitjen si mesues) gjithashtu testohen, megjithese pjesemarrja ne keto teste sigurisht nuk eshte 100%. Nuk ka raste qe ndonjeri qe ka kualifikimet e kerkuara te kete ngelur ne keto provime; prandaj ato jane me shume provime me “te drejten e kalimit” qe te jep vjetesia ne pune se nje vleresim serioz i kompetences.

Nuk duket se po kryhet ndonje reforme sistematike lidhur me trainimin e mesuesve ne detyre (per shembull, ne lidhje me ndryshimet ne kurrikulum, ne sistemin e vleresimit, apo ne metodologjine e punes ne klase). Nuk jane krijuar mundesi zhvillimi profesional per drejtoret e shkollave dhe inspektorët. Ka plane per te filluar kete lloj trainimi ne Universitetin e Tiranës; departamentet e universiteteve nuk jane angazhuar ne trainimin e mesuesve ne detyre.

OJQ dhe fondacione te huaja, si Projekti per Zhvillimin e Arsimit Shqiptar (AEDP), *Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit* (GTZ), gjithashtu kontribuojne per aktivitetet e trainimit te mesuesve ne detyre ne bashkepunim me institucionet shqiptare ose me OJQ shqiptare. Per momentin nuk ka asnje strategji per integrimin e ketyre perpjekjeve ne rrjedhen e trainimit te mesuesve ne detyre.

Trainimi ne detyre nuk shfaqet si nje çeshtje me vete ne buxhetet kombetare apo lokale, prandaj eshte e pamundur te percaktohet sa po harxhohet per te.

Mesuesit dhe trainimi i mesuesve ne Strategjine Afatmesme te MASH

Projekt Strategjia Afatmesme e MASH i percakton mesuesit si elementin me te rëndesishem per te siguruar dhe permiresuar cilesine e sistemit arsimor ne Shqiperi. Decentralizmi per te shperndare pushtetet ndermjet administrates qendrore dhe lokale ne nje menyre te balancuar dhe per te krijuar pjesemarrjen e komunitetit; privatizimi per te rritur mundesite e zgjedhjeve e konkurrencen; dhe vleresimi per te nxitur zhvillimin e performances dhe planifikimin e karrieres jane elemente qe theksohen ne projekt Strategji.

Nje qellim i rëndesishem eshte edhe rritja e numrit te mesuesve te kualifikuar. MASH po shqyrton hartimin e nje politike te planifikimit te kuotave per te terhequr te rinjte drejt programeve te mesuesise ne institucionet e arsimit te larte; do te ofrohet gjithashtu trainim i vazhdueshem ne detyre. Do te ngrihen Qendra te specializuara trainimi ne nivel kombetar dhe lokal. Nje program per edukimin ne distance me emrin “*Kualida*” i adresohet mesuesve nga zonat e largeta.²²

²² AEDP per shume vite ka vazhduar nje program shume te sukseshem dhe popullor te quajtur “TV per Mesuesit”, i cili u perqendrua ne permiresimin e njohurive te mesuesve mbi metodat e mesimdhënies dhe metodat e reja per te mesuarin dhe te nxenin e shprehive te te menduarit kritik. Programi u shoqerua me materiale mesimore te shkelqyera te zhvilluara me ndihmen e Universitetit te Hapur ne Britanine e Madhe.

Kujdesi per femijet dhe zhvillimin tyre

Rendesia e arsimit ne femijerine e hershme

Nje pikenisje e rendesishme persa i perket te drejtave te femijeve per arsim ne femijeri dhe nevojës per kete lloj arsimit gjendet ne “Konventen per Te Drejtat e Femijeve” te Kombeve te Bashkuara (KDF) (1989). KDF rregullon te drejtat e femijeve dhe detyrimet e prinderve. Neni 28 thekson “Te drejten per arsim te lire” dhe Neni 29 “Objektivat e arsimit”.

Ne arsimin parashkollor shqiptar, jane sjelle disa risi kurrikulare me ndihmen e OJQ. Me te suksesshmet prej tyre perfshijne “Hap pas Hapi” i cili eshte nje program metodologjik qe ka ne qender femijen dhe filloi ne arsimin parashkollor ne 1994; ne 1996 ne klasen 1, dhe ne klasen 4 ne 1999. Ne vitin 2000 ai u shtri ne 7 rrethe.

MASH ka pergatitur nje strategji afatshkurter per zhvillimin e arsimit parashkollor, mbeshtetur ne disa konsiderata, si :

- Roli i viteve te para te arsimit si bazat e pjekurise.
- Kontributi i arsimit ne moshe te vogel per zhvillimin e shprehive dhe krijimin e vlerave te tilla si bashkepunimi, solidariteti, dhe respekti per opinionet e te tjereve;
- Rendesia e institucioneve cilesore per arsimin parashkollor me nje ndikim pozitiv te drejtperdrejte ne jeten kulturore, ekonomike dhe shoqerore te femijeve, familjes dhe shoqerise.

Fakte dhe shifra

MASH eshte pergjegjese per arsimin parashkollor ne Shqiperi. Ketu perfshihen femijet e moshes 3 deri 6 vjeç. Femijet nga 0 deri ne 3 vjeç mund te shkojne ne çerdhe, apo qendra te kujdesit ditor te cilat jane nen juridiksionin e Ministrise se Shendetesise. Çerdhet nuk jane konsideruar kurre pjese e sistemit arsimor. Te gjithë mesuesit, sipas te dhenave aktuale, jane femra. Ato pergatiten ne kurse 3 vjeçare ne shkollat pedagogjike ose universitete.

Ekipi vleresues i OECD mesoi se po hapen gjithne e me shume kopshte private. Prinderit mendojne se keto kopshte ofrojne nje cilesi me te mire, dhe kur jane ne gjendje ta perballojne, ata i dergojne femijet atje. Dalja ne skene e kopshteve private ndihmon edhe buxhetin e shtetit, i cili per momentin e adreson pjesen me te konsiderueshme te fondeve per arsimin ne sektoret jo te detyrueshem te sistemit (arsim parashkollor, te mesem dhe universitar).²³

²³ Palomba dhe Vodopivec (*op.cit*) jep raportet qe vijojne: nese shpenzimet per arsimin baze 1-8 jane 100, atehere shpenzimet per kopshtet jane 85, per arsimin e mesem 144, dhe arsimin universitar 596 per student. Banka Boterore, 2000, f. 73.

Ne vitin 1991, 60% e femijeve te moshes 3-6 vjeç shkonin ne kopshte. Ne vitin 2000, kjo shifer kishte rene ne 36%. Para vitit 1990 ne kopshte kishte 130 000 femije 3-6 vjeçare; ne vitin 2000 ky numur u ul ne 80 000 femije. Ne vitin 1990 kishte 70 çerdhe; tani ka 40. Edhe pse ka patur nje migrim te madh nga zonat fshatare drejt Tiranës dhe shume prinder duan t'i çojne femijet e vet ne çerdhe ose kopshte, sot nuk mund te gjenden vende te mjaftueshme.

Drejtimi dhe administrimi i sektorit parashkollor

MASH merr te gjitha vendimet per sistemin parashkollor qe kane te bejne me buxhetin, stafin dhe kurrikulumin ndersa bashkite lokale vazhdojne te kene fare pak pushtet. Ata vjelin disa taksa por vetem per qeverine qendrore. Sidoqofte, Ligji per Pushtetin Lokal do te amendohet, dhe nese keto ndryshime zbatohen, autoritetet lokale mund te luajne me shume rol per arsimin parashkollor brenda juridiksionit te vet.

Pershtypja e pergjithshme eshte se delegimi i pushteteve ne nivel lokal do te ndikojte pozitivisht ne arsim, por shpesh thuhet se keto ndryshime duhen bere ngadale. Nje person ne MASH tha: “Nuk eshte mire t'i shesesh kepuçet e vjetra pa blere te reja”.

Kopshtet akoma emertohen me numura, si ne kohën e regjimit komunist (psh. Kopshti Nr. 42 etj). Nga prinderit ka kerkesa te medha per kopshte, por nuk ka shifra se sa femije nuk mund te shkojne ne kopesht per shkak te mungeses se te ardhurave. Papunesia dhe verfaria duket se jane probleme te medha per prinderit perveç mungeses se vendeve.

Shteti shprehet se ne nje grup femijesh nuk duhet te kete me shume se 25 vete, por ne ato qe konsiderohen kopshte te mire shpesh ka shume me teper femije ne nje grup. Ne nje nga kopshtet e vizituara, ne nje grup kishte 50 femije 3-4 vjeçare; ne nje grup tjetër 5-6 vjeçaresh kishte 54 femije. Keto grupe kishin dy edukatore. Sipas te dhenave statistikore kombetare, raporti mesatar Nxenes/Mesues ne nivelin parashkollor eshte 20:1. Eshte e qarte se nuk ishte keshtu ne pese kopshtet e vizituara nga ekipi i OECD. Mesatarja kombetare mbase reflekton shifrat e frekuentimit me te vogel ne zonat fshatare.

Ne çdo shkolle, zakonisht ka nje klase te madhe me nje dhome tjetër qe sherben si fjetore, pasi te gjithë femijet ne kopshte flene dy ore ne dite. Meqenese oborret e shkollave jane kryesisht me balte, pula dhe barishte, femijet nuk kane vend ku te luajne. Vetem njera nga pese shkollat e vizituara kishte nje kend te mire lojrash me pajisje per te luajtur. Shkolla mbeshtetet nga UNICEF, dhe punon me metoden pedagogjike “Reggio Emilia”. Shkollat e projektit “Hap pas Hapi” (te mbeshtetura nga AEDP Soros) gjithashtu kane pajisje me te mira.

Ne Shqiperi ka 18 kopshte “Hap pas Hapi”, te ngritura nga Fondacioni Soros. Fondacioni financon pajisjen e ketyre shkollave, ndersa shteti siguron pjesen tjetër te fondeve. Prinderit paguajne 2 000 leke (15.9 EUR) ne muaj per ushqim. Sipas

statistikave, numri total i kopshteve me ushqim ne vitin 2000 ishte 97 ne zonat qytetare, dhe 0 ne zonat fshatare. Kjo eshte goxha renie nga 665 ne zonat qytetare dhe 351 ne ato fshatare qe ishin ne vitin 1990.²⁴

Persa i perket kurrikulimit, programi arsimor per kopshtet pergatitet ne MASH dhe te gjitha kopshtet e zbatojne ate. Metodoa “Hap pas Hapi” u fut ne vitin 1994. Metoda Reggio Emilia (nga Italia) erdhi me vone, por te dyja keto metoda tani po perdoren dhe po zhvillohen. Ato te dyja perqendrohen tek femija, dhe orientohen drejt veprimit, qe perben nje koncept krejt te ri per shumicen e mesuesve.

Te tjera kopshte private jane ngritur nga orginizata fetare, dhe keto kopshte jane shume popullore ne shqiperi. Ne Elbasan, shume prinder i regjistrojne femijet, sapo lindin, ne keto kopshte, me qellim qe ta kene vendin te sigurte kur te rriten.

Numuri i kopshteve dhe i femijeve

Tabela 8. **Kopshtet**

Viti	Numri i Kopshteve	Femije te Regjistruar		Numri i mesuesve	
		TOTAL	Femra	TOTAL	Femra
1990	3 426	130 007	62 148	5 664	5 664
1991	3 174	108 889	51 784	5 440	5 440
1992	2 784	81 117	41 549	5 081	5 081
1993	2 656	80 395	41 154	4 578	4 578
1994	2 668	80 348	39 685	4 428	4 428
1995	2 669	84 026	41 589	4 413	4 413
1996
1997	2 408	80 240	41 006	4 116	4 116
1998	2 048	80 418	39 952	4 116
1999	2 330	81 734	40 950	4 092
2000	2 111	80 337	40 778	3 806

Burimi: MASH Drejtoria e Statistikave

²⁴ Burimi: Strategjia afatmesme, MASH 2000.

Çeshtje te Barazise dhe Aksesit

Aksesi universal ne nje arsim te lire baze (tetevjeçar, te mesem, ose mestarisht 8 ose 9 vitet e para te arsimit) eshte nje element kyç i te drejtave te njeriut i njohur nga Konventa e OKB per Te Drejtat e Femijeve. Ne fillim te viteve 1980 kjo gje ishte arritur ne nje mase te madhe ne te gjithe bllokun socialist. Ne Shqiperi, afro 80% e popullise pas Luftes se Pare Boterore ishte analfabete; deri ne 1955, me hapjen e shkollave ne fshatra dhe kurset kunder analfabetizmit, analfabetizmi tek shqiptaret nen 40 vjeç thuhet se u zhduk plotesisht. Ne 1990, regjistrimet ne kopshte ishin rreth 60%, rregjistrimet ne arsimin e detyrueshem ishin 100%, ne arsimin e mesem 80%. Rreth 45% e popullise nga 35 deri 45 vjeç kishte perfunduar te pakten arsimin e mesem.²⁵

Studimet e fundit, sidoqofte, kane pare nje marxhinalizim ne rritje te grupeve te pafavorizuar, sidomos te te varferve, te atyre qe jetojne ne zonat fshatare ose zona me mos-stabilitet e kriminalitet te larte dhe trazira te medha, te te migruarve qe jetojne ne komunitete gjysem-te paligjshme sidomos rreth Tiranës; dhe te tjereve qe konsiderohen si “te huaj” ne shoqerine shqiptare. Ky fragmetarizim krijon nen-komunitete te lidhura ngushte nga rregulla besnikerie te grupit, por qe kane pak besim dhe bashkepunim mes grupeve. Prandaj eshte e veshtire te flasesh per vlera te “komunitetit” apo “shoqerise” mbi te cilat te mund te ndertohej nje strategji kombetare per reforma ne arsim.²⁶

Marxhinalizimi i ekstrem i te migruarve nga zonat fshatare ne qytete, si edhe i Romëve, kerkon te merren masa pozitive dhe aktive nese deshirohet te prishet cikli e perjashtimit ose vetperjashtimit. Po behen perpjekje nga OJQ, por vete sistemit shkollor i duhet akoma te marre pergjegjesi per te krijuar nje ambient me mikprites dhe perfshires. “Shkolla mike e femijeve”, nje nga objektivat kryesore te UNICEF per arsimin ne shekullin 21, duket shume e larget.

Femijet Romë

Nje vleresim i vitit 1994 per keshillin e Europes theksonte se atehere ne Shqiperi kishte rreth 95 000 Romë.²⁷ Megjithese numri aktual mund te jete (dhe shpesh eshte) i debatueshem, nuk ka asnje dyshim se ka te pakten kater “fise” dhe komunitete te llojeve te ndryshme Romësh (ne qytet/ne fshat, te asimiluar/te paasimiluar) ne Shqiperi. Pothuajse te gjithe keto komunitete jane te vendosur diku (ne dallim nga “jevgitet” endacake). Ne Shqiperi, Romët kane qene “kaq te izoluar sa ato jane fare pak te ndergjegjshem per vellezerit e tyre Romë ne diaspore anembane botes. Megjithate, Romët e Tiranës kane me shume gjera te perbashketa me Romët e larget se sa me fqinjët e tyre shqiptare, ne gjirin e te cileve ata kane jetuar per afro 600 vjet. Ata merren vesh - por mbeten te ndare.”²⁸

²⁵ Nora Dudwick dhe Helen Shahriari, *Arsimi ne shqiperi: Ndryshim Qendrimesh dhe Shpresash*. 2000. Banka Boterore, faqe 2.

²⁶ *Ibid*, faqe 8.

²⁷ J-P. Liegeois, *Romët, Jevgitet, Endacaket*. 1994. Strasburg: Keshilli i Europes.

²⁸ Isabel Fonseca, *Me Varrosni ne Kembe: Jevgitet dhe Udhetimi i Tyre*. Londer: Vintage Press, 1995, faqe 22.

Ekipi i OECD shikoi shume pak femije Romë ne kopshte, dhe nuk kishte fare informacion per pjesemarrjen e Romëve. Nga ai informacion i pakte ne formen e anekdotave qe mund te mblidhej, eshte e qarte se ata rralle shkonin ne shkolle, dhe nese e shkonin, ata u tregoheshin me gisht vizitoreve ose mesuesit flisnin per ta sikur ata te kishin qene nxenes te se kaluares. Ne te dy rastet, ata trajtoheshin si objekte kurioziteti. Ne kete fushe nevojitet nje ndryshim i vertete ne qendrimet.

Femijet me nevoja te veçanta arsimore (NVA)

Ishte gjithashtu e veshtire te merrje informacion te azhornuar per femijet me nevoja te veçanta ne Shqiperi. Megjithate, ishte e qarte se femijet me paaftesi nuk kishin status, dhe se disa prinder akoma i fshihnin femijet e tyre me paaftesi. Asnje femije me NVA nuk dukej te ishte integruar ne shkollat e zakonshme, ata qe ndjekin ndonje lloj arsimi jane ne shkolla te veçanta. Keto shkolla jane te specializuara per t'u kujdesur per te verberit ose ato me probleme shikimi, shurdhet ose ato me probleme degjimi, dhe femijet me te meta mendore.

Sipas "Raportit Vjetor 1998" te Ministrise se Punes dhe Çeshtjeve Sociale (botuar ne 1999) ne vend ka 7 qendra per zhvillimin fizik dhe mendor. Ato i sherbejne femijeve te moshes 6-14 vjeç, por disa mund te qendrojne ne keto qendra deri ne moshen 18 vjeç. 5 nga keto 7 qendra, jane rezidenciale dhe te tjerat jane ditore. Kapaciteti total i te gjitha qendrave rezidenciale eshte 250 shtreter ndersa kerkesat per t'u vendosur aty jane shume me te medha. Qendrat ditore mund t'u sherbejne 400 femijeve ose me teper, por edhe kjo eshte e pamjaftueshme per nje vend sa Shqiperia. Eshte e qarte se nje pjese e femijeve me nevoja te veçanta mbahen fshehur neper shtepia dhe nuk perfshihen ne asnje lloj arsimi. Per me teper, megjithese legjislacioni eshte i favorshem per te kunderten, studenteve me paaftesi te diagnostikuara rrallehere u ofrohen mundesi per te ndjekur arsimin e mesem jo profesional apo arsimin e larte. Shpesh paramendohet se nga femijet me NVA nuk mund te pritet me teper se sa te mbarojne arsimin baze, ose, nese jane me fat, pak arsim profesional. Kjo eshte shpesh nje çeshtje aksesi fizik dhe kushtesh te papershtatshme, por edhe nje çeshtje qendrimesh shoqerore ndaj personave me paaftesi. Ne regjimin e Hoxhes, familjet me femije "difektoze" izoloheshin; nofka e paaftesise mendore ose fizike prekte te tere familjen krahas vete femijes. Zakone te tilla shoqerore vdesin me veshtiresi, dhe do te duhet kohe qe femijet me NVA te pranohen si anetare te vlefshem te komunitetit arsimor.

Nga ana tjeter, ka gjithashtu nje legjislacion te veçante qe i favorizon studentet me paaftesi, jetimet dhe te persekutuarit nga komunizmi. Ky legjislacion zbatohet per t'i dhene femijeve me paaftesi vende ne institucione dhe shkolla speciale, dhe (me rralle) ne shkollat dhe universitetet e zakonshme.

Ne kopshte, per momentin nuk punesohen psikologe. Psikologet e pare u diplomuan ne 2001, pas pese vjet studimesh dhe eshte planifikuar qe disa prej tyre te punesohen ne shkolla.

Diagnostikimi dhe vendosja janë pergjegjesi e nje komisioni mjeko-pedagogjik ne çdo autoritet lokal. Kurrikula per femijet me NVA duhet t'i pershtaten llojit dhe shkalles se paaftesise, por llogjika e pershtatjeve te tilla nuk eshte e qarte. Per shembull, femijet ne shkollat speciale per te shurdher ose femije me probleme degjimi, dhe femije me probleme mendore, duhet ta mbarojne kurrikulumin e rregullt te 4 viteve te fillores per 9 vjet, ndersa shkolla per te verberit dhe femijet me probleme shikimi perdor kurrikulumin e rregullt shkollor te shkolles baze 8 vjeçare, me metodat dhe materialet e pershtatshme mesimore. Logjika me sa duket eshte se femijet e shurdher jane me pak te afte se femijet e verber per te perballuar programe shkollore normale.

As qe behet fjale per integrimin e femijeve me paftesi ne klasa te rregullta. Kjo vjen pjesisht ngaqë godinat e shkollave ne Shqiperi jane pergjithesisht te pariparura dhe me pak pajisje madje edhe per femijet e shendetshem; por arsyeja kryesore eshte nje paragjykim i theksuar shoqeror, dhe rezistenca nga mesuesit dhe prinderit e femijeve te shendetshem. Megjithate, Kushtetuta thekson qarte se *te gjithë* qytetaret e Shqiperise gezojne te drejta te barabarta per t'u arsimuar ne te gjithë nivelet e arsimit, pavaresisht nga statusi i tyre ekonomik, shoqeror *apo nga shendeti i tyre*; dhe Shqiperia eshte nje vend qe ka firmosur Konventen e OKB per Te Drejtat e Femijeve, e cila po ashtu thekson te drejta te barabarta per te gjithë femijet.

Tani eshte me se e qarte nevoja per ta perfshire kete çeshtje ne axhenden arsimore te Shqiperise.

Femijet me probleme shoqerore dhe femijet ne rrezik

Jane ngritur disa institucione per femijet me probleme shoqerore. Institucionet rezidenciale per femijet kane nje "kapacitet teorik" prej 595 vendesh. OJQ te huaja kane filluar te punojne ne kete fushe per te ngritur disa institucione me te vogla per keta femije.²⁹ Koncepti "femije me probleme" kohet e fundit ka ndryshuar. Me pare ai nenkuptonte jetimet ose femijet e lindur jashte martese. Megjithese ekipit iu tha se numri i femijeve te lindur jashte martese eshte rritur ne 10 vitet e fundit, tashme eshte e njohur qe probleme mund te kene edhe femijet qe jetojne ne familje me te dy prinderit. Keto kategorizohen te jene: varferia; semundjet (sidomos psikologjike); prishja e familjes; emigracioni, sidomos kur prinderit jane larguar ne destinacion te panjohur. Eshte ngritur nje Komision Qendror per te koordinuar levizjen e personave ne institucionet e mbrojtjes shoqerore.

Ka nje rritje te numrit te femijeve te braktisur apo te lene ne keto institucione, shpesh ngaqë prinderit e tyre ose nenat e reja besojne se ata do te gezojne me shume kujdes atje. Per shkak se numri i institucioneve dhe vendeve eshte kaq i kufizuar, eshte gjithashtu e veshtire t'i vendosesh femijet e te njejtës grupmoshe ne te njejtin institucion, dhe prandaj ka grupe femijesh me mosha te ndryshme, gje qe nuk eshte e dobishme per zhvillimin e femijeve.

²⁹ Raporti Vjetor 1998, Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale.

Eshte e dukshme per vezhguesit qe, sidomos ne qytete, nje numur femijesh dhe te rinjsh ne moshe shkollore jetojne ne rruge, dhe me sa shihet pa kontroll dhe kujdes prinderor. Pas krizes se 1997 ne Shqiperi, kur qindra mije arme u grabiten nga depot, femije te tille jane ne rezik per t'u perfshire ne veprimtari te renda kriminale, duke perfshire grabitjen e armatosur, trafikimin e droges dhe prostitucionin. Veçanerisht ne jug dhe prane kufinjve me vendet fqinje, djemte qe kane braktisur shkollen e konsiderojne kontrabanden si nje rruge te lehte per te fituar para. Edhe perdorimi i droges eshte ne rritje. Shpesh prinderit shprehen te frikesuar per sigurine e femijeve te vet, jo vetem ne rruge por madje edhe ne shkolla.³⁰

Krahas AEDP (Fondacioni Soros) dhe UNICEF, sipas Raportit te Ministrise se Punes dhe Çështjeve Sociale te vitit 1998, nje numer i konsiderueshem donatoresh te tjere nderkombetare veprojne ne insitucionet per femijet me probleme shoqerore. Midis tyre mund te gjenden Danish Red Barnet (Save the Children) dhe Misioni "Nene Tereza", dhe projektet bilaterale si psh. ato me fonde Zviceriane, Austriake, dhe Britanike.

OJQ kombetare jane te perqendruara kryesisht ne Tirane, me rrjete te shperndara edhe ne qytetet e medha. Qellimi i tyre kryesor eshte te ndihmojne per te krijuar mundesi me te mira per femijet, sidomos per sektoret me te pafuqishem te shoqerise, si femijet me paaftesi, femijet e pastrehe, femijet Romë, e minoritete te tjera. Keto organizata punojne gjithashtu edhe per te drejtat e femijeve. Organizatat dhe individe te tjere jane organizuar ne Aleancen e Femijeve Shqiptare, e cila eshte nje forum i hapur per te gjithë femijet e Shqiperise. Komiteti drejtues zgjidhet nga Asambleja e Pergjthshme, e cila mblidhet nje here ne vit.

Kur metoda "Hap pas Hapi" e Fondacionit Soros u prezantua si nje skeme pilot, u shtua edhe nje koordinator familjar per te mbeshtetur punen e mesuesve dhe marredheniet me komunitetin. Ne shkollat qe perdorin metoden "Reggio Emilia" stafit mesimor iu shtua nje mesues per ateliene per te dokumentuar gjithçka qe nxenesit i tregonin mesuesit per ateliene, ku kater femije punonin gjithmone bashke. Klasat e Reggio Emilias mund te kene 35 femije dhe 2 mesues.

Eshte fare e qarte se fondacioni Soros me metoden "Hap pas Hapi" ka pasur ndikimin me te madh ne arsimin parashkollor. Ata jane aktive jo vetem ne sistemin parashkollor por edhe ne shkollat tetevjeçare. Fondacioni Soros dhe MASH jane duke bere nje vleresim te ndikimit ne sistemin parashkollor. U theksua se nevojiten eksperte te huaj per te vleresuar sistemin por nuk ka ze ne buxhet per kete. Duhet te behet gjithashtu edhe nje monitorim i ngjashem per menaxhimin ne metoden "Hap pas Hapi", dhe projekti duhet te perfshije gjithë Shqiperine. Nevojiten eksperte te huaj per te futur "Hap pas Hapi" ne klasat 5-8.

Metodes Reggio Emilia nuk i eshte bere vleresim dhe ajo nuk do te vazhdoje ne arsimin tetevjeçar.

³⁰ Dudwick dhe Shahriari, *op.cit.*, ff. 12-13.

Çeshtje dhe Barriera ne Kujdesin per Femijet dhe Zhvillimin e Tyre

Drejtimi dhe financa. Thuhet se disa bashki i “riadresojne” per qellime te tjera fondet e dhena nga qeveria qendrore per arsimin. Per momentin MASH nuk ka asnje mekanizem per t’u siguruar qe pushteti lokal te permbushe detyrimet e veta.

Pajisjet. Rehabilitimi i shkollave eshte financuar nga donatore nderkombetare, por çeshtja te tjera kane mbetur prapa si psh. trainimi i mesuesve dhe kurrikula. Kjo eshte e vertete per kopshtet, shkollat tetevjeçare dhe te mesme. Kopshtet shteterore kane nevojte urgjente per riparime, si edhe per materiale mesimore per mesuesit dhe nxenesit. Ne shume prej tyre mungojne pajisjet baze, si elektriciteti, uji i pijshem dhe tualete funksionale. (Edhe ne shkolla qe kane uje te pijshem, ai nderpritet per ore madje dite te tera, dhe nderprerjet e energjise jane tashme nje rutine.). Po ashtu mungon edhe ngrohja e nevojshme ne dimer. Sobot per ngrohje, ne shume raste, jane vjedhur ose shkaterruar gjate krizave te fundit, dhe nuk ka para per t’i zevendesuar ato. Lenda djegese eshte po ashtu e shtrenjte dhe e veshtire per t’u siguruar.

Tekstet. Ne kopshtet “HAP pas Hapi” nxenesit nxiten qe t’i krijojne vete tekstet. Perndryshe, kopshtet perdorin tekste nga shtepia botuese zyrtare Shteterore. Edhe manualet per mesuesit e kopshteve vijne nga shtepia botuese Shteterore. Ne disa nga kopshtet e vizituara nga ekipi nuk kishte fare libra, me perjashtim te atyre ne Anglisht ose Gjermanisht te dhuruara nga donatore te huaj. Te gjitha femijet e blejne kompletin e librave nga shkolla, ne fillim te Shtatorit, kur ata regjistrohen per vitin e ri shkollor. Ka shume libra cilesore, veçanerisht per femijet nga 5 vjeç e lart, ndersa per me te vegjelit ka me pak libra.

Ka pothuajse nje mungese totale te materialeve mesimore dhe lodrave ne kopshte. Pajisjet jane dhene kryesisht nga donatore te huaj. Fondet e vena ne dispozicion nga shteti jane te paperfillshem ne krahasim me nevojat. Nevojat financiare per infrastrukturen dhe pajisjet e kopshteve llogariten te jene shume te medha. MASH ka llogaritur qe nevojat totale per vitin 2000 do te jene USD 1 172 000 (EUR 1 285 440) - Buxheti i shetit mbulon USD 380 000 (EUR 416 781), qe lejon nje defiçit prej USD 792 000 (EUR 868 659). Duhet te inkurajohen nismat per angazhimin e siperarrjeve private.

Çeshtje te procesit: kurrikulum, mesimdhenie, mbipopullim. Cilesia e arsimit po vuan per shkak te pergatitjes se dobet te mesuesve dhe pagave te tyre te uleta. Shume mesues detyrohen ta lene profesionin per shkak te pages se ulet. Kurrikulat jane duke u permiresuar, ne disa raste me ndihmen e donatoreve te huaj, por shpesh mungon koordinimi i projekteve te tilla dhe zbatimi i tyre nuk eshte i njejte, sidomos kur ndryshimet ne kurrikulum nuk shoqerohen me pergatitjen e duhur te mesuesve dhe te materialeve mesimore (veçanerisht libra).

Kurrikulumi shteteror i kopshteve ka formen e nje manuali te pergatitur nga MASH ne 1993 dhe eshte aktualisht ne perdorim. Cilesia e ketij manuali nuk eshte ne standarde te pranueshme. MASH eshte e ndergjegjeshme per kete problem dhe ka krijuar hapshire per metoda te reja ne arsimin parashkollor duke i njohur ato zyrtarisht, dhe duke

e bere kete te vetmin nivel te arsimit me nje program te decentralizuar. Metodrat "Hap pas Hapi" dhe "Reggio Emilia" e kane kete status. Keto dy modele jane baza per hartimin e standardeve kombetare per arsimin parashkollor, te cilat jane duke u perfunduar. Mungojne librat qe mund te perdorin si burime nga mesuesit, edhe pse shume projekte kane botuar shume libra cilesore.

Ka mungese edhe te materialeve shtese dhe nderkurrikulare. Literatura e botuar nga institucionet shteterore eshte relativisht e varfer. Shume OJQ kane botuar literature bashkekohore per mesues e studente, e cila eshte e vogel ne numur dhe kryesisht per mesuesit dhe shkollat pilot te perfshira ne projekte dhe kjo literature nuk i ploteson nevojat e tregut.

Ne kopshtet "Hap pas Hapi" mesuesit bejne 80 ore trainim ne vit. Keto mesues po pergatiten per t'u bere vete trainues. UNICEF ofron tre dite ne vit seminare trainimi per mesuesit e pese shkollave ne Tirane dhe dy shkollave ne rrethe te tjera qe perdorin metoden "Reggio Emilia". Nje mesues ne nje shkolle te hapur rishtas, qe punon me metoden "Reggio Emilia" e mbeshtetur nga UNICEF, kishte qene tre muaj ne Itali per te mesuar rreth kesaj metode.

Mbipopullimmi eshte nje problem per kopshtet. Eshte e pamundur te mesosh 54 femije ne nje klase, sidomos kur ajo eshte e pajisur keq, ose e pa pajisur fare, dhe kur ka fare pak ose aspak vend ku femijet mund te luajne. Mesuesit me pergatitje te dobet nuk dine si t'i mesojne femijet ne te tilla kushte. Dikush e pershkroi gjendjen e femijeve si nje "neglizhim dashamires". Pas trazirave te 1997 shume njerez migruan nga zonat fshatare ne ato qytetare, gje qe ka sforcuar te tere sistemin arsimor, duke perfshire edhe kopshtet. Ne zonat fshatare shkollat kane me pak nxenes. Prinderit ne zonat fshatare nuk e perballojne dot dergimin e femijeve te tyre ne kopesht, dhe ne lagjet e reja e te varfra perreth Tiranes situata nuk eshte me e mire.

Gjinia dhe kushtet e punes. Te gjitha edukatoret e kopshteve ne Shqiperi jane femra dhe nuk ka nje shoqate te edukatoreve.

Arsimi dhe Formimi Profesional (AFP)

Drejtimi

Arsimi fillestar dhe ai i vazhdueshem profesional jane ne sferen e MASH, qe eshte pergjegjese per gjitha ciklin arsimor duke perfshire arsimin e larte dhe te mesem AFP. Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale (MPÇS) eshte pergjegjese per trainimin e vazhdueshem dhe ate te te rriturve.

Arsimi i mesem ndahet ne te pergjithshem dhe profesional. Programet e arsimit te pergjithshem zgjatin 4 vjet, dhe programet e studimit profesional nga 3 ne 5 vjet. Numri total i nxenesve ne nivelin e mesem (ne 2000) ishte 102 971, nga te cilet 14 501 ishin studente te AFP.

Para vitit 1990, shkollat profesionale ofronin pergatitje teknike dhe bujqesore, dhe 70% e nxenesve vazhdonin keto shkolla. Per momentin, AFP nuk luan ndonje rol te rendesishem ne kuadrin e arsimit te mesem ne Shqiperi dhe ka vetem 41 shkolla AFP, 30 prej te cilave jane shkolla profesionale 3 vjeçare dhe 13 jane shkolla teknike 5 vjeçare. Regjistrimet kane rene ne 15% te numurit total te nxenesve ne arsimin e mesem. Nje mase e madhe femijesh (rreth 50%) nuk marrin pjese ne arsimin dhe trainimin e pasdetyrueshem dhe nje numur i madh nxenesish e braktisin arsimin dhe trainimin para kohe.

Tabela 9. **Regjistrimet ne arsim/formim (14-25 vjeçaret) 1999-2000**

vjeç	Arsimi i pergjithshem			Arsimi Profesional		
	Meshkuj	Femra	TOTAL	Meshkuj	Femra	TOTAL
14	8 032	8 777	16 809	1 903	852	2 755
15	9 723	10 625	20 348	2 303	1 032	3 335
16	8 454	9 239	17 693	2 003	897	2 900
17	7 609	8 315	15 924	1 903	807	2 610
18	2 959	3 233	6 192	701	313	1 014
19	1 268	1 386	2 654	300	134	434
20	760	832	1 592	180	80	260
21	930	1 016	1 946	220	98	318
22	803	878	1 681	190	85	275
23	878	970	1 848	210	94	304
24	423	462	885	100	45	145
25	435	463	498	103	48	151
TOTAL 14-25	42 274	46 196	88 470	10 016	4 485	14 501

Burimi: Francesco Panzica, Tregu i Punes ne Shqiperi dhe Vlerisimi i Sektorit AFP. ETF: 2000. f. 44.

Keshtu, Shqiperia nuk ka nje strategji te veçante per AFP, megjithese ne kohen e vizites se ekipit, nje draft duhet te diskutohej me faktoret, para botimit. Qeveria shqiptare ka ngritur nje grup pune me synimin per te pergatitur nje punim per strategjine e arsimit qe do te perfshije edhe sektorin AFP. Punimi duhet te jete gati ne Korrik 2002.

MASH ka marre mbeshtetje te konsiderueshme nga donatoret, dhe jane ngritur shkolla pilot³¹ ne pjese te ndryshme te vendit per te testuar dhe zbatuar ne realitetin shqiptar sisteme te AFP te vendeve te zhvilluara. Aktualisht jane 41 shkolla te AFP disa prej te cilave jane te pajisura mire, ne gjendje te punesojne mesues te kualifikuar dhe te zbatojne kurrikula te reja. Shkollat pilot dhe institucionet shqiptare, ne vecanti ISP, kane punuar per bashkekohezimin e kualifikimit te mesuesve dhe kane ofruar trainime per menaxhim, konsulence per drejtimin e shkollave, futjen e kurrikulave te reja, dhe pergatitjen e materialeve mesimore. Shume, ne mos shumica e shkollave teknike e profesionale kishin nevojte per riparime pas trazirave civile te Marsit 1997, kur u vodh ose u shkaterrua shumica e orendive dhe pajisjeve.

Jane 5 shkolla te specializuara gjuhe ne Shqiperi, me 2 336 nxenes per Anglisht, Frengjisht, Gjermanisht, Italisht, Rusisht dhe Spanjisht. Ka gjithashtu edhe 1 151 nxenes ne 8 shkolla artistike te cilat pergatisin nxenes per muzike dhe arte te bukura. Pervec ketyre, dy shkolla sportive pergatisin atlete per te konkuruar ne vend dhe jashte tij. Pergatiten mesues ne 4 shkolla te mesme pedagogjike ne 4 qytete; ata qe mbarojne jane te kualifikuar per te dhene mesim ne arsimin baze, dhe shume prej tyre shkojne ne zonat fshatare. Ne Shqiperi lejohen dhe madje inkurajohen shkollat private, per shkak te mbipopullimit ne qytete, por per momentin nuk ka nje sektor domethenes privat ne AFP pasi shkollat e AFP kane tendencen te jene te kushtueshme dhe "te etura per burime". Disa institucione private ofrojne kurse trainimi per gjuhe te huaja dhe aftesimi ne kompjuter, por keto ndodhen te gjitha ne qytetet e medha dhe jo ne zonat fshatare.

Keshilli Kombetar i AFP

Gjate vizites se ekipit te OECD, ne Parlament po diskutohej nje propozim per te ngritur nje Keshill Kombetar te AFP te perbere prej tre palesh. Per shkak te kompleksitetit te ligjit dhe zgjedhjeve te reja te Qershorit 2001, ligji u aprovua vetem ne Mars 2002. Keshilli do te jete nje njesi qe do te mblidhet per te mundesuar nje forum tripalesh me qellim qe te keshilloje Qeverine per politiken, strategjine, dhe alokimin e burimeve. Ai do te promovojte AFP ne te gjithe spektrin shoqeror dhe ekonomik dhe do te beje te mundur qe te merren parasysh nevojat e partnereve sociale. Nepermjet Keshillit do te behet edhe vleresimi e monitorimi i dublimit dhe fragmentimit te agjencive aktuale, kombetare dhe nderkombetare, donatoreve dhe sektorit publik. Banka Boterore gjithashtu mund te jape fonde per ngritjen e Keshillit.

Zhvillimi i kurrikulumit, standardet dhe vleresimi ne AFP

Per sa i perket arsimit te mesem te pergjithshem dhe AFP, MASH eshte pergjegjese per hartimin e kurrikulave, qe realizohet nga ISP. Qysh nga 1998, ka programe teknike dhe profesionale 3 dhe 5 vjeçare; programi i arsimit teknik 5 vjeçar çon ne provimet e matures te percaktuara nga MASH (permes ISP), dhe jep akses ne arsimin e larte per kandidatet e suksesshem. Programet 4 vjeçare jane nderprere qysh nga 1998.

³¹ Shih Francisco Panzica, *Vleresimi i Tregut te Punes dhe AFP ne Shqiperi*, ETF, Nentor 2000, f. 45. Me aktivet kane qene Banka Boterore, Bashkimi European, Organizata Nderkombetare e Punes (ILO), UNDP dhe nje numur donatoresh dhe OJQ bilaterale.

Lidhur me qendrat e AFP per te rriturit, kompetencat, edhe per hartimin e kurrikulimit i ka MPCŞ. Ne fakt, sidoqofte, ketu MPCŞ nuk luan rol te dores se pare, keshtu qe vete trainuesit jane pergjegjes per hartimin dhe zbatimin e kurrikulimit. Jane 9 qendra trainimi qe ofrojne kurse profesionale afatshkurtra per kategori te ndryshme te rriturish; nje total prej 70 instruktoresh japin mesim ne qendra te tilla. Nevojat e verteta lokale te tregut jane pak te perfaqesuara. Nuk ka nje metodologji te pranuar per zhvillimin e kurrikulimit dhe mungojne procedurat e qarta te aprovimit si edhe infrastruktura per realizimin e kurrikulimit. Ne sektorin privat dhe te OJQ, situata e kurrikulimeve karakterizohet nga konfuzioni. Pa nje kuader kombetar kualifikimi, qendrat e trainimit veprojne ne liri te plote.

Mungon gjithashtu edhe vazhdimesia midis AFP fillestar dhe trainimeve te metejshme/per te rritur, dhe eshte krejtesisht i panjohur ne ambientin e kurrikulimit koncepti i "te mesuarit gjate gjithe jetes". Kurrikulat profesionale ne nivelin e arsimit te larte i japin me teper perparesi njohurive akademike se aftesive teknike e praktike te nevojshme ne tregun e punes. Teoria e tejkalon pergatitjen praktike ne 80% me 20%, qe perben nje kufizim serioz ne pervesesimin e aftesive te tregtueshme. Papunesia rinore ne Shqiperi eshte e larte, dhe shume te rinj (edhe me kualifikime AFP) nuk jane ne gjendje te gjejne pune.

Asistenca e KE-Phare per Reformen e AFP ne Shqiperi

Projekti i KE-Phare e permbushi objektiven e vet duke permiresuar aftesine e sistemit te AFP per te ofruar zhvillimin e shprehive me te nevojshme ne nje grup te vogel perfituesish. Megjithate, reformat e nisura mund te mos kene vazhdimesi pa shtesa te konsiderueshme ne financime dhe asistence teknike. Projektet pilot duhej te pergatitnin terrenin per nje nderhytje me te gjere te Phare ne sektorin e AFP, kjo, sidoqofte, nuk u materializua siç pritej per shkak te zhvillimeve te fundit politike ne Ballkan.

Ekipi qe i dha asistence teknike programit ishte e detyruar te harxhonte shume kohe dhe energji per probleme te panevojshme administrative dhe logjistike, si psh, zhdoganimin e pajisjeve, qe zvogeloi suksesin e pergjithshem te projektit.

Kohezgjatja e kurseve ne secilen shkolle pilot e kaloi ate te projektit dhe fondet per blerjen pajisjeve ishin te pamjaftueshme per te mbuluar nevojat e kurseve qe ishin ne proces.

Udheheqja dhe keshillimi, siç ishin parashikuar ne program, nuk u bene objekt trajtimi sistematik nga ofruesit e trainimit. Stafet i secilit nga vendet e caktuara si pilot hezitoni dhe /ose nuk ishin ne gjendje te vendosnin lidhje me Strategjine Kombetare per Arsimin apo me punedhensit qe ndodheshin ne hapesiren e ngushte rreth tyre.

Trazirat civile te pranveres 1997 shkaktuan çrregullime te medha ne afatet kohore te veprimtarive te Projektit BE-Phare. Megjithate, ky problem u kapercye fale nje qendrimi pozitiv dhe fleksibel te te gjitha paleve te angazhuara ne projekt. Tani ka filluar

nje projekt i ri ne kuadrin e CARDS 2002-2004 (nje program rajonal i BE) qe do te perfshije projektet TEMPUS dhe AFP.

Qendrat Shteterore te Formimit ndodhen ne 6 qytete (Tirane, Durres, Elbasan, Vlore, Korçe dhe Shkoder); ato kane trainuar nje total prej 27 000 personash ne 16 specialitete duke perfshire riparimin e automobilave, riparimin e TV dhe pajisjeve elektronike, hidraulike etj.). Ka githashtu edhe nje numur qendrash private trainimi per profesione si gjuhet e huaja, kompjuterat, dhe per stiliste/rrobaqepese. OJQ kane mbeshtetur kurse per administrim biznesi, menaxhim te burimrve njerezore, rrjete kompjuterike, menaxhim industrial etj. Ne 1999, ne institucionet publike te trainimit kishte nje total prej 634 te trainuarish, shumica e te cileve te regjistruar ne kurse sekretarie (mbi 50%) dhe pjesa tjeter ne kurse per parukiere, stiliste/rrobaqepese, riparim makinash dhe elektrikiste.

Çeshtje dhe Barriera ne Arsimin Profesional

Mungesa e zhvillimit ekonomik te integruar, e afatgjate dhe / ose e politikës apo strategjise se punesimit ne nivel Shteteror; kjo ndikon ne sistemin e AFP i cili nuk ka udhezimet e mjaftueshme nga pikepamja e kerkesave per te drejtuar zhvillimin e vet. Te rinjte perballen me pasigurite e tregut te punes dhe kane nevojte te pajisen me shprehi te transferueshme dhe njohuri te gjera qe ta bejne te mundur kete ndryshueshmeri.

Mungesa e angazhimit te strukturuar te partnereve sociale qe perfaqesojne anen e kerkeses ne zhvillimin e politikave te punesimit. Ofrimi i trainimit per menaxhim ne Shqiperi eshte i papershtatshem dhe i pamjaftueshem per t'iu pergjigjur sfidave dhe mundesive qe paraqet pershtatja e kompanive egzistuese ne zhvillim me ndryshimet teknologjike dhe tregun nderkombetar.

Pergjegjesia per qendrat AFP per te rriturit, duke perfshire kurrikulat, eshte e MPÇS. Nuk ka nje metodologji te pranuar per zhvillimin e kurrikulimit dhe mungon nje infrastrukture e centralizuar ne Ministri, keshtu qe vete trainuesit jane direkt pergjegjes per hartimin dhe zbatimin e kurrikulimit. Pa nje skeme kombetare kualifikimi, qendrat e trainimit veprojne ne liri te plote.

Ka nje numur te madh mesuesish per sektorin e AFP qe jane te kualifikuar te papune, dhe nje numer akoma me te madh mesuesish ne sistem, qe nuk i permbushin kerkesat per mesimdhene sipas nevojave te ndryshimit dhe reformave. Meqenese nuk ka mundesi per t'i pushuar ata, eshte urgjentisht i nevojshem nje plan veprimi, duke perfshire trainimin ne detyre per nje pjese te tyre dhe masa sociale per ato qe nuk mund te rikonvertohen ne staf mesimor permes nje trainimi te pershtatshem.

Arsimi i Larte (AL)

Ne 1999/2000, ne kategori te ndryshme te arsimit terciar ishin regjistruar gjithsej 39 848 studente (5% e numrit total te studenteve ne arsimin e mesem ne Shqiperi). 60% e tyre ishin femra. Arsimi i larte ofron programe 4, 5 dhe 6 vjeçare ne universitete (ISCED 5A) dhe ne programe 3.5 vjeçare ne institucione terciare jo-universitare (ISCED 5B) Studimet per doktorature zgjatin mesatarisht 3.5 vjet (ISCED 6).

Ka (ne vitin 2000) 8 universitete te akredituara dhe 3 institucione te larta jo-universitare, dhe mungojne institucionet e larta jo-universitare me orientim profesional. Pak me shume se gjysma e studenteve jane me shkeputje nga puna (full-time). Numuri i studenteve pothuajse u dyfishua ne periudhen 1990 dhe 2000 (nga 21 000 ne 40 000), por pothuajse e gjithe rritja eshte ne numurin e studenteve qe studiojne me korrespondence (part-time), (nga 4000 ne 18 000). Ne Shqiperi nuk ka institucione terciare (te larta) private. Egziston nje ndergjegjesim per faktin qe studentet do te jene te ekspozuar ndaj tregut dhe sfidave te tij dhe qe reformat jane te domosdoshme.

Çeshtje dhe Barriera ne Arsimin e Larte

Ligji me i fundit per arsimin eshte bere ne vitin 1999, por jane duke u pergatitur ndryshime dhe, per vitin 2003, eshte planifikuar nje reforme ne arsimin e larte ne frymen e Proçesit te Bolonjes. Ligji i 1999 pasqyron nje numur permiresimesh sipas prioriteteve te identifikuara ne nje strategji te perpunuar me Keshillin e Europes (1996-98). Pas kesaj, do te jene te nevojshme ndryshimet ligjore ne fushat e vleresimit te cilesise, zgjedhjeve te organeve drejtuese, pavaresise financiare dhe institucionale dhe permiresimit te proçedurave te pranimit.

Struktura e sistemit te arsimit te larte mbetet shume e centralizuar dhe pavaresia e universiteteve eshte teper e kufizuar, sidomos persa i perket çeshtjeve financiare, megjithese kjo ishte parashikuar ne ligjin e vitit 1999. Universiteti eshte i lire te zgjedhe stafin e vet, por numri caktohet nga Ministria. I vetmi burim fondesh eshte shteti, dhe nuk ka asnje institucion privat qe te financoje AL megjithese jane krijuar mundesite nga ligji. Tarifat egzistuese per te studiuar nuk jane nje burim i rendesishem financimi.

Ngritja e Keshillit Kombetar te Akreditimit dhe e nje sistemi qe te siguroje cilesi jane elemente qe parashikohen ne ligjin e vitit 1999, por ato akoma nuk jane realizuar plotesisht. Egziston Agjencia e Akreditimit (permes nje projekti BE-TEMPUS) por deri tani ajo ka arritur rezultate te kufizuara. Objektivat e Keshillit Kombetar eshte menduar te jene egzaminimi i rezultateve te Agjencise, vleresimi i cilesise se universiteteve dhe raportimi ne Keshillin e Ministrave.

Arsimi i larte ka terhequr fare pak mbeshtetje nga komuniteti i donatoreve keto dhjete vitet e fundit, sidomos i krahasuar me arsimin baze dhe te mesem. Ndikimi negativ i ketij fakti ne cilesine e mesimdhenies, kerkimit shkencor dhe sherbimit eshte mjaft i dukshem. Infrastruktura (labororet, bibliotekat etj.) jane ne gjendje te keqe, dhe per pasoje, kushtet nuk jane aspak motivuese per studentet dhe profesoret e rinj. Eksperienca

e stafit universitar dhe njohurite akademike nuk perdoren ne projektet ne shkalle te gjere per infrastrukturen te cilet jane ne proçes ne sektore te tjere te ekonomise.

Zhvillimi ekonomik i Shqiperise eshte shume i dobet, por megjithate ne rritje te ngadalte. Tregu i ardhshem i punes, investimet e huaja dhe proçesi i reformave demokratike do te krijoje gjithnje e me shume nevoje per profesioniste me kualifikime (akademike dhe profesionale) te larta. Marredheiet e universiteteve me shoqerine civile si edhe me ndermarrjet nuk jane shume te zhvilluara. Duket se keto çeshtje nuk jane prioritete te qeverise, por gjithsesi kane nje ndikim negativ ne zhvillimin e pergjithshem te vendit.

Rekomandime sipas Seksioneve.

Drejtimi dhe Administrimi

Te zhvillohen strukturat baze. Pesimizmi i pas-1997 eshte ne renie dhe progresi eshte e i dukshem, per shembull, ne kuadrin ligjor i cili po krijohet dhe po i jep forme strukturave drejtuese ne arsim dhe trainim. Per vitin 2001-2003 eshte pergatitur nje draft per nje kuader financiar afatmesem. Tani buxheti pasqyron si investimet edhe kostot operative. Arsimi konsiderohet si nje instrument i rendesishem i reformes per reduktimin e varferise dhe decentralizimin e pushtetit. Propozimet sugjerojne rritjen e perqindjes se GDP qe i alokohet arsimit si edhe rritjen me 10-20% te pagave shume te uleta te mesuesve. Ka prova se rindertimi i godinave te shkollave, qe ka qene nje perparesi e madhe qysh nga viti 1997, po jep rezultate persa i perket permiresimit te ambientit fizik te mesimdhënies dhe te nxenit. Ne arsimin e larte eshte konfirmuar pavaresia institucionale, jane ngritur strukturat drejtuese dhe eshte filluar reforma kurrikulare.

Te zhvillohet dhe forcohet misioni i MASH dhe i departamenteve te saj. Edhe pse nuk mund te ndryshohet akoma sistemi i thesarit te Shtetit dhe shperndarja e parave nen mbikqyrjen e MASH, kesaj te fundit i duhen dhene me shume pergjegjesi per financimin e arsimit. Brenda Ministrise, departamentet e linjave duhet te kene pergjegjesi te plote per planifikimin dhe vendim-marrjen per alokimin e parave. Alokimi i buxhetit per çdo shkolle nuk duhet te vendoset nga MASH, por ekipi vleresu mendon se (per momentin) kjo mund te mbetet akoma e nevojshme per shkak te mungeses se njesive ndermjetese kompetente.

Politika dhe standardet. MASH duhet te perqendrohet ne çeshtjet strategjike dhe ne drejtimin e sistemit arsimor duke bere politike dhe duke vendosur standarde. Duhet te forcohet pozita udheheqese e MASH ne drejtimin e arsimit. Nevojitet nje kuader proçedurash buxhetore per te bere te mundur qe Ministria e Finances te decentralizojë planifikimin dhe vendim-marrjen per fondet ne dobi te ministrive te linjes.

Te sqarohen rolet dhe marredheniet mes “aktoreve” te ndryshem ne drejtimin e arsimit. Krahas MASH, ka edhe kater nivele aktoresh ne drejtimin e arsimit: Instituti i Kerkimeve Pedagogjike i Shqiperise, Departamentet e Rretheve te MASH, bashkite dhe

Bordet e Drejtimit të Shkolles. Në arsimin e lartë aktoret janë universitetet dhe fakultetet. Misionet dhe rolet respektive të tyre duhen riformuluar, duke u përqendruar në llojin e ekspertizës që pritet prej tyre dhe në çështjet më të rëndësishme e më urgjente.

Organizimi ekspert në nivelin qendror duhet të jetë nën mbikqyrjen e MASH dhe duhet të përqendrohet në cilësinë e arsimit dhe trainimit nëpërmjet zhvillimit të një kuadri koherent kurrikulumi, të kurrikulave lëndore dhe standarteve për rezultatet e të nxenit, dhe nëpërmjet përhapjes së përvosjes, rezultateve, dhe materialeve të mira. Ai duhet gjithashtu të mbështesë zhvillimin e përmbajtjes dhe cilësisë së teksteve shkollore.

Departamentet e Rrethëve të MASH duhet të fokusohen në raportimin dhe dënimin e informacionit për MASH lidhur me gjendjen, zhvillimin dhe nevojat e shkollave në rrethet e tyre. Ata duhet gjithashtu të ndihmojnë bashkitë dhe Bordet Drejtuese të Shkollave në zgjidhjen e problemeve. Krahas kësaj, Departamentet duhet, në bashkëpunim me organizatat eksperte në qendër, të përhapin ndryshimet në kuadrin e kurrikulimit kombëtar, në kurrikulat e lëndëve, dhe në standardet e të nxenit.

Bashkitë dhe komunat duhet të përqendrohen në garantimin e sigurisë dhe mirëmbajtjes së shkollave, në shërbimet sociale për nxënësit, si edhe në mobilizimin e burimeve shtesë për shkollat.

Bordeve të Drejtimit të Shkollave duhet t'u jepet më shumë pushtet, për shembull, emërimi i mesuesve dhe drejtoreve, përdorimi i fondeve, dhe planifikimi i vitit shkolle.

Një formulim i ri dhe i qartë i misioneve dhe përgjegjësisë, i kombinuar me forcimin e pushtetit të Bordeve Drejtuese të Shkollave, do të krijonte një bazë të shëndoshe për decentralizimin e drejtimit në arsim si gjatë, ashtu edhe pas zbatimit të strategjisë afatmesme.

Të krijohet një Task Force për Strategjinë Kombëtare për Arsimin. Përsa i përket strategjisë së arsimit në Shqipëri, nevojitet konsensus dhe perkushtim, dhe kjo mund të arrihet përmes diskutimeve dhe nismave nga poshtë-lart në lidhje me këtë çështje. Për zbatimin e strategjisë duhet të zhvillohet një plan veprimi. Prandaj, nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës duhet të ngrihet një Task Force për zbatimin dhe vazhdimin e Strategjisë. Mandati i kësaj njesie të re strategjike të MASH duhet, në bashkëpunim të ngushtë me departamentet e linjës dhe nivelet e tjera të drejtimit të arsimit, t'i japë përparesi kryesore zhvillimit të infrastrukurës së arsimit, çështjeve kryesore si rrjeti i shkollave, rehabilitimi i ndërtesave shkollore, riformulimi i strukturave të arsimit dhe trainimit, ritrainimit të drejtoreve dhe mesuesve sipas strategjisë, zhvillimit të cilësisë së prodhimit të teksteve shkollore.

Të përmirësohet koordinimi i projekteve për reforme. Janë për t'u lavdëruar përpjekjet e qeverisë qendrore për të koordinuar përparesitë dhe projektet e saj me ato të komunitetit të donatoreve. Projektet e përbashkëta midis saj dhe Programit për Zhvillimin e Arsimit Shqiptar (AEDP-Instituti për Shoqërinë e Hapur) janë raste të shkëlqyera që e dëshmojnë këtë. Ngritja në vitin 1999 e Zyres së Monitorimit dhe Vlerësimit në

Ministrine e Arsimit dhe bashkepunimi i saj me Bordin e Donatoreve (jane identifikuar 23 donatoret kryesore) jane gjithashtu premtuese per te zvogeluar mbivendosjen e projekteve. Te tilla jane edhe udhezimet dhe procedurat per mbledhjen e te dhenave qe ajo ka zhvilluar. Ketyre funksioneve teknike, per me teper, iu bashkangjit edhe nje funksion strategjik shume i nevojshem – perkatesisht, realizimi i vleresimeve horizontale dhe vertikale ne te cilet vleresohet inputi, outputi dhe ndikimi i projekteve te vleresuara. Te tilla vleresime mund te perdoren me pas si burim informacioni per transferimin e arritjeve te projekteve te suksesshem dhe krijues ne zbatime ne shkalle me te gjere ne sistem.

Nje funksion strategjik i duhet shtuar Zyres se Monitorimit dhe Vleresimit ne MASH me futjen e vleresimit horizontal (perkundrejt vleresimit vertikal te projekteve te vecante) qe do te çonte ne zbatimin me te gjere ne sistem te projekteve te suksesshem dhe krijues; ky funksion i ri do te shtonte vlerat e drejtimit te pergjithshem te bere nga Ministria dhe me ndihmen e njesise strategjike te rekomanduara me lart.

Te vendosen kriteret dhe transparencen per financimet. Metodet aktuale te financimit dhe shperndarja e tyre jane teper te centralizuara. Krahas kesaj, parate shkojne ne shkolla te pakten nga tre burime te ndryshme (MF, MASH, bashkite) duke shtuar ketu edhe financimet e bera nga prinderit dhe burime te tjera private. Ne lidhje te ngushte me rekomandimet e bera me lart, modelet e financimit duhet te ndryshohen me qellim qe te kete vetem nje kanal per levizjen e parave nga niveli qendror tek shkollat. Pergjegjesia per financimin e shkollave duhet te percaktohet shume qarte dhe t'u jepet Shtetit dhe autoriteteve lokale, ne menyre qe te mos kete asnje dyshim se kujt i jane dhene dhe kush eshte pergjegjes per te financuar nje shpenzim te caktuar. MASH duhet te vendose nje model financimi, te bazuar ne formule, i cili te mundesoje nje metode administrativisht te vlefshme per te financuar lloje te ndryshme shkollash ne rrethe te ndryshme te vendit. Gjithashtu, nga MF duhet te vendoset nje model financimi i bazuar ne formule per subvencionimet e bashkive. Keshtu, granti aktual per bashkite i dhene nga MF mund te shnderrohet ne nje sistem nga i cili parate e nxjerra per shkollat te perfshihen ne financimin e bazuar ne formulen e dhene nga MASH .

Te strukturohet nje sistem informacioni per rezultatet. Duhet ndermarre masa per te rritur cilesine, efektivitetin dhe besueshmerine e sistemit arsimor dhe te shkollave. Nje nga objektivat e deklaruara te Projekt Strategjise per Arsimin eshte ngritja e standarteve ne nivelet qe kerkon integrimi eventual ne BE dhe ne sistemin boteror te arsimit. Nje fillim i mire eshte marreveshja me anen e se ciles Shoqeria e Hapur dhe MASH ndihmuan per te financuar koston kombetare te pjesemarrjes se Shqiperise ne projektin OECD/PISA (Programi per Vleresimin Nderkombetar te Studenteve). Megjithate do te nevojitet fond shtese nese Shqiperia do te vazhdoje te qendroje ne PISA³² per nje raund te dyte. Gjithashtu, eshte e nevojshme qe ne te gjithe sistemin arsimor te futen dhe te zbatohen sistematikisht standarte nderkombetare te krahasueshme per arritjet dhe, rezultatet e te nxenit te perdoren per caktimin e bazuar ne fakte te prioriteteve ne alokimin e burimeve te pakta.

³² Kostot nderkombetare te projektit PISA mbulohen prej nje granti nga Finlanda.

MASH duhet te filloje, ne menyre urgjente aplikimin e matesve nderkombetarisht te krahasueshem per cilesine, efektshmerine dhe besueshmerine e te nxenit ne te gjithë nivelet e sistemit shkollor. Profesionistet, drejtuesit dhe mesuesit duhet te trainohen per t'i zbatuar ato me rregull, ne nje menyre sistematike dhe transparente, dhe rezultatet t'u vihen menjehere ne dispozicion faktoreve te interesuar. Sistemi i informacionit per menaxhimin e arsimit duhet te zhvillohet ne menyre graduale dhe te permbaje treguesit e arritjeve te shkollave.

Te krijohen kapacitete njerezore dhe institucionale ne nivelin e arsimit terciar (arsimit te larte). Drejtimi dhe menaxhimi i arsimit te larte u trajtuan me ligje ne 1995 dhe perseri ne 1999 u konfirmua pavaresia e Universiteteve dhe se fundi jane ngritur strukturat e zgjedhura drejtuese. Jane bere edhe reforma kurrikulare. Ajo qe nevojitet tani eshte futja e sistemeve te menaxhimit financiar, dhe krijimi i kapaciteteve per administratoret titullare dhe stafet e tyre ne kete sektor.

Duhet te filloje nje program per krijimin e kapaciteteve per te mbeshtetur ndermarrjen e hapave te Strategjise. Krahas kesaj, duhet te zhvillohet nje program i ngjashem per administratoret titullare te unversiteteve dhe stafet e tyre ne lemin e sistemeve te menaxhimit financiar dhe veprimtarise se tyre. Keto programe mund te ofrohen nga Shteti ose nga donatoret nderkombetare, apo nga nje kombinim i te dyve, por ne çdo rast, duhet te jene te mbeshtetur nga eksperte nderkombetare.

Te rishikohet mbeshtetja financiare per arsimin e larte. Arsimi i larte ka terhequr fare pak mbeshtetje nga komuniteti i donatoreve keto 10 vitet e fundit, sidomos ne se krahasohet me arsimin baze dhe te mesem. Sidoqofte, shifrat e Bankes Boterore³³ tregojne se perfitimi privat nga investimet ne arsimin e larte eshte vetem 2.5% (krahasuar me 13-16% per arsimin baze), ndersa perfitimi shoqeror eshte vetem 1% (krahasuar me 11% per arsimin baze). Prandaj, ne kushtet aktuale te Shqiperise, financimet shteterore duhet te perqendrohen ne arsimin e detyrueshem (klasat 1-8), ndersa per arsimin terciar duhen marre ne konsiderate opsione te tjera (psh, tarifa pranimi sipas mundesive).

Ne te njejten kohe, Shqiperia ka nevojë per sektorin e arsimit te larte qe te mund te siguroje zhvillimin ekonomik dhe social te vendit. Mungesa e fondeve ka pasur nje ndikim negativ ne cilesine e mesimdhënies, te kerkimit dhe sherbimit. Labororet kane shume nevojë per riparime, pajisjet shkencore moderne mungojne dukshem, dhe rrjetet kompjuterike e aksesit elektronik ne biblioteka jane te pakta. Keto dobesi, te shoqeruara edhe me largimin e trurit te shume profesoreve te rinj (rreth 40% jane larguar nga Universiteti i Tiranës gjate dekadës se fundit), kane hedhur dyshime serioze mbi mundesine e zëvendësimit te akademikeve te larte. Nuk egzagjerojme te themi se po vihet, pa qene nevoja, ne rrezik kontributi aq shume i rendesishem i arsimit te larte ne zhvillimin ekonomik dhe prosperitetin kombetar.

Ne nje kendveshtrim me detyrues dhe praktik, eshte e veshtire te kuptohet pse stafi universitar nuk perdoret me shume ne projektet infrastrukturore te shkalles se gjere

³³ G. Palomba dhe M. Vodopivec, *op.cit*, faqe 14.

(autostrada, porte, etj.) te cilat jane ne proçes. Shume vezhgues me pervoje dhe nepunes te qeverise e konfirmuan kete anomali por nuk ishin ne gjendje te jepnin shpjegime.

Krijimi i kapaciteteve kombetare dhe nje zhvillim me i barabarte rajonal i vendit kane nevoje per njohurite shkencore dhe aftesite praktike te stafeve universitare. Prandaj, Strategjia Kombetare nuk duhet ta neglizhoje zhvillimin e shendoshe te sektorit te arsimit te larte. Krahas kesaj, projektet qeveritare dhe donatore te çdo lloji (por sidomos ato ne fushen e puneve publike) duhet, ne menyre rutinore, te shfrytezojne aftesite, kompetencen dhe pervojën e stafeve te institucioneve shkencore te Shqiperise.

Kurrikulumi

Duhet te krijohen struktura dhe proçese te thjeshta dhe transparente ne te gjitha nivelet e politikës dhe administrates publike me qellim qe çdo perdorues i sistemit te kete mundesi te kontribuojë me inpute dhe te kontrollojë proçeset. Pjesemarrja e aktoreve lokale – prinder, femije, nxenes dhe perfaqesues te administrates publike lokale – duhet te garantojë mundesine per te bashke-vendosur per marreveshje dhe proçese te cilat ndikojne tek ata, ne zonat e veta. (Per shembull, ne caktimin e kriterëve te perzgjedhjes ne rastet kur nuk ka vende te mjaftueshme ne kopshte, shkolla dhe universitete). Informacioni i plote dhe ne format te lexueshem eshte nje parakusht i nevojshem per te krijuar besim.

Me qellim qe te evitohet perseritja e eksperiencave te se shkuars, per te cilat duhet akoma pune, apo tabute, qe kane mbetur per t'u hequr pa u bere akoma nje barriere e pathyeshme ne nivelin aktual te komunimit, eshte e nevojshme te behet nje perpjekje per te trajtuar dhe per te punuar, ne menyre shkencore, sistematike dhe publike, me temat e vazhdimesise dhe te trazirave ne tranzicionin nga sistemi i vjeter politik tek sistemi i ri. (me nje debat te gjere publik). Duhet zhvilluar projekte per edukimin qytetar per te gjithë nivelet e sistemit (arsimor) ne sferen e te mesuarit gjate gjithë jetës dhe edukimit per te rriturit.

Projekt Strategjia Aftatmesme Kombetare per Arsimin eshte nje fillim i mire si nje plan per te ardhmen; sidoqofte, meqenese eshte shkruar vetem nga pak njerez, dokumenti duhet t'u vihet ne dispozicion mesuesve, prinderve dhe drejtuesve dhe inputi i tyre duhet te perfshihet ne dokumentin perfundimtar. Per te tjere projekte rekomandohet perfshirja e te gjithë partnereve te mundshem persa i perket bashkepunimit horizontal dhe vertikal. Pastaj mund te hartohet nje plan veprimi, sa me shpejt qe te jete e mundur, i cili te realizojë objektivat e caktuara si prioritare. Qellimi final, siç eshte shprehur, eshte nje arsim me efektiv per te gjithë nepermjet rritjes se efijences se sistemit, gje qe mund te realizohet vetem me nje perpjekje te perbashket dhe te koordinuar.

Decentralizimi eshte nje objektive e Projekt Strategjise, por, per ta bere ate te efektshem, duhet bere trainime per aftesimin menaxhues te atyre qe do te kene pergjegjesi dhe marredhenie te reja. Per shembull, tani pushteti lokal do te bashkepusoje me ngushte me Drejtorine Arsimore e cila punon direkt me drejtoret e shkollave. Secili prej tyre ka nevoje te kuptojë rolet e veta ne sistem. Inspektoriati do t'i raportoje

Ministrise; perseri rolet kane nevoje per nje percaktim te qarte dhe per menjanimin e mbivendosjes se detyrave. Njerezit ne funksione drejtuese te çdo lloji kane nevoje per trainim, sidomos kur dalin nga nje shoqeri jashtezakonisht autoritare.

Te angazhohen me sukses mesuesit ne bashkepunimin ne nivel lokal dhe te kontribuojne per zhvillimin profesional. Duhet te behet e mundur nje ngritje e pagave e cila do t'u kerkonte mesuesve te kalonin me shume kohe ne shkollë gjate javes (dy mbasdite) per te planifikuar punen, per pergatitjen per punet ne ekip, diskutime konsultative me koleget, prinderit dhe nxenesit, per trainimet, dhe per zhvillimin e kurrikulimit ne prishatje me nevojat lokale te shkollës.

Te ngrihen "rrethet e cilesise" per nje shkembim te brendshem mendimesh lidhur me performancen e mesimdhënies dhe te administrates lokale, qe t'i sherbejne zhvillimit te kurrikulimit dhe nje cilesie me te mire. (Cilesia e mesuesve gjithashtu theksohet ne Projekt Strategji). Ne keto rrethe duhet te angazhohen te gjithë aktoret perkates ne te gjithë nivelet e sistemit arsimor. Kjo mund te kontribuonte gjithashtu ne normalizimin e sistemit arsimor dhe ne rritjen e efektshmerise se brendshme.

Ka fare pak komunikim midis Institutit te Studimeve Pedagogjike (ISP) dhe universiteteve qe pergatisin mesues. Duhet vendosur nje bashkepunim me i mire midis te dyve. Po ashtu, universitetet duhet te bashkepunojne me MASH per te bashkerenduar trainimin me synimin per nje pergatitje me te efektshme per tregun e punes.

Bazuar ne punen ne shkollat pilot, reforma e kurrikulimit ne trainimin profesional duhet te çoje ne standarte kombetare te cilat te hartohen ne bashkepunim te ngushte me te gjithë partneret e angazhuar. Me qellim qe keto ide te zbatohen, eshte e nevojshme te rriten pavaresia dhe pergjegjesia ne te gjitha shkollat (jo vetem ne ato profesionale).

Nje pjese e trainimit te mesuesve ne detyre duhet t'i kaloje qendrave lokale dhe t'u ofrohet shkollave te veçanta. Per te bere te mundur nje perqendrim me te madh tek nevojat lokale duhet me shume fleksibilitet ne realizimin e trainimeve ne detyre. (Shih gjithashtu rekomandimet per pagat e mesuesve dhe frekuentimin ne shkollë).

ISP-se i eshte dhene pergjegjesi per zhvillimin e kurrikulimit si edhe disa detyra te tjera si trainimi i mesuesve, hartimi i Projekt Strategjise, dhe teksteve. Ai ka nevoje per me shume mbeshtetje teknike dhe kontakte me organizata homologe ne vende te tjera, per te percaktuar me saktësi rolin qe duhet te luaje. ISP kerkon me shume drejtim dhe mbeshtetje financiare nga qeveria me qellim qe te shpejtoje hapat per reformen kurrikulare. Per te shmangur mbivendosjen, sidomos ne trainimin e mesuesve – qe perben edhe nje pjese te rendesishme te reformes kurrikulare - eshte gjithashtu i nevojshem nje permiresim i komunikimit ndermjet universiteteve dhe ISP, me nje percaktim te qarte te pergjegjesive te secilit. Sot per sot sistemi perqendrohet me teper tek inputet se sa tek outputet; pjeses me te madhe te mesuesve u duhet ta zhvillojne nje tekst faqe per faqe, ne vend qe ta zhvillojne lenden si nje te tere. Reforma kurrikulare do te sillte me shume besueshmeri ne çdo nivel, por nevojitet gjithashtu edhe nje liri zgjedhjeje per metodat dhe materialet.

Servera per internetin duhet te ngrihen jashte Tiranes per t'i bere te mundur studenteve dhe mesuesve te mesojne arritjet me te fundit ne çdo fushe; aktualisht, studentet jane te detyruar te perdorin Internet-kafenete ne vend te shkollave dhe kompjuterave. Perparimet ne fushen e komunikimit jane te rendesishme ne arsimin modern. Si mesuesit ashtu edhe nxenesit kane nevojë per aftesi ne kompjuter.

Vleresimi i Rezultateve te te Nxenit

Ne pergjigje te shqetesimeve arsimore lidhur me ndikimin e e provimeve te jashtme mbi kurrikulumin, duhet qe specialistet e vleresimit dhe te kurrikulumit ne lende te ndryshme te punojne se bashku ne Grupet Lendore te Punes per te bere te mundur qe, gjithë permbajtja dhe aftesite/kompetencat e rendesishme te percaktuara ne objektivat e kurrikulumit, te gjejne mbulim nga objektiva te qarta vleresimi. Keto objektiva vleresimi duhet te gjejne vend ne planet e veçanta te lendeve qe jane , ne fakt, “kontrata” me anen e te cilave njesia egzaminuese shpreh me qartesi ate çka nje studnet pritët te dije, te kuptoje, dhe te jete ne gjendje te beje ne ate lende, me qellim qe edhe mesuesit nga ana e tyre te dine me qartesi se me çfare permbajtjeje dhe kompetencash duhet te punojne me nxenesit e tyre. Per aq kohe sa objektivat e vleresimit do te permbajne objektivat e rendesishme te kurrikulumit, mesimdhënia dhe te nxenit do te jene te perqendruara me mire dhe me pak te varuara nga preferencat e veçanta te nje mesuesi.

Reagimi politik dhe publik ndaj ndryshimit eshte me i veshtire per t'u kapercyer, sidomos ne fillim. Niveli i kalueshmerise ne provimet e matures eshte i larte, dhe studenteve qe kane ngelur u krijohet mundësia per te hyre perseri ne provim. Sikur provimet e jashtme te ishin me rigorozë dhe mesuesit ne klase te kishin me pak kontroll mbi vleresimin me note dhe mbi kalueshmerine e nxenesve te tyre, do te rritej me shume mundësia qe nivelet e ngeljes se studenteve te ishin me te larta. Ne pergjigje te kesaj mund te ndermerren dy veprime. I pari eshte te sigurohemi qe gjithkush te dije se çfare duhet te prese (permes nje fushate pozitive informacioni); dhe i dyti eshte te sigurohemi qe studentet ngeles te kene mundësi zgjidhjeje permes riprovimeve.

Projekti i dyte i Qeverise Shqipatre/Bankes Boterore ka nje komponent thelbesor vleresimi dhe provimi me nje kontribut goxha te madh te asistences se huaj mesimdhënesë. Eshte e nevojshme qe kjo asistencë te perdoret ne menyre intensive per krijimin e kapaciteteve ne Qendren e Vleresimit e te Provimeve, por edhe per futjen e nje kulture te vleresimit³⁴ ne Drejtorite Arsimore (DA) dhe ne shkolla e klasa, ne menyre qe, krahas decentralizimit, edhe besueshmeria ne ofrimin e nje arsimit cilesor te mund te mbeshtetet me prova dhe fakte te besueshme nga arritjet e nxenesve.

³⁴ “Vleresimi” ndryshon nga “inspektimi” pasi ai synon ta shikojë sistemin, shkollën dhe rezultatet e te nxenit ne lidhje me standartet kombetare. “Inspektimi” zakonisht perqendrohet tek inputet (ndertesa, materiale, tekste, numur mesusesish) dhe proceset (numuri nxenesve per klase, oraret, metodat e mesimdhënes, frekuentimi i studenteve). Shqiperia ka nje sistem inspektimi (qe realizohet permes DA). Ne çdo rreth ka gjithashtu edhe “formatore” te cilet sherbejne si keshilltare lendore dhe trainues per mesuesit ne detyre. Ajo qe nevojitet eshte nje funksion vleresues qe te plotesoje metodën aktuale te inspektimit/formatorit.

*Eshte jashtezakonisht e rendesishme qe Shqiperia te vazhdoje te marre pjese ne studimet nderkombetare per vleresimin e arritjeve dhe rezultateve te te nxenit. Shqiperia nuk mori pjese ne studimin nderkombetar te vitit 1999 per arritjet e nxenesve te klasave te teta ne lendet e matematikes dhe fizikes. (TIMSS-R), megjithese u bene perpjekje per pergatitjen e stafit kryesor dhe gjetjen e fondeve. Sidoqofte, ne vitin 2002, Shqiperia do te plotesoje pjesemarrjen ne Programin e OECD per Vleresimin Nderkombetar te Studenteve (PISA). PISA mat se sa mire jane pergatitur te rinjte ne moshen 15 vjeçare – domethene afer perfundimit te arsimit te detyrueshem – per te perballuar sfidat e “shoqerise se sotme te dijeve”. Vleresimet perqendrohen me shume ne aftesite e nxenesve *per te perdorur* njohurite dhe shprehite e veta ne perballimin e sfidave te realitetit, se sa ne masen ne te cilen ata zoterojne nje kurrikulum te caktuar shkollor. Vleresimet e para PISA per vitin 2000 u zhvilluan ne 32 vende; 13 te tjere, duke perfshire edhe Shqiperine, do te perfundojne ne 2002. Testimet kane te bejne me aftesite per te lexuar, aftesite ne matematike dhe fizike, dhe do te jene teper te nevojshem per politikeberesit dhe shkollat ne Shqiperi duke ofuar nje krahasim ne nivel boteror me rezultatet e studenteve ne vende te tjera. Anketimet PISA do te perseriten çdo tre vjet me qellim monitorimin e tendencave ne kohe, por pjesemarrja e vazhdueshme e Shqiperise do te kerkoje fonde.*

Mesuesit dhe Trainimi i Mesuesve

Status i ulet, paga te uleta, emigracion, mesues te pakualifikuar, mesime private, mungese mesuesish, mesues me pune te dyte dhe te trete, mesues ne lista pritjeje... Edhe vete terminologjia e perdorur tregon sa e veshtire eshte gjendja. Sidoqofte, gjate ketyre pak viteve te fundit Qeveria ne bashkepunim me disa OJQ dhe Organizata Nderkombetare ka bere disa ndryshime graduale. Ata qe merren me mesuesit dhe trainimin e mesuesve jane te ndergjegjshem per sfidat, dhe po perpiqen shume per te gjetur zgjidhje. Sugjerimet e meposhtme synojne te mbeshtesin keto perpjekje.

Punesimi dhe pushimi nga puna. Duhet te vendosen kritere dhe kerkesa minimale, qe te perdoren ne punesimin, transferimin dhe pushimin nga puna te stafit profesional. Per kete qellim, duhet te krijohet nje ekip kombetar pune, dhe duhen marre eksperte nga nje organizate nderkombetare ose OJQ.

Pajisja me staf e posteve arsimore duhet te profesionalizohet dhe depolitizohet duke vendosur dhe publikuar kritere punesimi te mbeshtetura ne njohuri dhe aftesi. Pushimet nga puna duhet te bazohen ne prova te qarta te inkompetences dhe gabimeve.

Furnizimi me mesues te kualifikuar. Duhet te rritet numuri i mesuesve te kualifikuar, dhe duhen bere perpjekje per t'i mbajtur mesuesit e kualifikuar ne profesion. Emerimet e detyrueshme te mesuesve te kualifikuar ne zonat fshatare parfunduan me fillimin e tranzicionit: si rezultat, zonat fshatare kane nje perqindje mesuesish me arsim te larte shume me te ulet se zonat qytetare. Si nxitje per te punuar ne zonat fshatare, mesuesit e kualifikuar mund te perfitojne nje shperblim prej 25%. Duhet marre ne konsiderate edhe stimuj te tjere.

Pergatitja shkollore me cilesi te mire e mesuesve eshte gjithmone me e efektshme dhe nje menyre me e mire per pergatitjen e kuadrove mesimore se sa perpjekja “per te mbledhur copat” me vone nepermjet trainimit ne detyre. Bashkepunimi i ngushte shkolle-universitet duhet t’i sherbeje shkembimit te informacionit, pervojes dhe madje edhe stafeve. Qeveria mundet edhe te nxise bashkepunimin me institucionet nderkombetare dhe me vendet partnere. Duhet marre ne konsiderate edhe trainimi i trainuesve permes aktiviteteve ne projekte brenda Europes.

Per te terhequr nxenesit e shkelqyeshem dhe premtues qe mbarojne shkollat e mesme drejt departamenteve te mesimdhenies ne universitete, kane filluar te aplikohen grantet e studimit per studentet e matematikes dhe fizikes ne Universitetin e Tiranes. Kjo skeme mund te zgjerohet me tej; pervec kesaj, duhet te vendosen stimuj (si garancia per pune) per mesuesit e rinj e te kualifikuar per te punuar ne zonat fshatare apo ne vende ku nevojat jane te medha.

Trainimi i vazhdueshem ne detyre. Emigracioni, migrimi i brendshem i mesuesve, dhe mesuesit qe largohen nga profesioni per shkak te pages se ulet dhe kushteve te keqija, kane krijuar nje sistem ne te cilin ka teprice mesusesish ne disa zona, dhe mungese mesusesish ne disa te tjera. Ne menyre te veçante zonat fshatare dhe me te veshtira te Shqiperise kane mangesi te medha.

Trainimi per mesuesit e pakualifikuar duhet te marre rendesine e duhur. Nga ISP dhe departamentet e universiteteve duhen zhvilluar programe per kurse trainimi baze te cilat t’u ofrohen mesusesve te pakualifikuar ne zonat fshatare, sidomos gjate veres. Ne to mund te perfshihen menaxhimi i klases, perdorimi i metodave aktive te mesimdhenies/te nxenit dhe teknikat qe lidhen me to, marredheniet me komunitetin, dhe metodologjia e mesimdhenies se lendeve. Nje program fleksibel, mbase me module, do te ishte me i mire, duke u bazuar edhe ne nevojat e mesuesve.

*Tani per tani nuk ka nje sistem te besueshem per trainimin ne detyre. Sektori i arsimit duhet te vendose mekanizma qe te shfrytezohen per te ndihmuar mesuesit te integrojne kurrikulat e reja, materialet mesimore dhe metodat e mesimdhenies ne praktiken e punes se tyre ne klase. Mbi te gjitha, ofrimi i trainimit ne detyre duhet bere mbi bazen e *kerkesave* – dmth, bazuar ne nevojat reale te mesuesve – dhe jo mbi bazen e *ofertave* – qe do te thote qe mesuesve thjesht t’u jepet nje shans per te zgjedhur midis çfaredo seminaresh apo kursesh qe mund te ofrohen. Shume kohe dhe para shkojne dem per nje trainim ne detyre i cili nuk lidhet me ato çka *vete* mesuesit thone se kane nevojte. Trainimi ne detyre me baze shkolle, ne te cilin e tere shkolla (perfshire edhe drejtorin) merr pjese ne nje program trainimi qe realizohet brenda vete shkolles, ka rezultuar i efektshem ne vende te tjera dhe duhet perdorur shume me gjere ne Shqiperi.*

Bordet e Shkollave. Drejtoret e shkollave duhet te kene me shume fuqi per vendim-marrje dhe autoritet financiar. Bordet e Shkollave te perbera nga prinder, mesues, perfaqesues te DA dhe, ku eshte me vend, nje ose dy nxenes te viteve te fundit, mund te bashkepusojne me drejtorin per zhvillimin e nje politike shkollore dhe perdorimin e burimeve, sidomos ne rastet kur shkollave i eshte dhene pavaresi me e

madhe dhe drejtoret kane me shume pushtet mbi menytrat e drejtimit dhe financimit te shkollave te tyre.

Kujdesi per Femijet dhe Zhvillimin e Tyre

Te caktohen prioritete. Kur jepen rekomandime per sistemin arsimor ne Shqiperi, eshte e rendesishme te kujtohet nje koment i bere nga nje parlamentar i intervistuar nga ekipi vleresues i OECD: “Ka nje hendek te madh midis realitetit Shqiptar dhe mendimit Perendimor”. Lista e tij e prioriteteve per ndryshimin e shoqerise Shqiptare ishte si me poshte:

1. Te rivendoset rendi publik,
2. Te luftohet korrupsioni dhe krimi i organizuar,
3. Te permiresohet arsimi; dhe
4. Te reduktohet varferia.

Te plotesohen nevojat baze. Shkollat kane nevojte urgjente per fonde per te bere permiresimet baze, pasi ka nje mungese pothuajse totale te elementeve thelbesore per nje cilesi arsimore. Shume ndertesa shkollash nuk kane nje mence te veçante apo nje dhome aktivitetesh per te gjitha femijet; kane fare pak njesi funksionuese sanitare; sheshe lojrash dhe oborre shkollash te pasigurte dhe te papershatshem; sisteme te papershtatshme ngrohjeje, dhe fare pak materiale mesimore. Nuk ka as hapesire te brendshme te mjaftueshme per te luajtur femijet. U sugjerua qe godinat e paperdorshme te rinovoheshin dhe te perdoreshin per kopshte femijesh.

Bashkepunimi dhe bashkerendimi. Te shtrihen projektet e perbashketa te MASH dhe UNICEF (Reggio Emilia) dhe AEDP (Hap pas Hapi). Te dy modelet duhet te monitorohen dhe vleresohen, dhe me pas te shtrihen ne me shume kopshte dhe shkolla teteveçare. Te gjitha projektet e perbashketa duhet te pershpejtohen, dhe duhen filluar te tjere.

Te permiresohet komunikimi dhe bashkepunimi ndermjet ministrive te ndryshme te angazhuara ne arsim. Ketu perfshihen MASH, Ministria e Finances dhe Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale. Edhe OJQ nderkombetare duhet ne maksimum te bashkepunojne dhe te bashkerendojne punen e tyre. Drejtoria e veçante ne MASH per bashkerendimin dhe monitorimin e donatoreve duhet vihet ne udheheqje te kesaj pune.

Te eksplorothen nismat rajonale. Kur burimet jane te pakta, eshte e nevojshme te kapercehen kufijte dhe te punohet se bashku. Duhet te zhvillohet bashkepunimi me vendet fqinje ne fushen e arsimit parashkollor.

Te promovohen çeshtjet qe lidhen me shoqerine civile dhe ambientin. Arsimi parashkollor eshte i rendesishem ne shume aspekte. Duke qene se Shqiperia eshte nje demokraci e re, edukimi qytetar duhet te filloje qe ne kopshte. Shqiperia ka fare pak pervoje ne shoqerine civile dhe eshte e rendesishme te ndertohen marredhenie me OJQ kombetare te cilat mund te punojne me femijet (ne kopesht e me lart) per parimet e demokracise. E njejta gje mund te thuhet edhe per edukimin ambientalist, i cili eshte nje

fushe qe do te behet edhe me e rendesishme per nje zhvillim te qendrueshem ne te ardhmen.

Te behen perpjekje per te zgjidhur mungesen kritike te teksteve dhe materialeve te tjera mesimore. Mangesite e materialeve mesimore, teksteve dhe librave per femije duhet te ndryshojne. Perseri mund te jete e nevojshme t'i behet thirrje donatereve te huaj per zgjidhje afatshkurtra, por synimi duhet te jete prodhimi ne vend i ketyre mjeteve pedagogjike. Shtepia botuese shteterore ka 10 vjet qe nuk boton libra te rinj per arsimin parashkollor, dhe me sa duket do te duhet ca kohe deri sa ajo te hartojte libra te rinj bazuar ne kurrikulum. Nderkohe, duhen eksploruar alternativa te tjera.³⁵

Arsimi Profesional

Te hartohet nje metodike e integruar per reformat ne sektorin e AFP. Kjo metode duhet, se pari, te perqendrohet ne nje sinkronizim shume te mire ndermjet reformes ne tregun e punes, sistemit te AFP dhe kontekstit te pergjithshem social-ekonomik; dhe se dyti, te integrojte reformen ne AFP ne sistemin e te mesuarit gjate gjithe jetes.

Te merret ne konsiderate nje program thelbesor per ndertimin e institucioneve me synimin per t'i sjelle ato ne nje linje me metodat nderkombetare ne ceshtje kyçe te politikes, te tilla si keshillimi dhe udheheqja, (ri)trainimi per te punesuarit dhe te papunet.

Te zhvillohet nje program i AFP per nje shans te dyte per te integruar femijet qe nuk marrin pjese ne arsimin apo trainimin ne nivelin e mesem dhe qe largohen para kohe nga shkolla, pasi perqindja e femijeve ne AFP eshte shume e ulet.

Te rritet besueshmeria e drejtoreve te shkollave dhe mesuesve qe t'i sherbeje te nxenit te studenteve, dhe te perforcohen kompetencat e tyre. Te ofrohet trainim per menaxhimin e shkollave, buxhetimin, perdorimin me efektshmeri te burimeve etj. dhe t'u jepet atyre nje rol me i madh ne punesimin e mesuesve, organizimin e trainimeve ne detyre etj.

Te vleresohet ndikimi i decentralizimit ne sistemin aktual dhe te hartohen propzime per reforma qe te rrokin ceshtjet qe lidhen me balancen e pergjegjesive ndermjet aktoreve te ndryshem. Ky vleresim duhet te realizohet me pjesemarrjen e plote te te gjithe faktoreve ne sistem.

Te sigurohet (MASH) cilesia e inputeve dhe outputeve duke vendosur standarte, duke zhvilluar politka dhe duke vleresuar rezultatet. Duhet te perpilohen standarte per performancen dhe te ngrihet nje sistem i besueshem informacioni per te vleresuar si mesojne studentet.

³⁵ Nje shembull jane 5 000 librat e dhene nga nje OJQ Suedeze "Kvinna till Kvinna" (Grua me Grua) (shume aktive ne vendet SEE qysh nga lufta e Bosnje-Hercegovines). Nje shtepi botuese Suedeze, se bashku me autorin dhe perkthyesin (nga Suedishtja ne Shqip), kane dhene falas kontributin e punes se tyre. Flota ajrore Suedeze ka sjelle me avion librat ne kopshtet e Kosoves. Mbase donacione te ngjashme nund te perfitohej edhe per kopshtet Shqiptare, nga OJQ Suedeze ose te vendeve te tjera Europiane.

Te permiresohen akreditimi i programeve te mesuesise, njohurite dhe aftesite e duhura dhe kriteret e perzgjedhjes se mesuesve, drejtoreve, inspektoreve, dhe te zhvillohet nje sistem monitorimi per menyren e funksionimit te sistemit, duke perfshire edhe perhapjen e rezultateve te aktivitetit monitorues.

Te forcohen lidhjet ndermjet reformes se kurrikulumit dhe tregut te punes. Progresi aktual ne kurrikulat e AFP dhe reforma kualifikuese duhet te perqendrohen me shume tek sjellja e tyre ne linje me nevojat e tregut te punes per te ardhmen. Per te arritur kete, konsultimi i strukturuar ne fushen e reformes se kurrikulumit me faktoret kyç, duke perfshire edhe aktoret sociale dhe ekonomike, duhet te futet si nje pjese integrale ne procesin e zhvillimit dhe te vleresimit te kurrikulumit dhe kualifikimit ne nivel Shteteror, lokal dhe shkollor.

Te rishikohet sistemi i trainimit te mesueseve, duke perfshire si vleresimin e institucioneve qe pergatisin mesues edhe auditimin e kualifikimit dhe aftesive te personelit ne shkolla. Te ngrihet ne nivel shteteror nje njesi per te percaktuar standarte te perbashketa per trainimin e mesuesve dhe menaxhereve te shkollave duke u perqendruar veçanerisht ne metodologjite moderne te te nxenit.

Te ofrohen trainime ne detyre per mesuesit dhe drejtoret e shkollave qe jane te perfshire ne zbatimin e kurrikulave te reja. Qe te arrihet kjo, mbase do te ishte i nevojshem nje program intensiv veprimesh te perqendruara (seminare, konferenca, trainime) per te bashkekohezuar standartet aktuale.

Arsimi i Larte

Te forcohet pavaresia e universiteteve dhe e institucionit te ri (sipas ligjit te 1999), Konferences se Rektoreve, e cila duhet te bashkerendoje marredheniet ndermjet Ministrise, universiteteve dhe institucioneve te tjera.

Te decentralizohet struktura, veçanerisht ne lidhje me çeshtjet financiare dhe te permiresohen marredheniet ndermjet Ministrise, universiteteve dhe fakulteteve. Nevojitet nje kuader procedurash buxhetore i cili te beje te mundur qe MF te decentralizojë planifikimin dhe vendim-marrjen ne favor te ministrive te linjes.

Te filloje nje program per krijimin e kapaciteteve per administratore te larte te universiteteve dhe stafit ne fushen e menaxhimit dhe finances. Ky program duhet te ofrohet nga Shteti por te mbeshtetet nga donatore dhe eksperte nderkombetare. Kjo duhet te lidhet me rritjen e fondeve per arsimin e larte dhe permiresimin e cilesise se mesimdhënies, kerkimit dhe sherbimit.

Te rritet angazhimi i kapaciteteve akademike kombetare ne zhvillimin e vendit i cili duhet te mbeshtetet me shume ne njohurite shkencore dhe aftesite praktike e pervojën e asistentëve dhe profesoreve te universiteteve. Per te rritur aftesite, kompetencat dhe

eksperiencen e stafëve universitare ata, në mënyrë rutinore, duhet të merren në konsideratë dhe të punësohen në projekte qeveritare dhe donatore të të gjitha llojeve.

Te përmiresohet menaxhimi dhe sigurimi i cilësisë në të gjitha nivelet; të forcohet roli i Agjencisë Kombëtare të Akreditimit. Njësitë qeverisëse duhet t'i japin prioritet futjes së matësve ndërkombëtarisht të krahasueshëm për cilësinë, efektshmërinë, dhe besueshmërinë e të gjithë niveleve të arsimit.

Te ripërterihen kurrikulat në përputhje me Proçesin e Bolonjes.

Te mbështetet puna kërkimore në universitete, ngritja e një rrjeti për kërkime shkencore brenda Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit dhe me institucione dhe universitete ndërkombëtare.

Te zhvillohet një sistem kualifikimi pas-universitar si edhe instrumentet për të mesuarit në detyrë dhe kualifikimin e mëtejshëm.

Te krijohen institucionet e arsimit të lartë jo-universitar me orientim profesional për të plotësuar nevojat e ekonomisë në ndryshim dhe të tregut të punës.

REFERENCAT

- Berryman, Sue, (2000) "Sektori i Arsimit ne Shqiperi: Probleme dhe Premtime." Washington D.C. Banka Boterore. Projekt Diskutim.
- De Waal, Clarissa (2000) "Raport mbi Arsimin Rural ne Shqiperi dhe Reformat e Propozuara per Rritjen e Efektshmerise se tij." Tirane: AEDP (OSI). Draft.
- Dudwick, Nora dhe Shahriari, Helen (Shkurt 2000), Banka Boterore. Arsimi ne Shqiperi: Ndryshimi i Qendrimeve dhe Shpresave. Washington, D.C. Banka Boterore.
- Durham, Edith (1985) Shqiperia e Larte. 1909. Londer: Virago Travellers Series. Ribotuar ne 1985 nga Virago Press Limited.
- Duthilleul, Yael; Hoxha, Artan; Llambiri, Stavri et al. (2000) "Shqiperia: Çeshtje dhe Sfida ne Drejtimin e Arsimit". Banka Boterore.
- Fonseca, Isabel (1996) Me Varrosni ne Kembe: Jevgjitet dhe Udhetimi i Tyre. Londer: Vintage Press.
- Francesco, Panzica (2000) Shqiperia: Tregu i Punes dhe Vleresimi i Sektorit AFP. Fondacioni European i Trainimit. (ETF) Torino.
- Hammarberg, Thomas (1997) "Nje Shkolle per Femijet me Te Drejta." Firenze: UNICEF Qendra Nderkombetare per Zhvillimin e Femijes. Innocenti Lecture series, 1997.
- Kaser, Karl (2002) Drejtimi dhe Menaxhimi i Arsimit te Larte ne Europen Juglindore. Vizite ne Shqiperi dhe FYROM. Punim i Pabotuar. Universiteti i Gratz, Austri.
- Kisi, Pavli, ed. (2000) "Te dhena Statistikore per qellime mbeshtetese te Vleresimit te OECD. Shqiperi. Qendra per Studimin e Politikave Arsimore (CEPS), Universiteti i Ljubljanes, Slloveni.
- Klugman, Jeni (1997) "Decentralizimi: Nje Ankete nga Kendveshtrimi i nje Femije." Firenze: UNICEF Qendra Nderkombetare per Zhvillimin e Femijes, Seria e Politikes Ekonomike dhe Sociale No. 61. Firenze.
- Instituti i Studimeve Pedagogjike (ISP) dhe UNICEF (1996), Tirane. Arsimi ne Shqiperi: Dosie Kombetare. Tirane.
- Ministria e Arsimit dhe Shkences (1998) dhe Banka Boterore (Mircea Enache dhe EMI Systems Inc.) Projekt Arsimi 1: Raport i Misionit per Harten e Shkollave dhe Mbledhjen e Fakteve. Tirane.
- Musai, Bardhyl (2000) "Reformimi i Arsimit per Mesuesit ne Shqiperi: Te Rejat ne Partneritet dhe Mentorim." Tirane: AEDP (OSI). Draft.

- Palomba, Geremia dhe Vodopivec, Milano (Mars 2000) Banka Boterore. “Financimi, Efektshmeria, dhe Barazia ne Arsimin Shqiptar.” Washington, D.C.: Banka Boterore.
- Pettifer, James (1994) “Ngritja dhe Renia e Komunizmit Shqiptar.” Londer: A & C Black, 1994.
- Ringold, Dena (2000) Banka Boterore. “Arsimi dhe Romët ne Europen Qendrore dhe Lindore: Tendenca dhe Sfida.” Draft i pabotuar. Washington, D.C.: Punim i Bankes Boterore prezantuar ne Konferencen Arsimi Rajonal Europian per Te Gjithe, Varshave, Poloni.
- Tryeze Pune 1 e Paktit te Stabilitetit (Tetor 2000) Shqiperi: Raport per Gjendjen / Progresin. Tirane: Tryeza 1 Kombetare e Punes (Demokracia dhe Te Drejtat e Njeriut). Punim i pabotuar per mbledhjen e Bukureshtit.
- Terzis, Nikos P., ed. (2000) “Sistemet Arsimore te Vendeve te Ballkanit: Çeshtje dhe Tendenca.” Shoqata Ballkanike per Pedagogjine dhe Arsimin. Athine: Shtepia Botuese Kyriakidis Brothers.
- UNICEF (1997) Qendra Nderkombetare per Zhvillimin e Femijes. Femijet ne Rrezik ne Europen Qendrore dhe Lindore: Rreziqe dhe Probleme. Projekti MONEE, Raporti Monitorues Rajonal No. 4. Firenze.
- UNICEF (1998) Qendra Nderkombetare per Zhvillimin e Femijes. Arsimi per te Gjithe. Projekti MONEE, Raporti Monitorues Rajonal No. 5. Firenze.